

## Botohet për herë të parë në gjuhën shqipe soneti “Shtegtari i dashuruar” i Shekspirit, përkthyer nga Alqi Kristo në vitin 1970

Përgatitur nga Prof. Dr. Diana Kristo




In Memoriam

## Skënder Kamberi Lamtumirë, Mjeshtri rebel i ngjyrës

Ylli Drishti

Av. Fatmir Braka



Vizatimi © Bashkim Alushi

(fq. 10)

Piktori Skënder Kamberi i përket brezit të parë të piktorëve nga Vlora që mbaruan studimet në Akademinë shqiptare të arteve. I diplomuar në Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë në vitin 1965, në atelietë e Danish Jukniut dhe Vilson Kilicës, Kamberi u kthye menjëherë në Vlorë, ku hodhi themelet e një tradite të re artistike. Si pedagog i parë në shkollën artistike “Naim Frashëri”, ai formoi breza të tërë artistësh, duke u bërë jo vetëm krijues, por edhe një figurë kyçe në edukimin dhe emancipimin estetik të qytetit.

Dokumentari filmik, ngjarje  
sa kulturore aq dhe historike

“Nikolla, i zemrës së Tiranës”,  
përpyetje në sukses e  
dokumentarit me bashkautorë  
SHANAJ-LAKO

Nga Agron Xoxa

(fq. 7)

Dy fjalë për 25-vjetorin e Shoqatës  
së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë  
Letërsia nuk është luks  
i qytetërimit: Ajo i përket  
formimit të njeriut

Nga Gjekë Marinaj

(fq. 6)

### SHËNIME MBI LIBRAT

Mozaik shënimesh për veprën e Thanas Dinos

Midis kujtesës, historisë  
dhe fatit njerëzor

Nga Petro Çerkezi

(fq. 8)

Mbi romanin “Zonjës me pirpiri”  
të Odise Kotes, “Toena”

Një poemë epifanike

Nga Prof. Zija Vukaj

(fq. 11)

Mbi romanin “Ditët e lakuriqëve të natës”  
të Namik Dokles

Temperatura e ankthit

Nga Izet Duraku

(fq. 12)

Mali i tejdukshëm i Zija Çelës

Roman atipik, projeksione  
parashënjuese

Nga Prof. Bashkim Kuçuku

(fq. 13)

Kompozuar nga Vasil S Tole, dirigjuar nga Eno Koço

“ALBANOI” asht një vepër  
e kalibrit european që na nderon  
kudo në botë

Nga Robert Prennushi

(fq. 11)

Artikulli “Gratë tona”  
i editorit të Gazetës “Drita” të  
Gjirokastrës, Veli Hashorva në  
kontekstin e emancipimit të  
gruas shqiptare (1920)

Nga Dr. Dorian Koçi

(fq. 4)

## Një takim letrar i viteve '70

Me dy korifinj  
të letrave shqipe:  
Dhimitër Shuteriqin  
dhe Fatos Arapin

Nga Agim Vinca

(fq. 2)



### BIBLIOTEKË

— Ylljet Aliçka

*Shkrimtarët*

(fq. 14)

— Kimete Arifaj

*Antologji poetike*

(fq. 16)

— Mikel Gojani

*Nën një copë qiell*

(fq. 17)

— Behar Jacaj

*Thundrat*

(fq. 17)

— Sazan Goliku

*Lotët e pyllit*

(fq. 18)

— Arta Maxhuni

*Ajâ*

(fq. 18)

— Klara Kodra

*Në ditëlindjen e motrës*

(fq. 19)

— Arben Meksi


*Karikatura e së shtunës*

(fq. 19)

### Libri shqip në Amerikë

Dërgesa të shpejta  
dhe të sigurta  
me një klik

www.albibris.al



Në nëntor të vitit 1979, me një grup pedagogësh të Universitetit të Prishtinës, kisha shkuar në Shqipëri për një qëndrim studiues.

Një ditë kisha lënë takim me poetin Fatos Arapi te hotel Tirana, jo larg nga Biblioteka Kombëtare, ku punoja për temën time të doktoratës. Kur u takuam në hyrje, Fatosi më tha: "Është edhe Shuteriqi këtu. Dëshiron të të takojë. Ke qejf?".

- O, edhe më pyet?! Nder i madh për mua!

Kur u afruam te tryeza në të cilën qe ulur profesor Shuteriqi, vetëm, pamë se kishte hapur një mori fletësh, skedash e letrash në dorëshkrim ose të daktilografuara. Mbi disa sosh kishte vënë beretën e tij të njohur. Ishte zhytur në punë. Sa na pa, u ngrit në këmbë dhe derisa Fatosi po më prezantonte: "poet etj.", më përqafoi dhe më tha: "Ta kam dëgjuar emrin... Por gëzohem që të shoh këtu n'Shqipni!". Kështu tha: "Shqipni". Ndoshta me qëllim.

Dolëm në një sallë tjetër, sepse salla ku u takuam ishte pak e ftohtë. Ndenjëm bukur gjatë. Pimë kafe dhe biseduam. Fliste pothuajse vetëm ai, ndërsa ne dëgjonim dhe ndërhynim herë-herë me ndonjë pyetje a "ngacim". Profesori tymoste llullën e tij të famshme, kurse unë dhe Fatosi ndiznim nga ndonjë cigare "DS" a "Bozhur", që i kisha sjellë nga Prishtina.

E pyeta se a i binin në dorë botimet e Prishtinës. "Kam disa qarje për këtë punë", tha. "Nuk më vijnë librat. Bile dëgjova se është botuar një vëllim imi me tregime, por s'ma kanë dërguar. S'di pse. E do të doja ta marr edhe 'Jetën e re', edhe atë romanin në tregime të Rexhep Qoses, edhe...".

Shpreha keqardhjen time që Redaksia e botimeve "Rilindja", drejtuesit e së cilës vinin shpesh në Tiranë, nuk ia kishte dorëzuar autorit kopjet e librit të tij me tregime, *Ura në Tepelenë*, që kishte dalë para disa muajsh, në mos më shumë. Sikur ta dija do t'ia sillja unë një ekzemplar.

Profesori nuk e zgjat. Fatosi, për ta nxitur muhabetin, e ngacmon nga pak. "Janë të vështirë këta lirikët kur bëhen satirikë", thotë Shuteriqi dhe duke e ditur dobësinë e poetit vlonjat për krahinën nga vjen, rrëfen një ngjarje që ka të bëjë me Vlorën dhe Zvërnecin. (Mua sakaq m'u kujtua vjersha e Fatosit për Zvërnecin, ku poeti thotë: "Këtu nuk jam i huaj dhe mbrëmave nuk do të therin pulën për mua"). Flet ngadalë, qetë, për një vizitë në Manastirin e Zvërnecit diku në vitet '50 dhe për një lloj peshku (nuk ia mbajta mend emrin), që rritet vetëm në liqenin-det të Zvërnecit. Përmend një kryetar kooperative, dogmat, që paskësh thënë: "Është e ndaluar gjuetia e peshkut!" dhe një kryetar tjetër, më liberal, që urdhëron të sillen peshq për miqtë që "na kanë nderuar me vizitën e tyre".

# NJË TAKIM LETRAR I VITEVE '70

## Me dy korifenj të letrave shqipe: Dhimitër Shuteriqin dhe Fatos Arapi

Nga Agim Vinca

"Ishte fillimi i viteve '50", thotë. "Duhet të ketë qenë viti 1951. Nga Vlora në Zvërnec atëherë nuk shkonte makina, ndaj udhëtuam me kalë, me kuaj. Vizituam Kishën e Shën Sofisë, shijuam peshkun e Zvërnecit me verë të mirë dhe u kthyem nga kishim ardhur.

Jam matur shumë herë ta shkruaj këtë ngjarje, por nuk e kam shkruar dot. Është e bukur, ë?".

Unë pohoj me kokë, kurse Fatosi buzëqesh. Vazhdojmë bisedën. Profesor Shuteriqi është i gjerë si deti. Di shumë dhe flet bukur.

Për të mësuar diç më shumë për jetën e tij, e pyes se ku i ka kryer studimet. "Në Grenobël", thotë. Atje më zuri edhe okupacioni. Më parë pata kryer Liceun e Korçës, ku mësimet bëheshin frëngjisht. Në vitin 1942 u ktheva në Shqipëri, në Elbasan dhe hyra në luftë; aty njoha edhe time shoqe, Myneverin, që kishte dalë në mal për të luftuar fashizmin, si unë".

"Po krijimtarinë kur e filluat?", pason pyetja ime e radhës. "Vjershën e parë, thotë, e kam shkruar kundër Bodlerit në moshën 13-14 vjeçare. Unë atëherë isha religjioz. Dhe kur lexova te *Fleurs du Mal* atë Lutjen Satanait: "*O Satan, prends pitié de ma longue misère/ O satana, mëshirë për vuajtjen time të gjatë*" (Shuteriqi e reciton në origjinal këtë varg të poezisë bodleriane), u revoltova dhe thashë me vete: 'Po ky qerrata pse nuk i drejtohet Zotit po djallit?! Vargjet e Bodlerit ishin sfidë drejtuar shoqërisë së kohës, protestë



kundër realitetit borgjez, por unë atëherë aq dija, aq kuptoja, prandaj u ula dhe e shkrova atë vjershë, që s'di ku ka mbetur. Pastaj edhe shumë të tjera. Shkruaja, por nuk botoja. Nuk kisha guxim".

Pushon pak. Thith llullën dhe vazhdon. "Mirëpo, do ti që një ditë vjen në Korçë një Vendresha, një skriboman, që kish shkruar diçka për Ali Asllanin, më takon mua dhe më thotë: 'Pse nuk merresh me shkrime?'. Unë e ftova të shkonim në shtëpinë ku banoja. Ishte dimër. Të zonjën e shtëpisë e luta të na ziente ca gështenja. Pimë edhe pak verë. Unë u nxeha dhe fillova t'i lexoj vargje zotërisë në fjalë. Ai më tha: 'Pse s'i boton?'. Vendresha, me emrin

Shemshedin, ishte tip aventurieri (më vonë u arratis andej nga ju), por mua më nxitu t'i hyja botimit të vjershave të mia.

Të nesërmen që në mëngjes çohem e vete te Dhori Koti. Dhori Koti, librar i njohur, kishte një librari në Korçë. Kishte edhe një shtypshkronjë. Botonte Naimin. Me atë jetonte.

- Sa e bëni një libër? - i them unë.

Ai ngriti kryet, më shikoi, pastaj më pyeti: 'Ç'libër, mor djalë? Çfarë shkruan ti?'

- Poezi - i thashë.

- Poezi! Po kush e lexon poezinë?

Unë kisha në xhep pesë napolona flori. Para të mëdha për atë kohë. M'i kishte dërguar babai që të blija një kostum. 'Blije

**dhimitër**

**s. shuteriqi**

**poezis**

(shokut, qi nuk njof,  
poetit p. marko)


«T'vërtetën! tivërtetën më trego!  
Kështu të çirresh, ty, një i ashpër za!  
- O zani i keq! O zani i shkretë!  
«T'vërtetën më trego!»  
- Nuk a shpirti i vërtetë!?  
Dhe ti ke po ate frymë, qi i ep gjasë jetë,  
tue mos qenë e shtangët gja,  
po n'amëshim tue jetë.

Fjala e jote përvëluese,  
qi gjëmon n'gjithsi  
çdo ditë, tinguj t'ri,  
asht fjala e rinis me kangë përshkuese  
përshkuese drite t'bardhë, pa njollë errsine;  
pa le t'duket se lenë ndoi ditë  
prej ndoi fellsine,  
ku t'rrallë shofin një dritë,  
një dritë të rrallë,  
shkëndi gjallnije  
e madhnije;  
mallë;

dashuni,  
dashunie dlirtë,  
qi tret me dritën tingëllimin;  
qi i tret zan zogut me agimin;  
zan e prronit me gjelbrimin;  
erën e lules me bukurin e 'saj;  
qi thotë se ka një shpirtë,  
te dlirtë përmbi të dlirtë,  
qi shuen në një muzikën me ngjyrat e shijimiu.

O kangë e djepit të ditëve t'rinis  
të ditëve t'madhnis!  
M'mësove t'dashunoj  
E t'rroj!  
Unë thashë se do ta gjeja vetëm në lumtëni  
tingullin t'at përvëlues, qi desha t'i gjejë kudo  
Të gjeta dhe n'vorfni,  
n'mjerim t'pashoq... Me thoje: «Ti shëko  
t'më gjuhë ku lëvis ndenja fortë edhe dër-muëse,  
se un jam kanga e ndjenjëse jo e fjalës Lutuëse  
qi mund të gjuhë kudo».

(Nga «Illyria» 1935)



stofin dhe dërgoje tek rrobaqepësi' – më tha. Por ndërrova mendje.

Kur i thashë librarit se e kisha seriozisht dhe se kisha para, m'u përgjigj:

- Tre napolona e gjysmë me letër të zezë; pesë me të bardhë.

- Po mirë, i thashë. Do më bësh 500 copë me të zezë, por ama 20 copë për mua me letër të bardhë.

Në bisedë e sipër, Dhori si duket më njohu që nuk isha nga Korça dhe më pyeti se nga isha dhe i kujt isha. Kur i tregova, u habit: 'I Simonit je?... O, po ti qenke djali i mikut tim, more!'. Më përqafoi dhe më tha: 'Tre napolona e gjysmë dhe 20, 30, 35 copë me letër të bardhë për ty. Po deshe menjëherë fillojmë nga puna'. Atëherë unë kalova në pjesën prapa librarisë, në shtypshkronjë dhe nisa të bisedoj me tipografët për tipin e shkronjave. Për dhjetë ditë libri ishte gati. E quajta *Kangët e rinis së parë*. Sepse të tilla ishin, 'këngë'.


Kështu unë mbeta pa kostum, por botova librin e parë dhe u bëra 'shkrimtar'. 'Isha i ri, njëzet vjeç dhe si çdo i ri edhe ëndërrimtar', e përfundon rrëfimin e tij Shuteriqi dhe nis të kërkojë diçka në çantën që ka pranë. "Nuk kam kopje nga libri i parë, por më ka qëlluar një nga libri i dytë, KANGË, botuar

një vit më vonë, më 1936, po te 'Dhori Koti'. Dhe nxjerr nga çanta një libër të hollë, me kapakë të bardhë, krem dhe ma dhuron me dedikim, me një shkrim të imët, por elegant. "Poetit Agim Vinca, një kujtim (nga Shqipëria e vjetër), prej Shqipërisë së re, me urimet më të mira". Pason firma poshtë tekstit dhe vendi e data: "Tiranë, 14. XI. 79".

Libri i kushtohet, siç mund të shihet, "Shokut P. M.". Nga një poezi e botuar në revistën "Illyria" mësojmë se prapa këtyre nistoreve fshihet emri i Petro Markos. Këtu kushtimi është më i plotë: "Shokut, qi nuk njof, poetit P. Marko". Që të dy i takonin brezit të krijuesve të viteve '30 me Migjenin në krye, që luftonin për një art të ri e revolucionar, por jo edhe të pavlerë e trivial.



E falënderoj profesor Shuteriqin për këtë dhuratë, që e ruaj si kujtim të shtrenjtë dhe pasi përshëndetem me të dy miqtë e nderuar shkoj në Bibliotekën Kombëtare dhe në një bllok të vogël që kisha me vete i bëra shpejt e shpejt këto shënime.

E gjeta këto ditë, rastësisht, atë bllok të zverdhur, të struktur mes librash e fashikujsh dhe thashë ta ndaj me lexuesit këtë rrëfim për takimin e para gati gjysmë shekulli me dy korifenj të letrave shqipe: Dhimitër Shuteriqin dhe Fatos Arapin.



Dhimitër Shuteriqin. *Autoportret*

Dhimitër Shuteriqi. *Kopertina e librit të parë*



Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore dhe krizës së madhe politike që kishte përfshirë vendin e sapo dalë nga Lufta e Madhe, Shqipëria ndodhej në proces rindërtimi institucional dhe identitar. Ngjarje të rëndësishme kombëtare si mbajtja e Kongresit të Lushnjës (janar 1920) dhe Lufta e Vlorës (qershor 1920) shënuan një përpjekje për konsolidimin e sovranitetit shtetëror dhe për ndërtimin e një administrate kombëtare. Në këtë klimë të mobilizimit social dhe kombëtar, shtypi shqiptar luajti një rol të rëndësishëm si hapësirë debati për çështjet politike, kulturore dhe shoqërore. Ai bëri të mundur përhapjen e ideve të nacionalizmit, apo shqiptarizmit, duke krijuar një publik të gjerë lexuesish në gjuhën amtare. Kjo gjuhë zëvendësoi dominimin e mëparshëm të gjuhëve të shkruara të huaja në formësimin e mendësisë së njerëzve dhe dobësoi solidaritetet tradicionale fetare, si ato të krishterimit dhe umetit islam, si edhe forma të tjera solidariteti shoqëror, duke i hapur rrugë një solidariteti të ri të bazuar mbi gjuhën dhe kulturën shqiptare. Një nga organet e para të shtypit shqiptar në vitet e para pas shpalljes së pavarësisë dhe konsolidimit të shtetit kombëtar ishte gazeta "Drita" (1920-1924), e botuar në qytetin e Gjirokastrës. Ajo përfaqëson një nga nismat e rëndësishme të shtypit në gjuhën shqipe në këtë qytet dhe dëshmon për zgjerimin gradual të hapësirës publike shqiptare në fillim të viteve 1920. Gazeta u drejtua nga patrioti dhe publicisti demokrat Veli Hashorva (1892-1975), i cili kontribuoi në zhvillimin e debatit politik dhe kulturor të kohës. Ai ishte përfaqësues i një familjeje të vjetër gjirokastrite, të parët e të cilit kishin administruar financat e vilajetit të Janinës<sup>1</sup>. Veli Hashorva e kishte filluar veprimtarinë patriotike në qytetin e lindjes, në Gjirokastrë si anëtar i klubit "Drita" të themeluar më 1908. Më 1911 ai shkoi në Stamboll për studimet e larta për shkenca politike dhe u kthye në Shqipëri më 1912. Veli Hashorva së bashku me studentët të tjerë shqiptarë, përfshirë edhe mikun e tij Ali Këlcyra, i ndërpreu studimet e larta për arsye të shpërthimit të luftërave ballkanike. Si veprimtar i Lëvizjes Kombëtare, u ndoq dhe u përdoq nga forcat greke, kur ato pushtuan Gjirokastrën, më 1913. Për t'u shpëtuar përndjekjeve të mëtejshme, në maj 1915 mërgoi në SHBA, ku punoi pranë Federatës "Vatra". Më 1916 botoi në Nju Jork gazetën "Vjosa", me frymë politike kombëtare.<sup>2</sup> Megjithatë, pas botimit të disa numrave, vendosi ta ndërpriste atë,

<sup>1</sup> Arkivi i familjes Hashorva.

<sup>2</sup> Dorian Koçi. Patritoti liberal Veli Hashorva dhe Gazeta "Drita" E Gjirokastrës (1920-1924), Pikëtakime historike, kulturore dhe identitare, Vol.III, Bota Shqiptare, 2023, Tiranë, f. 154

## Artikulli "Gratë tona" i editorit të Gazetës "Drita" të Gjirokastrës, Veli Hashorva në kontekstin e emancipimit të gruas shqiptare (1920)

Nga Dr. Dorian Koçi



me qëllim që komuniteti shqiptar në Shtetet e Bashkuara të përqendrohej në një organ të vetëm përfaqësues, gazetën "Dielli", si dhe që burimet financiare të kanalizoheshin në mbështetje të Federatës "Vatra" dhe të vetë "Diellit". Më 3 qershor 1917 zgjidhet delegat për kuvendin e Vatrës, që organizoi fushatën për mbledhjen e një shume prej 40.000 dollarësh (750.289 dollarë me kursin e sotëm) për të bërë të mundur që kolonia shqiptare e Amerikës të dërgonte dy përfaqësues në Konferencën e Paqes – z. Mehmet Konica dhe z. Turtulli<sup>3</sup>. Veli Hashorva u kthye në Shqipëri më 1919, kur Gjirokastra ishte ende nën zonën e pushtimit italian bashkë me Tepelenën. Sipas një letre të Luigj Gurakuqit, dërguar Parashqevi Qiriazit më 6 dhjetor 1919 nga Parisi, Veli Hashorva ishte këshilltar i "Vatrës" dhe po kthehej në Shqipëri bashkë me Kol Tromarën dhe Ilia Panon. Pasi kishin qëndruar dy javë në Romë dhe pasi qenë takuar me Luigj Gurakuqin, Mehmet Konicën e përfaqësues të kolonisë së Stambollit, ata ishin kthyer në Shqipëri<sup>4</sup>. Në janar të vitit 1920, Veli Hashorva mori pjesë në Kongresin e Lushnjës si një nga përfaqësuesit e Gjirokastrës. Përvoja e Veli Hashorvës si gazetar në SH.B.A., si editor i gazetës "Vjosa" dhe kontributor në gazetën "Dielli", si edhe qëllimet e rithemelimit të shtetit kombëtar shqiptar që u shpalosën në Kongresin e Lushnjës, e nxitën për të themeluar gazetën "Drita" në Gjirokastrë. Numri i saj i parë doli më 27 mars 1920, dy muaj pas Kongresit të Lushnjës dhe në ditën e konstituimit të Këshillit të Lartë me 37 anëtarë, që konsiderohet si parlamenti i parë shqiptar. Sipas kujtimeve të Veli Hashorvës, emrin "Drita" të gazetës ia ka propozuar Petro Poga, ish-ministër i Drejtësisë në qeverinë e Vlorës dhe një nga drejtuesit e gazetës "Drita"

<sup>3</sup> Kalendari i Vatrës i motit 1918, Shtypur në Shtypshkronjën e Gazetës Dielli 1918, edituar nga Fan Noli, fq 65.

<sup>4</sup> Hylli i Dritës. Letërkëmbimi i Luigj Gurakuqit. Nr 3, mars 1944, fq 79-80.

në gjuhën shqipe në Stamboll më 1884<sup>5</sup>. Numri i parë i gazetës u bë fshehtëzi për t'ia bërë surprizë popullit. Ceremonia e vogël e çeljes së gazetës u bë në oborrin e shkollës fillore "Drita", ku ishin thirrur një grup qytetarësh, midis tyre edhe disa gra, kryetari i bashkisë, prefekti dhe zëvendësprefekti i qytetit etj. Këtu drejtori përgjegjës i gazetës, Veli Hashorva mbajti një fjalim modest: "Zotërinj, jam i lumtur pa masë që kam nderin të flas në qytetin tim që jam lindur dhe rritur, për herë të parë përpara një shumice patriotësh, të cilët janë edhe njerëzit më të zgjedhur të Gjirokastrës. Po ajo që më lumturon më tepër është rasti gazmor që shkaktoi këtë mbledhje, i cili do të mbetet i çmuar në historinë e qytetit tonë dhe në jetën time personale".<sup>6</sup> Përmes artikujve dhe qëndrimeve të saj editoriale, "Drita" u bë një platformë e rëndësishme për diskutimin e çështjeve kombëtare, arsimore dhe shoqërore, duke reflektuar orientimet demokratike dhe modernizuese të një pjese të elitës intelektuale shqiptare të periudhës. Në këtë kuadër, roli i gazetës nuk kufizohej vetëm në informim, por shtrihej në formësimin e opinionit publik dhe në konsolidimin e gjuhës shqipe si mjet themelor komunikimi në hapësirën publike. Shtypi i kësaj periudhe kontribuoi në ndërtimin e identitetit kombëtar dhe në institucionalizimin e debatit politik, por edhe në trajtimin e problemeve sociale të shoqërisë shqiptare, duke u shndërruar në një element të rëndësishëm të modernizimit kulturor dhe shoqëror të Shqipërisë së viteve 1920.

Në këtë kontekst, Gazeta "Drita" e Gjirokastrës ishte një nga organet e shtypit lokal që synonte të ndërgjegjësojë publikun për problemet e shoqërisë shqiptare dhe për nevojën e reformave administrative dhe shoqërore. Ajo u bë një hapësirë e rëndësishme

<sup>5</sup> Arkivi i familjes Hashorva.

<sup>6</sup> Flutura Hashorva, 95-vjetori i gazetës "DRITA" e Gjirokastrës (1920-1924). Gazeta "Tirana Observer" 27.03.2015; "Drita" Nr.2, prill 1920.

e debatit publik, ku diskutoheshin çështje me karakter kombëtar, shoqëror dhe kulturor. Përmes artikujve të saj, gazeta synonte të ndikonte në formimin e një vetëdijeje më të avancuar qytetare dhe në nxitjen e ndryshimeve shoqërore.

Artikulli "Gratë tona", i botuar në gazetën "Drita" të Gjirokastrës më 13 maj 1920 dhe i shkruar nga editorit i saj Veli Hashorva, përbën një dokument domethënës për të kuptuar debatet sociale dhe kulturore në Shqipërinë e fillimit të shekullit XX. Teksti reflekton përpjekjet e elitave intelektuale shqiptare për të diskutuar dhe reformuar rolin e gruas në shoqëri në një moment kryesor të historisë së vendit. Viti 1920 përfaqëson një periudhë vendimtare për shtetin shqiptar. Në këtë kuadër historik, artikulli i Veli Hashorvës lidhet drejtpërdrejt me projektin modernizues të elitave shqiptare të kohës, duke dëshmuar përpjekjet për transformim shoqëror dhe kulturor. Artikulli pasqyron një realitet social të karakterizuar nga patriarkalismi i fortë dhe izolimi i grave në jetën familjare. Në shumë zona të Shqipërisë, veçanërisht në qytete të Jugut dhe në familje me tradita konservatore, gratë jetonin të kufizuara në hapësirën e shtëpisë dhe kishin shumë pak mundësi për arsimim apo pjesëmarrje në jetën publike. Duket se, për rreth një shekulli që nga koha kur Bajroni kishte përshkruar statusin social të femrës shqiptare, situata nuk kishte ndryshuar shumë. Gruaja shqiptare kur Bajroni vizitoi Shqipërinë e Jugut më 1809 jetonte në një shoqëri tipikisht patriarkale, siç ishte edhe shoqëria e Perandorisë Osmane, ku dallimet ndërmjet grave të miletëve të ndryshme nuk ishin thelbësore në aspektin e pozitës shoqërore. Mes gjithë epiteteve lavdëruese për bukurinë e tyre — për të cilën bien dakord pothuajse të gjithë udhëtarët e huaj të shekullit XIX — bie në sy një përshkrim i tërthortë që Bajroni i bën statusit të tyre social, duke i përshkruar si "tamed in their cave" ("të zbutura në shpellën e tyre"), një figuracion që vështirë se i përshtatet natyrës së butë femërore. Në pak rreshta, Bajroni rrëfen pozitën shoqërore të gruas shqiptare, e cila nuk dilte dot vetëm pa shoqëri dhe pothuajse gjithmonë ishte e mbuluar. Në të njëjtën kohë, ai thekson edhe tiparet e besnikërisë dhe përkushtimit ndaj fëmijëve dhe familjes.

Në këtë vend s'i ndihet zëri gruas:

E mbyllur, s'del dot pa çarçaf e rojë,  
Mësuar në kafaz, as do të dalë;  
Njëjtë vetëm ia jep trupin dhe zemrën,  
Atij q'ë ka pranuar zot e burrë;  
E lumtur në detyrë amtare t'ëmbël

— Në më të shenjtën përmbi gjithë ndjenjat

— Me gjin' e saj e rrit fëmin' e saj,

E nuk e lë t'u bindet epsheve më t'ulta.<sup>7</sup>

Dyzet vjet më vonë, kur Edward Lear vizitoi Gjirokastrën, ai na ofron një përshkrim edhe më të gjallë të grave të këtij qyteti, të shoqëruar edhe me një gravurë të tyre. Përmes përshkrimit të veshjes së tyre të veçantë, në përputhje me zakonet tradicionale islame, nënkuptohet edhe statusi i tyre shoqëror dhe kufizimet që karakterizonin jetën e tyre publike. Në këtë kuadër, Lear shkruan:

"Por nga të gjitha risitë befasuese, këtu apo kudo tjetër, më lejoni të rekomandoj kostumin

<sup>7</sup> Bajron. Çajld Harold. Tiranë: 1973, përkthyer nga Skënder Luarasi



Në qendër, ulur Urani Rumbo, drejtoresha e shkollës dhe në krah mësuesja Hasibe Hashorva. Musine Kokalari, rrjeshti i dytë, e katërta duke filluar nga e djathta

e grave të Argyrokastrës! Përbindëshat më të çuditshëm që janë paraqitur apo imagjinuar nuk i afrohen realitetit të këtyre krijesave jashtëzakonisht të veçanta në ecje dhe veshje; dhe është për t'u habitur se kur dhe nga kush u shpik për herë të parë kjo lloj veshjeje, apo si mundën qeniet njerëzore ta praninin ta vishnin atë. Fillimisht, përfytyroni një maskë të ngushtë prej liri të bardhë të fiksuar në fytyrë, me dy të çara të vogla përmes të cilave shihen sytë. Më pas, një mbështjellëse e gjerë prej të bardhe, me shirita të gjerë në ngjyrë bezhë të çelët, e cila mbulon të gjithë pjesën e sipërme të trupit dhe është mbledhur në palë të mëdha rreth krahëve, të cilët mbahen me bërrylat e ngritur, ndërsa duart ruhen me kujdes nga pamja nën mbulesën e rëndë. Shtoni këtyre pantallona të shkurtra e të gjera prej basme vjollcë dhe çizme të larta në ngjyrë të verdhë si kanarinë, me thekë në ngjyrë trëndafili; dhe çfarë incidenti më mahnitës në historinë e veshjes femërore mund të imagjinohet?<sup>8</sup>



Nisur nga kjo trashëgimi sociale, editori i gazetës "Drita", Veli Hashorva, në artikullin e tij "Gratë tona", trajton çështjen e pozitës shoqërore të gruas shqiptare në fillim të shekullit XX. Përmes metaforës së gruas që jeton "si brenda një guaske", autori përshkruan mbylljen fizike dhe sociale të grave, duke kritikuar zakonet dhe normat tradicionale që i mbajnë ato të izoluar. Ky përshkrim përfaqëson diskursin reformator të kohës, i cili e konsideronte emancipimin e gruas si një element të domosdoshëm të përparimit shoqëror dhe të modernizimit kombëtar. Përmes metaforës së gruas që jeton "si brenda një guaske", aq të ngjashme me vargjet baroniane:

"E mbyllur, s'del dot pa çarçaf e rojë,  
Mësuar në kafaz, as do të dalë,"

theksohet vazhdimësia e një realiteti shoqëror që kërkonte transformim. Në këtë mënyrë, artikulli i editorit të "Dritës", Veli Hashorvës krijon një lidhje historike mes përshkrimeve të udhëtarëve të huaj dhe diskursit reformator vendas, duke reflektuar projektin modernizues të elitave shqiptare të kohës. Megjithatë pavarësisht sensit kritik ndaj gjendjes sociale të gruas, ai nuk propozon një model radikal të emancipimit. Editori i gazetës "Drita", Veli Hashorva e bën të qartë se qëllimi nuk është që gratë të adoptojnë modele të jetës perëndimore që në atë kohë perceptoheshin si të tepruara, si p.sh. frekuentimi i kafeneve apo pjesëmarrja e lirë në jetën publike. Përkundrazi, ai kërkon një transformim gradual dhe moral të rolit të gruas, duke theksuar rëndësinë e arsimimit, të respektit dhe të trajtimit të saj si qenie njerëzore me dinjitet.

Kjo qasje reflekton një modernizim të moderuar, tipik për intelektualët shqiptarë të fillimit të shekullit XX. Ata synonin reformimin e shoqërisë, por pa një shpërbërje të plotë nga normat tradicionale. Gruaja shihet ende kryesisht në rolin e saj familjar – si nuse, nënë dhe vjehrrë – por kërkohet që ajo të ketë më shumë dinjitet, arsim dhe respekt. Artikulli është gjithashtu një shembull i rolit që luante shtypi në procesin e modernizimit social. Gazetarë dhe intelektualë si Editori Veli Hashorva përdornin shtypin e shkruar për të ngritur çështje të ndjeshme shoqërore dhe për të sfiduar disa zakone tradicionale. Duke kritikuar prindërit dhe burrat që nuk u japin grave arsim dhe liri, autori i drejtohet drejtpërdrejt lexuesit mashkullor, i cili në atë kohë përbënte pjesën më të madhe të publikut të gazetave. Kështu artikulli "Gratë tona" synon të krijojë një ndërgjegjësime sociale dhe të nxisë një reflektim mbi përgjegjësinë e burrave në ndryshimin e statusit të gruas. Ai duhet parë si pjesë e një diskursi më të gjerë reformator në Shqipëri dhe viteve 1920, kur shteti i ri shqiptar kërkonte të modernizonte institucionet dhe shoqërinë. Edhe pse i kufizuar nga mentalitetet e kohës dhe nga një

vizion ende tradicional për rolin e gruas, teksti përfaqëson një hap të rëndësishëm në debatet mbi emancipimin dhe arsimimin e grave shqiptare. Familja Hashorva në Gjirokastrë përfaqëson një shembull të emancipimit të gruas në vitet 1920, kur Hasibe Hashorva, kushurira e Veli Hashorvës, përfundoi kursin për arsimtare. Ajo shfaqet në një fotografi të vitit 1926, e lidhur me shkollën e vajzave "Koto Hoxhi" në Gjirokastrë, ku përmendet si pjesë e stafit mësimdhënës, në krah të drejtoreshës Uran Rumbo.<sup>9</sup> Kjo foto/dokument e vendos Hasibe Hashorvën në kontekstin e zhvillimit të arsimit të vajzave në Gjirokastrë gjatë viteve 20', një periudhë e rëndësishme për modernizimin arsimor dhe emancipimin e grave në Shqipëri. Prania e saj në këtë institucion dëshmon për rolin aktiv të grave në jetën publike dhe për përpjekjet për të zgjeruar mundësitë arsimore për gjeneratat e reja. Hasibe Hashorva ishte mësuese e Musine Kokalari, shkrimtares së parë femër shqiptare dhe një prej ikonave të mendimit intelektual shqiptar.

Vite më vonë, në romanin "Darka e gabuar" të shkrimtarit të shquar Ismail Kadare, personaliteti i Hasibe Hashorvës shfaqet sërish, tani si personazh. Në roman, ajo paraqitet si një zonjë arsimtare e aristokracisë të qytetit të Gjirokastrës që nuk e kupton ndryshimin e dhunshëm social që ka ndodhur në Shqipëri me ardhjen në pushtet të komunistëve, kur e ftojnë të marrë pjesë në mbledhjen e Frontit Demokratik, dhe për pasojë, kur dëgjon që e ndalojnë në

<sup>9</sup> Arkivi i Muzeut Kokalari, Gjirokastrë. Në qendër, ulur Urani Rumbo, drejtoresha e shkollës dhe në krah mësuesja Hasibe Hashorva. Musine Kokalari, rrjeshti i dytë, e katërta duke filluar nga e djathta



Edward Lear: Shtëpi në Gjirokastrë në jug të Shqipërisë, me këshjtjellën dhe akueduktin në sfond, 4 nëntor 1848.

<sup>8</sup> Edward Lear in Albania (London 2008), p. 155.

mes të rrugës për ti thënë se duhet të jetë në mbledhje, i ndodh një hemorragji. Ky episod ilustron kontrastin e ashpër midis zhvillimit të shoqërisë shqiptare në vitet 1930 dhe sistemit totalitar që u instalua më pas, duke shërbyer si reflektim kritik i transformimeve shoqërore dhe tensioneve midis traditës dhe ndryshimit të dhunshëm të humbjes së individualitetit.

Parë në këtë panoramë të gjerë të ndryshimeve sociale përgjatë viteve 20'-50' të shekullit të XX, editoriali i Veli Hashorvës i vitit 1920 duhet lexuar jo vetëm si një reagim ndaj një realiteti të caktuar shoqëror, por si pjesë e një diskursi më të gjerë historiko-social, ku projekti i ndërtimit kombëtar ndërthuret ngushtë me përpjekjet për transformimin e marrëdhënieve gjinore. Duke e konceptuar përmirësimin e statusit të gruas si kusht për përparimin e përgjithshëm të shoqërisë, ky tekst reflekton ndërgjegjësimin në rritje të elitave për rolin e arsimit si instrument emancipimi. Publikimi i tij pasqyron jo vetëm shqetësimet e kohës për shkollimin e femrës shqiptare, por edhe një klimë qytetare në Gjirokastrë që synonte zgjerimin e hapësirës arsimore për vajzat. Në këtë sfond, vëzhgimet e Justin Godart gjatë vizitës së tij në vitin 1921, mbi praninë e shkollave me klasa mikse<sup>10</sup> dhe përfshirjen e vajzave në arsim, dëshmojnë se këto ide nuk mbetën vetëm në planin e diskutimit, por filluan të materializohen në praktika konkrete, duke shënuar hapat e parë drejt një modernizimi shoqëror me bazë arsimore dhe qytetare.

<sup>10</sup> Justin Godart. Shqipëria në 1921. Shtëpia botuese: Klubi i poezisë, Tiranë 2015, f. 81

Gratë tona<sup>11</sup>

Kujtoni një breshkë që lind brenda guaskës së saj, nxjerr kokën dhe këmbët për një çast jashtë, dhe pastaj futet përsëri e mbledhet në shtëpinë e saj mbrojtëse. Kështu është gruaja jonë në Shqipëri; kështu janë nënat, motrat dhe vajzat tona.

Një vajzë, që në fillim, lidhet dhe mbulohet fort nga koka deri te këmbët me shumë rroba. Që këtu nis jeta e saj e mbuluar. Pastaj vijnë kujdeset dhe shqetësimet e prindërve, të cilët mundohen shumë që ajo të mos ftohet e të mos sëmuret.

Por e keqja më e madhe fillon më pas; edhe ajo pak liri që ka, i merret dhe fillon burgu i gjatë me të cilin është dënuar. Mbyllja zyrtare e një vajze fillon rreth moshës dymbëdhjetë vjeç. Më pas ajo jeton në një atmosferë të ngushtë: katër mure të trasha, dyer e porta të mbyllura me perde të rënda, me hekur, me dryna e pengesa të tjera – dhe kjo bëhet shoqëria e jetës së saj të mëvonshme. Dielli për to perëndon shumë shpejt.

Nëse ndonjëherë dalin pak jashtë për ndonjë nevojë, përsëri mbulohen dhe rëndohen edhe më shumë. Kur i shikoni në rrugë, nuk do të mendoni kurrë se ajo zonjë që kalon pranë jush është një qenie njerëzore si ju; nuk duket si jetë e gjallë dhe nuk ka asnjë shenjë që t'ju bindë për këtë. Ajo duket si një leckë që lëviz, me këmbë të zbehta e me mbulesa të bardha.

Por nuk mbaron me kaq; ajo mbyll edhe gojën. Mos qeshni: kjo është e vërtetë në kuptimin e plotë të fjalës. Ajo hesht sepse ka turp, sepse ka frikë, ose sepse kështu është mësuar. Kështu vazhdon kjo jetë deri sa të hyjë në varr, ku më pas mbulohet përgjithmonë nga dheu i rëndë.

Këto zakone shpesh shkaktojnë edhe pasoja të tjera; ato mund të shkatërrojnë jetën e një djalë të ri që lidh fatin me to dhe të nxijnë jetën e një familjeje. Një vajzë që nuk bëhet dot nuse e mirë, nuk bëhet dot as nënë e mirë.

Ne duam që shqiptarët të na kuptojnë për guximin që morëm duke kritikuar një mënyrë jetese që ecën në errësirë. Nuk qortojmë pa arsye; fajin më të madh e kanë shqiptarët që nuk reflektojnë, prindërit që nuk i edukojnë vajzat e tyre dhe burrat që nuk i mësojnë e nuk u japin lirinë për të cilën kanë shumë nevojë.

Burrat duhet të shohin atë që jeta u ka mohuar grave të tyre dhe të mos veprojnë në dëm të tyre. Gratë vuajnë dhe lëngojnë për atë që u mungon: për lirinë e tyre të shenjtë.

Por shqiptarët të mos mendojnë se ne duam t'i shohim gratë të dalin në bulevardet krah për krah me burrat, të shkojnë në kafene dhe të pinë birra. Jo, zonja; nuk kemi një qëllim të tillë. Ne duam që ato të trajtohen si njerëz, të mësojnë si njerëz, të flasin si njerëz dhe të mendojnë si njerëz. Vetëm kështu do të bëhen nuse të mira, nëna të mira dhe vjehrra me zemër të mirë, për të cilat kemi shumë nevojë.

Nëse nuk ndryshojmë dhe nuk bëhemi më njerëzorë, ato do të vazhdojnë të vuajnë nga burrat e tyre, të cilët shpesh i qortojnë dhe i dënojnë për arsye të vogla.

Bibliografi:

Arkivi i Muzeut Kokalari, Gjirokastrë  
 Arkivi i familjes Hashorva, Gjirokastrë  
 Bajron. Çajld Harold. Tiranë: 1973, përkthyer nga Skënder Luarasi  
 Dorian Koçi. Patritoti liberal Veli Hashorva dhe Gazeta "Drita" E Gjirokastrës (1920-1924), Pikëtakime historike, kulturore dhe identare, Vol.III, Bota Shqiptare, 2023, Tiranë  
 Editorial i Gazetës Drita nga Veli Hashorva " Gratë tona ", 13 maj 1920  
 Flutura Hashorva, 95-vjetori i gazetës "DRITA" e Gjirokastrës (1920-1924). Gazeta "Tirana Observer" 27.03.2015  
 Gazeta "Drita" Nr.2, prill 1920  
 Hylli i Dritës. Letërkëmbimi i Luigj Gurakuqit. Nr 3, mars 1944  
 Justin Godart. Shqipëria në 1921. Shtëpia botuese: Klubi i poezisë, Tiranë 2015  
 Kalendari i Vatrës i motit 1918, Shtypur në Shtypshkronjën e Gazetës Dielli 1918, edituar nga Fan Noli.

<sup>11</sup> Editorial i Gazetës Drita nga Veli Hashorva " Gratë tona ", 13 maj 1920

Me respekt të thellë dhe me mirënjohje të sinqertë ju drejtohem në këtë 25-vjetor të themelimit të Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë. Më 25 shkurt 2026 mora nga zoti Adnan Mehmeti ftesën për të qenë sot mes jush, një ftesë që përfshinte me bujari edhe bashkëshorten time, Dusita. Por më 17 janar 2026 kisha marrë një angazhim të rëndësishëm akademik në Kinë, të lidhur me përgatitje të gjata dhe me detyrime që nuk mund të shtyheshin. Kjo është arsyeja e vetme pse sot nuk jam fizikisht në këtë sallë. Ju kërkoi ndjesë me gjithë zemër dhe falënderoj atë që po e lexon këtë fjalim në emrin tim.

Sot nuk dua vetëm t'ju përgëzoj. Dua t'ju ftoj të mendoni për madhësitë e kësaj dite dhe për peshën e misionit që ajo na kujton. Përvjetorët janë të bukur kur nuk mbeten vetëm numërim vitesh, veprimtarish dhe botimesh, por bëhen çast reflektimi mbi arsyen e vërtetë të ekzistencës sonë. Prandaj pyetja ime e parë nuk është sa libra janë shkruar apo sa aktivitete janë zhvilluar. Pyetja ime e parë është më themelore: për çfarë qëllimi ekziston një shoqatë si kjo? Sepse asgjë nuk kuptohet plotësisht pa u kuptuar qëllimi i saj. Një anije nuk përcaktohet nga druri e velat, por nga lundrimi. Një mjek nuk përcaktohet nga manteli e instrumentet, por nga shërimi. Edhe një shoqatë letrare nuk përcaktohet nga ceremonitë, titujt dhe fotografitë, por nga misioni i lartë që u jep kuptim të gjithave.

Shikoni përreth me qetësi dhe mendoni për ata poetë, shkrimtarë e miq të fjalës që kanë qenë pjesë e këtij udhëtimi, por sot nuk janë në këtë sallë. Disa i ka marrë koha. Disa i ka larguar jeta. Disa i ka shpërndarë mërgimi. Kjo kujtesë e heshtur na mëson një të vërtetë të thjeshtë dhe madhore: jeta është tepër e shkurtër për t'u humbur në gjëra dytësore. Pikërisht për këtë arsye institucionet e kulturës duhet ta njohin me kthjelltësi arsyen e ekzistencës së tyre. Kur qëllimi mjegullohet, puna dobësohet. Kur qëllimi bëhet i lartë, edhe sakrificat merr dritë.

Nëse një shoqatë ekziston vetëm për të kremtuar vetveten, ajo bëhet darkë miqsh dhe jo institucion. Nëse ekziston vetëm për të pasqyruar pasionet kalimtare të ditës, ajo bëhet jehonë dhe jo udhërrëfyese. Nëse ekziston për të shpërndarë nderime pa kriter, ajo bëhet treg prestigji dhe jo strehë e vlerës. Por nëse ekziston për të kultivuar atë që është më e bukur në gjuhë, më e vërtetë në mendim, më e thellë në ndjenjë dhe më jetëgjatë në shprehjen njerëzore, atëherë puna e saj është fisnike. Letërsia nuk është luks i qytetërimit. Ajo i përket vetë formimit të njeriut. Njeriu nuk jeton vetëm me bukë, as vetëm me ligj, as vetëm me dobi; ai jeton edhe me kujtesë, me ritëm, me rrëfim, me mall, me vajtim dhe me fjalë që marrin trajtë të tillë sa bëhen të afta të zbulojnë se çfarë është jeta.

Për ne shqiptarët kjo e vërtetë ka peshë të veçantë. Historia jonë ka kaluar nëpër mërgim, sprova identitare dhe sfida të mëdha të ruajtjes së gjuhës. Prandaj një shoqatë e shkrimtarëve shqiptaro-amerikanë nuk është vetëm bashkim autorësh. Ajo është urë ndërmjet atdheut dhe botës, ndërmjet kujtesës dhe së ardhmes, ndërmjet brezit që solli me vete gjuhën dhe brezit që duhet ta marrë atë si pasuri të gjallë. Nëpërmjet saj fjala shqipe fiton vazhdimësi, kultura shqiptare fiton dinjitet dhe diaspora fiton një shtëpi shpirtërore ku mund të njihet me vetveten pa u mbyllur ndaj botës.

Pikërisht sepse ky rol është i madh, ju duhet të jeni rojtarë të standardeve. Standardet nuk ruhen vetë. Çdo epokë ka tundimin të ngatërrojë zhurmën me madhësinë, risinë me thellësinë, vështirësinë me urtinë dhe provokimin me guximin krijues. Mirëpo jo çdo gjë që trondit është e thellë dhe jo çdo gjë që duartrokitet është e shkëlqyer. Këtu fillon pesha e gjykimit. Nëse një institucion letrar heq dorë nga detyra për të dalluar, nderimi bëhet bosh, kritika kthehet në lajkatim dhe kultura bie rob i modës.

## Dy fjalë për 25-vjetorin e Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë

# Letërsia nuk është luks i qytetërimit: Ajo i përket formimit të njeriut

Nga Gjekë Marinaj



Prandaj ju duhet guximi për të gjykuar drejt. Të gjykosh drejt nuk do të thotë të jesh i ashpër për hir të ashpërsisë; do të thotë të dallosh atë që ka formë nga ajo që është e shpërndarë, atë që ka forcë të brendshme nga ajo që është e fryrë, atë që është e vështirë sepse është e thellë nga ajo që është e paqartë sepse mendimi ka mbetur i papjekur. Por gjykimi duhet të jetë i disiplinuar. Ai nuk mund të jetë prodhim klanesh, pakënaqësish private, miqësish të verbra apo frike. Miqësia është e çmuar, por ajo nuk duhet të zëvendësojë drejtësinë. Kudo ku nderimet jepen kryesisht sipas përkatësisë, një kulturë letrare nis të kalbet nga brenda.

Nuk është në natyrën time të jap këshilla, por edhe unë, si të gjithë ju, kam dëshirat e mia. Në këtë kontekst, shpreh dëshirën time të ruheni nga fryma e përçarjes dhe nga logjika e grupimeve të ngushta. Një kulturë letrare fillon të dëmtohet kur pyetja nuk është më "çfarë është më e mira?", por vetëm "kush është i yni?". Atëherë revistat bëhen kështjella, kritika bëhet luftë pozicionesh dhe gjuha kthehet në embleme fisie, jo në instrument të së vërtetës. Shoqata juaj duhet t'i rezistojë me dinjitet kësaj rrëshqitjeje. Ajo duhet të qëndrojë e përgjegjshme para një gjëje më të lartë: përkryerjes së shprehjes, vërtetësisë së mendimit dhe gjykimit të gjatë të kohës. Koha është gjykatëse më e ashpër se çdo komision. Heshtja nuk është aprovim. Prandaj mendoni gjithmonë për pasardhësit. Ju nuk jeni kujdestarë të një stine; ju jeni ndërmjetës midis të vdekurve që na lanë trashëgiminë dhe të palindurve që do ta marrin prej nesh.

Kjo kërkon nderim të thellë për gjuhën. Gjuha nuk është vetëm mjet me të cilin shprehen mendime të gatshme; ajo është vetë hapësira ku mendimi formohet. Kur gjuha dobësohet, dobësohet edhe gjykimi. Kur fjalët bëhen të fryra, të mjegullta ose të papërpikta, mendja e humb elasticitetin dhe shpirti humb përmasën. Për ne që jetojmë e krijojmë në Amerikë, shqipja është atdheu portativ i kujtesës sonë. Është vendi ku fëmijët tanë mund të takojnë gjyshërit

e tyre përmes fjalës edhe kur oqeanet i ndajnë. Prandaj ruajtja e forcës, saktësisë dhe bukurisë së shqipes është një nga detyrat më të larta të kësaj shoqate. Bukuria në gjuhë lind kur shprehja i përshtatet mendimit dhe ndjenjës, kur ritmi e mbështet kuptimin dhe kur fjala e saktë vihet në vendin e duhur.

Por ruajtja e gjuhës nuk mjafton nëse nuk formohen edhe ata që do ta përdorin atë. Një shoqatë që vetëm shpërblen arritjen e përfunduar dhe nuk kujdeset për brezin e ri lë bosh një nga detyrat e saj më fisnike. Përsosmëria nuk lind rastësisht. Ajo rritet me lexim, me modele të denja, me korrigjim të ndershëm, me ushtrim të vazhdueshëm dhe me bindje ndaj mjeshtërisë. Pyeseni veten me sinqeritet: a po kultivoni nxënësit të artit të fjalës apo po nderoni vetëm emra tashmë të njohur? A po mësoni dëgjimin, durimin, rishikimin dhe disiplinën krijuese? Asgjë e qëndrueshme nuk ndërtohet me ngut.

Dua t'ju drejtohem posaçërisht krijuesve. Mos e derdhni thjesht ndjenjën. Jepini ndjenjës formë. Arti nuk është shënim i çastit; arti është rend, përzgjedhje, lëvizje dhe përfundim i merituar. Një shkrimtar duhet të mësojë jo vetëm të shprehjet, por edhe të shohë; jo vetëm të ndiejë, por edhe t'i japë përvojës trajtë. Nëse vepra juaj është e vështirë, pyeteni veten me ndershmeri nëse kjo vështirësi vjen nga thellësia e jetës apo nga papjekuria e mendimit. Letërsia e madhe synon universalen përmes konkretes. Mos shkruani vetëm "për shoqërinë" në mënyrë abstrakte. Tregoni jetën e prekshe: një familje në tryezë, një miqësi që çahet, një njeri që e kupton vonë çmimin e heshtjes së vet. Lërimi pasojat të kenë peshë. Lërimi karakterin të gjenerojë fatin. Një vepër nuk duhet thjesht të vazhdojë; ajo duhet të shpaloset.

Metafora është një nga provat më të larta të mendjes krijuese, sepse aftësia për të parë ngjashmërinë midis gjërave të ndryshme nuk është vetëm stoli stilistike, por shenjë e një inteligjence që depërton në strukturat e botës. Prandaj kultivoni perceptimin dhe jo vetëm stilin. Vëzhgoni thellë. Jepuni gjërave formë me rreptësi. Flisni me qartësi. Krijoni

art që na ndihmon të kuptojmë si jeton njeriu, si zgjedh, si vuan, si fal dhe si ngrihet. Letërsia që mbetet në është ajo që bërtet më fort; është ajo që ndriçon më gjatë.

Shoqata juaj ka edhe një detyrim qytetar e kombëtar. Letërsia nuk i përket vetëm specialistëve; ajo i përket jetës së një populli. Nëse mbyllet në kode private dhe në admirime të ndërsjella, e tradhton qytetërimin po aq sa e tradhton artin. Detyra është të ngrihet e folura e përbashkët, të thellohet kujtesa e përbashkët dhe të rafinohet gjykimi i përbashkët. Një kulturë fisnikërohet kur gjuha e saj bëhet më e vërtetë, më e hollë, më e saktë dhe më njerëzore. Kjo vlen sidomos për diasporën shqiptare, e cila jeton mes dy botëve dhe ka nevojë për institucione serioze që ta mbajnë të gjallë trashëgiminë pa e mbyllur ndaj së ardhmes.

Dhe së fundi, le të jenë të drejta nderimet tuaja. Njeriu ka nevojë të nderojë atë që admiron, por nderimi duhet të përputhet me realitetin. Një çmim që nuk njeh vlerën e vërtetë dëmton si atë që e jep, ashtu edhe atë që e merr. Anëtarësimi pa meritë e zbraz dallimin nga kuptimi. Reputacioni i patestuar nga kritika shndërrohet në kotësi. Prandaj le të jenë vlerësimet tuaja të menduara, shpërblimet tuaja serioze dhe mirënjohja juaj e fituar. Sepse në fund në lojë nuk është prestigji ynë personal, por pyetja nëse letërsia do të mbetet një forcë e gjallë ndër njerëz.

Sot, në këtë 25-vjetor të themelimit të Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë, unë nuk dua vetëm t'ju përgëzoj për atë që keni arritur. Dua t'ju falënderoj për atë që keni ruajtur. Një çerek shekulli nuk është thjesht një numër. Është provë se një ide mund të marrë trup, se një përkushtim mund të bëhet institucion dhe se një grup njerëzish të mbledhur rreth vlerës së fjalës mund t'i japin kohës së tyre diçka që i reziston harresës. Ju keni mbajtur gjallë një vatër të rëndësishme të kulturës shqiptare në Amerikë. Keni krijuar hapësira takimi, botimi, kujtesë, vlerësimi dhe frymëzimi. Keni dëshmuar se shqipja mund të tingëllojë me dinjitet, me bukuri dhe me autoritet edhe në zemër të një bote të madhe dhe shumëgjuhëshe.

Për këtë ju nderoj me gjithë zemër. Ju nderoj për durimin e atyre që e mbajnë një institucion gjallë kur rrethanat janë të vështira. Ju nderoj për besimin se fjala e mirë nuk është humbje kohe, por investim në shpirtin e një bashkësie. Ju nderoj për secilin libër të shkruar me ndershmeri, për secilin takim të mbajtur me seriozitet, për secilin autor të ri që ka gjetur kurajë nga prania juaj dhe për secilin çast kur keni zgjedhur vlerën mbi lehtësinë. Kultura nuk ndërtohet me një gjest të madh të një dite; ajo ndërtohet me besnikëri të gjatë, me punë të qetë dhe me një shpresë që nuk lodhet.

Le të jetë ky jubile jo vetëm ditë feste, por edhe ditë ripërtëritjeje. Ruajeni gjuhën. Mbroni standardet. Formoni të rinjtë. Guxoni të gjykoni me drejtësi. Qëndroni larg klaneve. Nderoni me ndershmeri. Shërbejini jo vetëm emrit të shoqatës, por edhe jetës më të gjerë të bashkësisë shqiptare kudo ku ajo jeton, krijon dhe ëndërron. Unë besoj me gjithë zemër se më e mira ende nuk është shkruar. Besoj se përpara jush janë libra të rinj, zëra të rinj dhe vite të reja pune fisnike. Besoj se djemtë dhe vajzat që sot e dëgjojnë shqipen si gjuhë shtëpie, nesër mund ta ngrejnë atë në nivel arti nëse gjejnë përpara vetes institucione serioze, shembuj të ndershëm dhe dorë të shtrirë me mirësi.

Ju falënderoj nga zemra për dëgjimin, për besimin dhe për punën tuaj. Falënderoj me mirënjohje atë që po e lexon këtë fjalim në emrin tim. Ju uroj një 25-vjetor të ndritur, me gëzim, me përlulesi para rrugës së bërë dhe me guxim të ri për rrugën që ju pret. Uroj që të takohemi me shëndet, me vepra të reja dhe me krenari të përtërirë në 30-vjetorin e Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë. Gëzuar 25-vjetorin dhe qoftë gjithmonë e bekuar fjala shqipe në çdo vend ku ajo shkruhet, lexohet dhe dashurohet.

Një dokumentar artistik mund të transformohet gjatë realizimit dhe të marrë kahje dhe fizionomi të ndryshuar nga ideja fillestare, kur nga shpërhyrja dhe përfytyrimi i një personazhi të caktuar, rindërtohet konturi përreth tij drejt një konteksti përgjithësues social-historik.

Dokumentari më i ri i bashkautorësisë të suksesshme Mevlan Shanaj-regjizor dhe Natasha Lako-narracion: "Nikolla, i zemrës së Tiranës", përfaqëson një iniciativë të arrirë e disa-dimensionale në fushën e krijimtarisë së filmit dokumentar. Ai qëndron në vazhden e përpjekjeve të mëparshme të këtij bashkveprimi autorial, duke krijuar për nga fryma, origjinaliteti dhe noviteti, një model të konsoliduar profilizimi, të përafërt në tërësinë e zhvillimit dramaturgjik-narrativ si në dokumentarin pararendës "Rikard", kushtuar mbi një figurë po aq të shquar dhe emblematike arti, si Rikard Ljarja.

Në të dy këta dokumentarë, për Rikardin dhe për Zoraqin, vihet re një tendencë për të shkuar përtej një përqendrimi e thjeshtëzimi mbi një portret artisti. Të dy përfaqësojnë përpjekje serioze që krahas individualizimit artistik të ndërtojnë edhe tablo të një realiteti social-kulturor më të gjerë, ku figura individuale shndërrohet në pikë referimi e një epoke të tërë krijuesish dhe krijimtarie artistike. Pikërisht në këtë bashkëjetesë të historisë së individit brenda asaj kolektive, evidentohen vlera të qenësishme të këtyre veprave filmike.

Tek dokumentari "Rikard", me autorë Shanaj-Lako, publiku përveçse u shmall me një ndër aktorët më të dashur të ekranit, arriti edhe ta njohë më nga afër duke gjetur e zbuluar vlera që nuk i kishte prekur më parë dhe duke e konfiguruar Rikardin si krijues letrar, piktor të ndjeshëm dhe "poet" i cilësisë artistike që i tejkalon kufijtë e një profesioni të vetëm.

Në dokumentarin "Nikolla, i zemrës së Tiranës", ky model zhvillohet e merr hapësirë më të qëllimshme, ku narracioni filmik ndërthuret me elementë historikë e shoqërorë; me tablo të gjera të jetës social-ekonomike të një epoke "disi të harruar", ku figura e kompozitorit N. Zoraqi nuk shfaqet më si individ krijues, por si pjesë organike e jetës kulturore, sociale e urbane të Tiranës.

Në këtë kuptim, ky dokumentar nuk duhet parë si portret biografik por si film autentik. Ai shfaq qartë përpjekjen për të rindërtuar pjesë monumentale të memories, duke e rivendosur figurën e artistit brenda një rrjeti të gjerë marrëdhënies historike, estetike e tipologjike. Dhe kjo mund të konsiderohet vlerë e shtuar, duke e parë produktin filmik edhe si akt kujtese kulturore.

Nga ana tjetër, dokumentari tregon dukshëm përpjekjen për të rindërtuar kornizën origjinale të një mozaiku të cunguar, ku copëza guriçesh me ngjyrë nuk gjenden më në vend dhe përplotësohen me elementë gati të barazvlefshëm, që rindërtojnë monumentin mozaikal si të përafërt me origjinalin e trashëguar.

Pa dashur aspak të bëj krahasime të pavend, në tendencën e zhvillimit narrativ dhe në hapësirën filmike, përpjekja e autorëve më vjen "frymë" a "koncept" tipologjike të veçuar të krijimit artistik, ku në qendër të rrëfimit vihet një individ, e ku dekori "i paplotë" narrativ, ndërthuret me veçori elementësh të një konteksti, i cili është në koherencë të plotë të zhvillimit dramaturgjik-historik. Ky lloj koncepti, edhe se katërcipërisht i ndryshëm nga forca dramatike e historike, më vjen frymë këndvështrimi në disa krijimish të veçanta, që sot janë "epe" historike, si: "Odisea"(Homer); disa tragjedi si "Rikardi III", "Makbeth", "Jul Çesar" (Shakespeare); "Bota e së djeshmes"; "Dostoievski", "Niçe"(Zweig); "Goya"(Fojhtvanger), etj., ku mënyra konseguente historike e narracionit mbi një figurë reale, përbashkohet me elementë të panjohur/të njohur që rindërtojnë fizionomi edhe më të plotë mbi ngjarje, përjetime e personazhe të ngulitura fort në memorien e njerëzimit.

#### Perceptimi filmik dhe rikthimi i së vërtetës njerëzore.

Dokumentari "Nikolla, i zemrës së Tiranës" qëndron mjaft solid si shprehje filmi ku mbivendosen perceptimi dhe përndijimi, si rrallëherë të ndahen kaq qartësisht nga njëri-tjetri. Në këtë vepër filmike, ato bashkëjetojnë në mënyrë ekuivalente, të ndara por të njëkohshme

Dokumentari filmik, ngjarje sa kulturore aq dhe historike.

## "Nikolla, i zemrës së Tiranës", përpjekje në sukses e dokumentarit me bashkautorë Shanaj-Lako

Nga Agron Xoxa

mbi shqisat e shikuesit, duke krijuar një përvojë që nuk kufizohet në informacionin perceptues por edhe në përndijimin individual. Aq më tepër, kur në këtë dokumentar perceptimi fizik dhe përndijimi emocional ecin që në zanafillë si rrugë paralele që bashkohen në një pikë: në përjetimin e përplotë të figurës së kompozitorit Nikolla Zoraqi.

Nën një këndvështrim më të hollësishëm, prezantimi në fjalë has në mangësi objektive/subjektive materiale dokumentimi, ku bie në vëmendje mungesa e sekuancave filmike që dokumentojnë jetën dhe veprimtarinë e Zoraqit. Por kjo nuk i pengon autorët që të ndërtojnë në mënyrë perceptivë një narracion të mjaftueshëm, ngritur mbi një platformë informacioni ku vijnë elementë të ndryshëm të të njëjtit kontekst kohe e hapësire, që më shtynë të mendoj se janë këto mungësi që i kanë shtyrë bashkautorët të ecin mbi rrugë alternative, duke përdorur elementë të jashtëm shprehjesh vizive, të cilët edhe pse mund të duken dytësorë në pamje të parë, mendoj se marrin një rol me rëndësi në tërësi e në shërbim të zhvillimit dramaturgjik të dokumentarit.

Për kujtesë si shembull, ndërftimet filmike me fotografi të qytetit të vjetër të Tiranës, portrete artistësh të kohës dhe pamje të ndryshme arkivore, nuk janë thjesht dekor vizual, por pjesë përbërëse e strukturës narrative. Ato krijojnë atmosferën e kohës, japin kolorit historik dhe ndihmojnë shikuesin

të hyjë gradualisht në botën e madhe-të vogël ku u formua dhe jetoi Zoraqi. Këto pamje të paharrueshme sjellin përpara syve Tiranën e kahershme: rrugë e rrugica, bulevardet në ndërtim, vila, barraka dhe godina publike tipike, lulishte e ambiente qytetare, qoshe e kthina pazari apo copëza në pluhur të rrugëve pa asfalt, ku baritin të përzier-në të shpejtë a në qejf të tyre-fshatarë me qylafë apo qytetarë në kostum; zbulohet në të pothuaj ajo gjithësi, e cila ekziston si vegim në kujtesën e atij që i ka përjetuar e shkelur me këmbë.

Për shumë nga ne, këto sekuenca nuk janë thjesht ilustrime të panevojshme, por rikthim emocional i një realiteti, i cili nëpërmjet dokumentarit na rrugëton në një kohë, në të cilën gjithkush i asaj dhe i kësaj kohe nuk ka luksin e mohimit dhe harrimit të tyre. Prandaj dhe vetë, si njëri prej tyre, nuk ngopem dot me ato pamje të rrugëve a bulevardëve të Tiranës, ku më vjen sikur shoh Nikollën e ditur, të baresë mbi to, ashtu siç kam mundur ta shoh e dëgjoj nëpër to.

Nëse përjetimet njerëzore të asaj kohe privimesh të thella tentonin të këputnin nyjet e brishta të së pakohëshmes që qëndron përmbi; vjen një moment kur ndjen qartë, se shumë herë, "autocensura" e kahershme individuale rëndonte shumë më shumë tek secili, se censura zyrtare.

Dhimbja e atëhershme mund të ndihet ende sot në realitetin e përditshëm, në dukuri sa të

pangjashme aq dhe të ngjashme, që bëjnë të humbësh sensin kohë e hapësirë, ku secili ashtu si dikur, e gjen një mënyrë të bëjë vend në rrypin e ngushtë të frymëmarrjes së lejuar.

Të gjithë "ne" që e kemi përjetuar atë kohë nën petkun e frustrimit të përditshëm, e ndjenim dhe e njihim se edhe nëse ajo kohë kishte absurditete e "gjynahe" të vlerësuar si "jashtë morali", nëndheshëm, realiteti vazhdonte me po atë ritëm dhe po aq vrullshëm ciklin e jetës.

#### Arti "tabu", që rikujton ekzistencën e realitetit ndryshe e të përtejme.

Në një bisedë me Mevlanin pas "premierës" dhe duartrokitjeve, më ra në sy e shprehur disi me dhimbje një dukurie të paparalajmëruar. Hidhur i kishte ardhur atij, kur mes miqve të shumtë kish patur opinione që i konsideronin "të pahijshme e të pavend", fotot e njëpasnjëshme të trupit "nudo", që guximshëm shfaqeshin në sekuanca filmike të dokumentarit.

Kjo dukuri më solli prezent copëza të përjetuara që s'kam mundur t'i harroj. Jeta erdhi e tillë, kur në moshë të re dhe i lidhur me një vajzë skulptore, vizitoja shpesh studio piktorësh e skulptorësh të shquar të asaj kohe, ku ata, më tepër fjalamanë se unë në heshtje, shkëmbejnim pikëpamje mbi "të bukurën" në art dhe se si ajo shkrihej ndrydhshëm brenda kufijsh të brishtë me realen. Por vinte një moment kur dikush merrte guxim të largonte një perde, si të lënë pasdore e një skute nën hije, nga ku të shfaqej si për habi një botë tjetër, jo aq e panjohur por "tabu" e absurdit të kahershëm, e kur vetëm rasti mund të sillte të zbuloj copëza "ishujsh, zhytur në mister", sa të tronditnin atë botë krejt të harruar sot, e cila ndrydhte e kufizonte jetët tona, kthyer gati si ato të një asketi.

Në këto momente m'u kujtua se si një ditë, profesori në thinja dhe skulptori i shquar Janaq Paço, (vite e vite larg), në momente konfidi që ndodh midis një artisti të vjetër e një të riu, hapi me dorë dridhur një tablo të padukshme, ku gëlonin ngjethshëm e përplot në ngjyra të mahnitshme: tablo piktore; torse "nudo" prej balte a allçie; skica vizatimi trupash shtrirë e në këmbë; detaje marramendëse të një bukurie të përtejme të trupit të gruas.

Shumë vonë e takova përsëri atë, më të ngrysur e krrusur hidhërimesh, kur pyetjes mbi

(Vijon në faqen 9)

Film Dokumentar

Kushtuar Kompozitorit të shquar Nikolla Zoraqi

Në Teatrin Andon Zako Çajupi Korçë ditën e Mërkurë, 25 Mars ora 18:00

NIKOLLA I ZEMRËS SË TIRANËS

Shkrimtari nga Gjirokastra, miku im i Spalodhur i jetës dhe i letrave, Thanas Dino, i shton krijimtarisë së tij të pasur një tjetër gur themeli me librin me tregime “Lëndë për ëndrra”, që sapo qarkulloi. Me mbi tridhjetë libra në qarkullim romane, studime, hulumtime dhe publicistikë mbi jetën shoqërore të jugut të Shqipërisë, Dino ka dëshmuar se është jo vetëm rrëfimtari, por edhe mbledhës i kujtesës kolektive. Ky libër e çon një hap më tej këtë mision.

Që në titull, “Lëndë për ëndrra” shpall programin e vet estetik. Fjala lëndë nuk është metaforë e zbrazët; është materiali jetësor, faktik, ai brumë i fortë që zakonisht i përket publicistikës. Por këtu ndodh një shndërrim i rëndësishëm: fakti jetësor nuk mbetet raportim, as kronikë, as dokument. Ai bëhet maja që e ngre brumin në art. Bëhet shkëndijë për tregim, për figurë, për impulse të fuqishme dhe botë letrare me frymëmarrje të plotë.

Prej kohësh kam besuar dhe ky libër ma përforcon bindjen, se shumë nga shënimet publicistike të Thanasit janë fabula të gatshme për letërsi. Publicistika, sado e shkruar me mjeshtëri dhe e përmbledhur në libra, rrezikon të venitet me kalimin e kohës, të mbetet e lidhur pas momentit kur është shkruar. Tregimi, përkundrazi, ka jetëgjatësi. Ai hap dimensione psikologjike e shoqërore më të gjera, ndërton karaktere, krijon tension e dramë, përfton simbolikë. E çliron faktin nga data dhe e vendos në kohën e gjatë të letërsisë.

“Lëndë për ëndrra” është pikërisht ky akt transformimi. Libri nuk ndërton një histori të vetme lineare. Ai ndërton një univers, një komunitet që të kalon para syve si në një galeri tragjike. Çdo tregim shton një pjesë në të njëjtën trupë shoqërore. Nuk kemi një protagonist të vetëm, sepse protagonistë është vetë shoqëria me kodet, plagët, krenaritë dhe bëmat e saj.

Ëndrra ka qenë që nga kohët më të lashta një nga hapësirat më pjellore të imagjinatës letrare. Në heshtjen e natës, kur njeriu tërhiqet nga realiteti, lind një botë tjetër e çuditshme, e lirë dhe shpesh zbuluese. Edhe këto tregime janë shkëndijime ëndrras, halucinacione e makthe që kur i sheh njeriu zgjohet befas dhe i jetojnë gjatë në kujtesë. Shkrimtarët e mëdhenj të letërsisë botërore e kanë parë ëndrën jo vetëm si burim imazhesh dhe simbolesh, por edhe si një mënyrë për të hulumtuar shtresat më të thella të ekzistencës njerëzore.

Në vëllimin me tregime “Lëndë për ëndrra”, është një vijshëmëri e pritëshme në arritjet më të spikatura të krijimtarisë artistike të Thanas Dinos. Veç ndërtimit mjeshtëror të fabulës veçori kryesore mbetet mënyra se si ndërtohen figurat e grave. Ato pikturohen me një penel të fuqishëm e dëndësi dramatik, të gdhendura me mjeshtëri mbi një “lëndë të ashpër”, duke bartur një qëndrueshmëri dhe dinjitet që i tejkalon rrethanat historike dhe shoqërore.

Në tregime si “Qilari”, gratë që fshehin ushtarët armiq të luftës italo-greke, Ngjarja merr përmasa që i afrohen strukturës romaneske, pasi në to përqendrohen virtutet më të larta njerëzore. Ato vendosin njeriun mbi ideologjinë, mbi luftën dhe mbi të keqen, duke dëshmuar se vlera e vërtetë e jetës qëndron në humanizëm. Po në këtë linjë, tregimi “Luga e kishës së Stojanit” sjell me gjallëri përplasjen mes shkatërrimit dhe ringjalljes së besimit, për të theksuar se feja nuk përcakton thelbin e njeriut, por se ky thelb buron nga vlerat e tij shpirtërore.

Një tjetër shtresë e rëndësishme është ajo e zakoneve dhe e mentalitetit. Në “Prurësi i zakonit të ri”, theksohet se thyerja e traditës kërkon sakrificë, madje edhe gjak, pasi zakonet janë të rrënosura thellë në kohë dhe në ndërgjegjen kolektive. Kjo ide mishërohet përmes figurave të forta si Zangona, që qëllon nga frëngjia për të mbrojtur pragun dhe nderin dhe i pret gishtin me sapatë gjitonit që përpiket të kapërcejë murin e avllisë. Po kështu, Nënëmadhja e Topullarajve shfaqet si një figurë organizuese dhe udhëheqëse, duke tejkuluar edhe burrat në vendimmarrje. Të gjitha figurat e grave në libër kanë dinjitet me përmasa mitike.

Në tregimin “Oxhakët”, autori përdor një simbolikë të fuqishme për të demaskuar shtirjen dhe deformimin e identitetit shoqëror. Rindërtimi i shtëpive të udhëheqësit dhe shtimi i oxhaqeve të rremë shndërrohet në një akt

## Mozaik shënimesh për veprën e Thanas Dinos

# Midis kujtesës, historisë dhe fatit njerëzor

Nga Petro Çerkezi

grotesk, që në mënyrë ironike kthehet kundër vetë protagonistëve, duke përmbysur rendin natyror. Edhe qielli zemërohet dhe e kthen tymin, në dhomën ku do të flejë udhëheqësi. Ndërsa te “Veçili”, drama e kurbetit paraqitet me një gjerësi dhe intensitet tronditës, duke zbuluar plagë të thella të përvojës njerëzore. Po ashtu, “Nusja në vllah” del si një figurë konkrete që mbart dhe përfaqëson traumën e një komuniteti të tërë.

Ajo që e bën prozën e Thanas Dinos të veçantë është vëzhgimi i hollë dhe skrupuloz i realitetit. Autori nuk e kërkon dramën vetëm në kohë lufte apo trazirash, por edhe në ditët e zakonshme, duke zbuluar tensionet e fshehta të jetës së përditshme. Për këtë arsye, tregimet e tij nuk mbeten thjesht regjistrime të realitetit, por shndërrohen në struktura me dëndësi të lartë dramatike, ótov situatat konkrete marrin përmasa arketipale dhe përfaqësojnë një mentalitet, një kohë dhe një hapësirë të caktuar. Në këtë mënyrë, “Lëndë për ëndrra” afirmohet si një vepër ku përvoja individuale dhe ajo kolektive ndërthuren ngushtë, duke krijuar një univers letrar me forcë të veçantë shprehëse dhe me një thellësi të dukshme antropologjike.

Në librat publicistikë të Thanas Dinos ka me dhjetëra fabula të tilla material bruto jetësor, sfidë dhe nxitje për të kapur penën e për ta vendosur lëndën në një sfond tjetër. Këtu shihet qartë se përvoja e publicistit nuk humbet; ajo përthithet nga prozatori. Saktësia e vëzhgimit, ndjeshmëria ndaj detajit, njohja e strukturave shoqërore bëhen bazament për ndërtimin e tregimit. Mbi këtë bazë ngrihet dimension i letrar: tensioni, heshtja domethënëse, nderi si ligj paralel, turpi publik si gjykatë, fjala e dhënë si institucion.

Libri lëviz mes hasmërisë, politikës, folklorit dhe besëtytnisë, por nuk shpall teza dhe nuk moralizon. Gjenezja e tyre vjen nga gojdhana, nga miti, nga ajo trevë folklorike burimore që vetëm realiteti ta bën dhuratë një lëndë të tillë. Ngjarjet vendosen përpara nesh me një kthjelltësi që i lejon të flasin vetë. Në disa raste vendimi merret me pushkë, në të tjera me heshtje. Regjimet ndryshojnë, por mënyra si peshohet nderi mbetet. Dhe pikërisht këtu qëndron forca e letërsisë: ajo na bën të kuptojmë se mentalitetet jetojnë më gjatë se sistemet.

Forca e këtij libri qëndron te kthjelltësia e vështrimit. Dino nuk e mitizon realitetin, por as nuk e zhvesh nga dinjiteti i tij. Ai e sheh komunitetin si një organizëm kompleks, me dritëhijet e veta, me plagët dhe krenaritë e veta. Çdo rrëfim bëhet një dritare për të kuptuar jo vetëm atë që ka ndodhur, por mënyrën se si një shoqëri mendon, gjykon dhe e shkruan kodin e vet moral.

Në një kohë kur kujtesa kolektive shpesh reduktohet në slogane ose në nostalgji të sipërfaqshme, “Lëndë për ëndrra” vjen si një akt i përgjegjshëm letrar. Është një vështrim i thellë mbi një mentalitet që vazhdon të jetojë edhe pasi koha ka ndryshuar. Një libër që nuk ofron vetëm histori, por “lëndë” për të kuptuar ëndrrat, frikërat, kodet dhe ndërgjegjen e një shoqërie të tërë. Me këtë vëllim, Thanas Dino jo vetëm pasuron bibliografinë e tij të gjerë, por rikonfirmon rolin e tij si një nga kronikanët më të rëndësishëm të shpirtit dhe historisë shoqërore të jugut shqiptar, një zë që di të dëgjojë, të mbledhë dhe të rrëfejë pa bujë, por me peshë.

“Lëndë për ëndrra” nuk është thjesht kujtesë e një kohe apo e një krahine. Është dëshmi se faktet e jetës, kur kalojnë nëpër filtrin e artit, fitojnë një dimension më të thellë dhe më universal. Është provë se publicistika mund të jetë farë për letërsi të begatë. Kështu, Thanas Dino vazhdon ta kthejë përvojën jetësore në prozë me peshë, me frymë dhe jetëgjatësi.

**Në kufijtë e ndryshimit:  
profili i prozës së thanas dinos**

Romanet e Thanas Dinos na japin profilin e një shkrimtari tashmë të konsoliduar, që përshkruan dy botë, të vjetrën dhe të renë, duke na dhënë tangjenten e takimit të tyre, një takim tronditës që ngjan çlirues, por po aq prangues, sepse qelizat kanceroze i kanë hedhur metastazat kudo në trupin e shoqërisë dhe janë mentaliteti, paragjykimet dhe propaganda e shfrenuar e gënjeshtres e një sistemi dhune dhe frike.

Veprat kanë protagonist të dyfishtë, heroin e traumatizuar dhe shkrimtarin, dhe ngjajnë me romane të disfatës dhe të shpresës, me protagonistë që kalojnë në një filtër katharsis dhe hedhin hapin e parë në një shkallë që ngjan me shkallë triumfi, por edhe dyshimi, një hap i grackuar nga e kaluara që nuk i ndahet kohës dhe njeriut, sepse ka rrënjë kaq të thella që përherë do të nxjerrë një lastar të helmatisur, si Hidra e Lernës që, po i preve një kokë, të tjera të padukshme i mbijnë.

Romanet e Dinos sjellin vlerat epokale të ndryshimeve dhe përmbysjeve shoqërore. Është hapi i madh drejt një bote të lirë demokratike, ai zhvillim që në dukje kërkon të jetë i natyreshëm, por në të vërtetë vjen me dallgëzime, tronditje, goditje dhe plagë. Koha hedh shkëndija ylberore të një kohe iluzionare, të mbushur me konflikte, përmbysje dhe deziluzione. Liria nuk paraqitet si një zonjë lozonjare, por si një gjendje që kërkon përherë flijime dhe kërkon haraç. Heronjtë e vërtetë ndeshen me fantazmat.

Dino ka një vepër shumëplanëshe dhe polifonike. E djeshmja dhe e sotmja, vetjakja dhe shoqërorja, tragjika dhe groteskja, Don Kishotët dhe Sançot, janë të pandashëm në një shtrat lumor ku ndeshen të gjitha dallgët dhe stinët. Autori i vë dorën njeriut që ndodhet mbi greminë dhe e tërheq, vë gishtin mbi plagën e njeriut, viktimë e krizës morale dhe e luftës psikologjike të një ndërgjegjeje të turbullt e pa busull. Heronjtë e tij gjenden në kufijtë midis reales dhe ireales, mes ankthit dhe frikës, mes kërcimit drejt së resë dhe rrëzimit në kaosin e zhgënjimit dhe ankthit ekzistencial të njeriut që gjendet lakuriq në një botë zbrazëtie, ku gënjeshtria dhe propaganda i kanë hyrë deri në palcë, i kanë turbulluar shikimin dhe i kanë shtrembëruar shtyllën kurrizore.

Tek libri i dyfishtë “Fjalët shihen” me publicistikë dhe romanin “Gjumi në shtëpinë e pritjes”, autori pohon: “Është gazetaria e një shkrimtari dhe letërsia e një gazetari”. E tillë është gjithë krijimtaria e tij, ku në qendër është njeriu. Dino është një mjeshtër hulumtues i publicistikës gojore, i mitit dhe i gojëdhënës, një kronist i vërtetë, një shprehës i fjalës së gjallë dhe një mag i historisë që shndërrohet në letërsi të mirëfilltë. Librat e tij i kam lexuar pothuajse të gjitha, shpesh që në dorëshkrim, duke shprehur përshtypjet dhe vërejtjet e mia gjatë procesit të përpunimit krijues



para botimit, pasi i daktilografonte im vëlla, Odhisea.

Libri “Mbi tokën e ngushtë”, që pasojnë “Vetëvrasje mbi trëndafil” dhe “Diell i ulët”, shënon një pjekuri në përpjekjen për të lidhur dy epokat e vendit, në fundin e një shekulli dhe në agun e një tjetri. Janë një sagë e dhimbëshme e përmbysjes e përmbysjes epokale, me një qiell përherë gri dhe një tokë tërmetore që është vështirë të mbash ekuilibrin e të glesh vend të mbështetesh, janë romane të kronikës, me një galeri personazhesh të ndryshëm dhe njëherazi të ngjashëm, që mbartin secili pas vetes kohën që kanë jetuar dhe që jetojnë, dramën dhe plagën, dëshminë dhe denoncimin e heshtur e të mprehtë.

**Bota që kërkon syrin e së vërtetës**

Romani “Ciklopi i Glinës” i Thanas Dinos nuk është thjesht një rrëfim me shpërthime të forta dramatike; është një udhëtim i guximshëm në kufijtë e dy botëve, jo vetëm gjeografike, por edhe shpirtërore, politike dhe historike. Me pikënisje pakicën kombëtare greke në Shqipëri, dhe më konkretisht në Epirin e Veriut, autori end një histori shumëplanëshe që pret në mes shekullin e njëzetë, me të gjitha tragjedite, fanatizmat, rrënojat, por edhe shpresat për shpëtim.

“Ciklopi” i titullit, Dhosi, është një hero tragjik, pothuajse mitologjik. Me një sy, i mbijetuar, dëshmitar dhe viktimë e një sistemi që për dekada shtypi çdo gjë të ndryshme dhe të lirë. Njëri sy i tij shikon nga e kaluara; tjetri, i humbur, i ruajtur si mbetje apo trashëgimi, simbolizon verbimin e dhunshëm nga një sistem që, fatkeqësisht, la gjurmë tragjike në historinë e popujve. Por Dino nuk shkruan për të justifikuar apo për të akuzuar, por për të kujtuar, për të ruajtur dhe për të zbuluar të vërtetë.

Gjuha e tij, herë e ashpër dhe herë lirike, të rrëmben nga kalimet e fshehta të Kakavijës deri në bodrumet e hetuesive, nga heshtja e internimit deri te protesta e fuqishme e trupave të zhveshur në kufi. Personazhet e tij, herë realë e herë pothuajse alegorikë, marrin frymë brenda së vërtetës së kujtesës historike.

Në kufirin mes dy atdheve dhe dy botëve, gjuha bëhet streha e fundit e identitetit, besimi (jo vetëm fetar, por edhe njerëzor) bëhet veprim, dhe drejtësia mbetet, shpesh, një ëndërr e shtypur.

Me këtë përkthim, publiku lexues grek tashmë ka qasje në një vepër thellësisht të rëndësishme, jo vetëm për dokumentimin e përvojës së Epirit të Veriut, por edhe për kontributin e saj më të gjerë në kuptimin e gjendjes ballkanike: një bashkëjetesë vazhdimisht në kufij, por edhe një njerëzi që këmbëngul të lulëzojë përmes çarjeve. Sepse, në fund, “Ciklopi i Glinës” nuk është gjë tjetër veçse secili prej nesh, që e sheh botën përgjysmë dhe kërkon syrin tjetër, të vërtetën, shpresën, vendin dhe jetën që iu mohuan.

**përballë pasqyrës së historisë**

Në romanin e tij të dytë, “Përdorimi”, botuar në të njëjtin libër Thanas Dino rikthehet me një forcë të rrallë shkrimi për të ndriçuar faqet më të errëta të historisë së re shqiptare. Me sfond ngjarjet e vitit të mallkuar 1997, një vit që shënoi thellë ndërgjegjen kolektive të një populli, autori nuk kufizohet në një regjistrim

të thjeshtë të krizës. Përkundrazi, ai depërton me një ndjeshmëri të admirueshme në shpirtat e njerëzve që u bllokuan në të: politikanë, ushtarë, qytetarë, madje edhe roje të thjeshta apo rrëfimtari të vetmuar.

Profesioni i gazetarit e lëviz rrëfimin midis realizmit dokumentar dhe thellimit të brendshëm letrar. Dino pyet pa predikuar, nëse plagët e një vendi mund të shërohen pa të vërtetë, pa falje, pa një introspeksion kolektiv. “Lufta” që ai përshkruan nuk është vetëm politike apo gjeografike. Është thellësisht morale, pothuajse ekzistenciale, një luftë brenda njeriut dhe shoqërisë, që përballet me fajin, pendimin, harresën dhe kujtesën.

Gjuha e Dinos, e thjeshtë, e mprehtë dhe e saktë, e çon lexuesin në një kohë që duket njëkohësisht e largët dhe tronditshme e pranishme. Gjykoj, Tirana, Jugu dhe Veriu nuk janë vetëm vende, por peizazhe kujtese, traume dhe shprese. Tingulli i kambanës, zëri që rikthehet në manastirin që ngjan si një zgjim në fillim dhe në fund të romanit, nuk është thjesht një simbol shpëtimi. Është një pyetje: a mundet një shoqëri të rikthehet në kohezionin e saj moral pas shembjes dhe reflektimit kolektiv: “a do të ketë vallë pendim apo vetëm përdorim? Do të shlyhen mëkatet apo thjesht do të përdoren sërish?”

Ky libër lexohet si kronikë, si britmë dhe si lutje. Është një dëshmi thellësisht njerëzore që i tejkalon kufijtë e Shqipërisë dhe, do të thosha pa hezitim, edhe të Ballkanit, dhe flet për të gjithë popujt që u thirrën, apo do të thirren të qëndrojnë përballë pasqyrës së historisë së tyre me vështrimin nga e ardhmja.

### Thanas Dino në dialog me prozën bashkëkohore greke

Letërsia e Thanas Dinos zë një vend të veçantë në hapësirën e ballkanit të jugut, sepse ajo ndërton një urë midis përvojës historike dhe dramës së brendshme të njeriut. Në këtë kuptim, krahasimi i vlerave të veprës së tij me ato të tre shkrimtarëve bashkëkohorë të epirit grek, si Dhimitris Haxhis, Kristoforos Milionis dhe Sotiris Dhimitriu, nxjerr në pah një afërsi tematike të dukshme, por edhe dallime të rëndësishme në mënyrën e trajtimit të historisë dhe njeriut.

Në veprën e Dhimitris Haxhis, sidomos në librat “Fundit i qytetit tonë të vogël” dhe “Libri i dyfishtë”, historia shfaqet si një forcë që vepron në heshtje mbi jetën e njerëzve. Personazhet jetojnë në periferi të zhvillimeve të mëdha, por mbartin mbi vete peshën e tyre. Vlera themelore këtu është dinjiteti njerëzor përballë humbjes dhe shpërbërjes së botës së vjetër. Kujtesa shndërrohet një formë rezistence, ndërsa vetëdija dhe kërkimi i identitetit bëhen boshti i ekzistencës moderne. Tek ky autor, historia është një sfond i brendësuar, një rrjedhë që formëson njeriun në mënyrë të heshtur dhe reflektuese.

Në këtë pikë, proza e Thanas Dinos afrohet me të, por edhe ndahet dukshëm. Edhe tek Dino historia nuk është një nocion abstrakt, por një forcë konkrete që ndërhyr në jetën e individit. Megjithatë, ndryshe nga qasja më e përmbajtur e Haxhiut, tek Dino ajo shndërrohet në një mekanizëm dramatik, shpesh i pamëshirshëm. Në romane si “Prishja” apo “Dimra luftime”, “Në mes” apo “Në qafë” personazhet nuk janë vetëm dëshmitarë të historisë, por viktima dhe bartës të saj. Ata jetojnë në një realitet ku dhuna, përndjekja dhe ndryshimet e identitetit nuk janë përjashtime, por norma.


Kjo e çon prozën e tij drejt një realizmi tragjik. Njeriu tek Dino gjendet i përfshirë në një rrjet forcash që e tejkalojnë, ndërsa përpjekja për liri dhe vetëpërcaktim shoqërohet gjithmonë me plagë, iluzione dhe zhgënjime. Liria nuk paraqitet si një gjendje e dhënë, por si një proces i dhimbshëm që kërkon sakrificë. Në këtë aspekt, vepra e tij fiton një dimension epokal, duke pasqyruar përmbyset e mëdha shoqërore dhe morale të kohës.

Në krahasim me Kristoforos Milionis, ndryshimi bëhet më i qartë. Në veprat e Milionit, si “Kallama dhe Akeron”, Epiri shfaqet si një hapësirë kujtese dhe reflektimi. Historia nuk është aq një forcë që shkatërron, sa një terren meditimi ku individit përpiqet të kuptojë të kaluarën. Toni është më i qetë, më introspektiv. Kujtesa nuk është plagë e hapur, por një proces i ngadaltë rikthimi dhe përpunimi.

Ndërsa tek Dino, kujtesa është e ngarkuar me tension dhe dhimbje. Ajo nuk është vetëm rikujtim, por prani e gjallë që ndikon në të tashmen. Personazhet e tij nuk reflektojnë thjesht mbi të kaluarën, por e përjetojnë atë si barrë që nuk i ndahet kurrë. Kështu, në vend të një meditim të qetë, kemi një përplasje të vazhdueshme midis njeriut dhe ngjarjeve historike.

Nga ana tjetër, Sotiris Dhimitriu i afrohet botës njerëzore nga një kënd tjetër. Në vepra si “Të dëgjoj mirë emrin tënd”, ai fokusohet tek historia e vogël, tek individit i thjeshtë dhe jeta e përditshme në komunitetet periferike. Gjuha e tij është e lidhur fort me të folmen popullore, ndërsa rrëfimi ndriçon brishtësinë dhe vetminë e njeriut.

Edhe këtu ka një pikë takimi me Dinon, sidomos në interesin për njeriun e zakonshëm dhe për botën e komuniteteve të vogla. Por ndërsa Dhimitriu ndalet tek detaji intim dhe emocional, Dino e zgjeron këtë botë në një panoramë më të gjerë historike dhe shoqërore. Tek ai, individit nuk është vetëm një genie e vetmuar, por një njeje ku kryqëzohen forca historike, ideologjike dhe kulturore, ndërsa përsa i përket gjuhës dhe Dino preferon gjuhën dialektale. Një element tjetër thelbësor i prozës së Dinos është karakteri i saj polifonik dhe shumëplanësh. Në veprën e tij ndërthuren e djeshmja dhe e sotmja, individualja dhe kolektivja, tragjikja dhe groteskja. Personazhet lëvizin në kufijtë



midis reales dhe ireales, midis shpresës dhe zhgënjimit, duke krijuar një univers ku gjithçka është në lëvizje dhe në konflikt. Kjo e bën veprën e tij një lloj kronike të gjallë të shoqërisë në transformim.

Në këtë drejtim, ai shfaqet si një kronist i historisë së padukshme, i atyre jetëve dhe fateve që nuk regjistrohen në narrativat zyrtare. Ashtu si tek Haxhiu, edhe këtu kemi një interes për njeriun dhe dinjitetin e tij, por Dino e çon këtë interes në një dimension më të errët dhe më dramatik, duke nxjerrë në pah jo vetëm qëndrueshmërinë, por edhe deformimin dhe krizën morale. Në përfundim, krahasimi i Thanas Dino me Dhimitris Haxhis, Kristoforos Milionis dhe Sotiris Dhimitriu tregon se të gjithë ndajnë një hapësirë gjeografike dhe bosht të përbashkët tematik, marrëdhënien e njeriut me historinë, kujtesën dhe identitetin. Megjithatë, mënyra se si secili e trajton këtë bosht është e ndryshme.

Haxhiu thekson dinjitetin dhe vetëdijen, Milionis reflektimin dhe kujtesën, Dhimitriu përditshmërinë dhe intimen, ndërsa Dino i përmbledh të gjitha këto në një prozë të ngarkuar me tension historik dhe dramë ekzistenciale. Pikërisht kjo e bën veprën e tij një nga dëshmitë më të fuqishme të përvojës ballkanike, ku historia nuk është thjesht e kaluar, por një forcë që vazhdon të jetojë dhe të formësojë fatin e njeriut.

### Vlerat stilistike të prozës së Thanas Dinos në disa kritika

Kritika shqiptare, përmes zërave si Sadik Bejko dhe Josif Papagjoni etj., e shohin prozën e Thanas Dinos si një ndërthurje të fuqishme të historisë me përjetimin artistik. Siç thekson Bejko, “Dino e kthen ngjarjen historike në përjetim letrar”, duke e bërë lexuesin jo thjesht dëshmitar, por pjesëmarrës në dramën kolektive.

Në këtë rrëfim, sipas tij, kemi një tekst “të dendur, të mbushur me jetë dhe me zëra që vijnë nga kujtesa kolektive”, çka i jep prozës së Dinos një karakter polifonik dhe një lidhje organike me historinë e jetuar. Po në këtë linjë, kritika vëren se autori “ndërton një afresk të gjerë njerëzor ku historia, zakoni dhe miti bashkëjetojnë”, duke e ngritur rrëfimin përtej një kronike të thjeshtë në një strukturë me thellësi antropologjike.

Një tjetër tipar i theksuar është gjuha. Ajo cilësohet si “e fortë, e ngarkuar dhe me energji të brendshme”, një gjuhë që nuk përshkruan vetëm, por shtyn përpara rrëfimin dhe krijon tension të vazhdueshëm artistik. Kjo energji lidhet edhe me përvojën e autorit si gazetar, për të cilën është thënë se ai “gërmon në histori me syrin e gazetarit dhe e rindërton me ndjeshmërinë e shkrimtarit”.

Në planin estetik, Josif Papagjoni thekson se “tek Dino tragjikja dhe groteskja ndërthuren natyrshëm”, duke krijuar një botë ku dhimbja, ironia dhe absurdi bashkëjetojnë. Kjo ndërthurje e bën prozën e tij një pasqyrë të thellë të realitetit historik dhe njerëzor, sidomos në periudhat e krizës. Po ashtu, në analizat për romanet e tij theksohet se rrëfimi “lëviz mes realitetit dhe simbolit”, duke marrë shpesh një dimension paralajmërues për fatet shoqërore dhe historike. Kështu, vepra e Dinos nuk mbetet vetëm dëshmi, por bëhet edhe reflektim dhe interpretim i kohës.

Në përfundim, kritika shqiptare e përmbledh stilin e Thanas Dinos si një prozë të dendur, të fuqishme dhe shumëdimensionale, ku historia shndërrohet në art, kujtesa në rrëfim dhe përvoja kolektive në një univers letrar me intensitet të rrallë.

(Vijon nga faqja 7)

fatim e atyre “nudo-ve” iu përgjigj me një gjest shpërfillës me dy duart, si të donte të asaj kohe, edhe nëse shfaqeshin të autocensuruar në përjetime të parrëfyshme dëshpërimi, ato kostelacione yjesh në jetë, njësoj sikur të kishte fundosur me po ato duar Atlantidën e tij të përjetshme.

Rikthyer tek dokumentari i Mevlanit dhe Natashës, në planin individual ato pamje “nudo” në sekuenca të bollshme filmike zbuluan një Zoraq tjetër, përtej kompozitorit pedant në jetën e përditshme, por djaloshin dhe burrin që dashuron, frymëzohet e “ngërthehet” me trup me bukuritë e fshehura femërore si çdo artist i vërtetë.

Në plan të gjerë, ato pamje rrëfenin një realitet ndryshe, ku artistët të asaj kohe, edhe nëse shfaqeshin të autocensuruar në publik, mbeteshin po ata njerëz të jetës së zhurmshme e të gjallshme; adhuronin e dashuronin me shpirt e trup magjinë e trupit, si gjithkush tjetër. Prandaj e për këtë arsye mendoj se ato “nudo” në atë dokumentar nuk ishin bukuri e tepërt dhe e pavend, por rikthim në kujtesë i një të vërtete që për shumë e shumë vite ishim të detyruar ta përjetonim në heshtje.

### Arkivat, mungesat dhe sfidat institucionale mbi memorien artistike.

Në këtë kuadër, bëhet e pashmangshme të mos ndalem tek një problem që nuk lidhet vetëm me dokumentarin në fjalë, por mbi gjendjen e memories kolektive dhe pamundësinë e çdonjërit për t’u përafuar me materiale të domosdoshme informimi mbi një autor. Në rastin e dokumentarit mbi Nikolla Zoraqin, kjo mungesë bëhet e dukshme. Autorët janë detyruar të punojnë mbi materiale të kufizuara, të cilat nuk arrijnë të pasqyrojnë plotësisht dimensionin e një krijuesi të këtyre. Nga ana tjetër, kur këto mangësi hasen shpesh në kohë që kanë patur teknologji adekuate për t’u arkivuar, nuk mund të konsiderohen më thjesht pasoja rastësie apo kufizime të teknikës së kohës. Ato flasin qartë dhe janë rezultat i një pakujdesie të theksuar institucionale ndaj ruajtjes e mirëmbajtjes së trashëgimisë kulturore. Ka ardhur koha, kur Institucionet studimore, shkencore dhe kulturore, në sikron të zhvillojnë krahas projekteve të rikujtimit teknik dhe ruajtjes, të zhvillojnë projekte për digitalizimin e veprave skenike shqiptare. Nëse nuk do bëhet në kohë, historia do humbë pasuri të vyera e të papërsëritshme të kulturës sonë kombëtare.

Në mënyrë të pafalshme, mungesa e materialeve filmike mbi vepra skenike madhore të Zoraqit, si operat “Komisari” dhe “Paja”; apo mungesa të karakteri tjetër, si tek baletet “Cuca e Maleve”, “Tokë e Pampushtur”, “Gjenerali Ushtrisë së vdekur”, “Shote dhe Azem Galica”, “Joniada”, etj., ku hasen mangësi të një hapësire teknike më tepër të mohuar se harruar; kur të paktën arkivi i Teatrit të Operës, ai i Radio-Televizionit shqiptar e biblioteka, duhet të ekzistojnë të përshtatura në teknologji të kohës. Ato vepra si dhe dhjetra të tjera kompozitorësh të shquar si Zoraqi, nuk janë vetëm pjesë e historisë muzikore, por etapa të rëndësishme të zhvillimit të teatrit muzikor skenik shqiptar dhe mungesa e tyre nuk prek vetëm Zoraqin, por edhe atë plejadë krijuesish të talentuar, të pasionuar e të ndritur të historisë së kulturës kombëtare.

Nuk është e tepërt të kujtoj se si vepra kolosësh të artit muzikor si A.M. Gjoka, K. Kono, L. Antoni, Ç. Zadeja, P. Jakova, T. Daia, T. Harapi, R. Dhomi, Z. Ballata, Gj. Simoni, A. Papparisto, K. Lara, etj., etj., dergjen nën pluhur. Por, po aq shqetësuese është mungesa e materialeve në arkiv, mbi të gjitha atij të Operës, që lidhen me ekzekutimin në publik apo regjistrim të dirigjentëve të mirënjohur e të vërtetë, si Mustafa Krantja, Rifat Teqja, Ermir Krantja, Bujar Llapaj, etj., të cilët kanë luajtur rol determinues në zhvillimin e jetës artistike të Operës shqiptare.

Kjo vlen edhe për emra pafund artistësh të shquar e të paharruar solistësh lirikë dhe të baletit shqiptar, emrat e të cilëve, për nga cilësia dhe numri i tyre, është e pamundur të listohen në këtë rast.

Kjo situatë ngrë pikëpyetje mbi përgjegjshmërinë e institucioneve për ruajtjen, transmetimin dhe digjitalizimin e memories artistike. Institucione të specializuara që krijojnë strategji të qëndrueshme mbi artet, si Akademia e Shkencave, Teatri i Operës dhe Baletit, Radio Televizioni, Biblioteka Kombëtare, Universiteti i Arteve, etj., kanë detyrime institucionale në plotësimin, në çdo formë e mjet, të mangësive esenciale për ruajtjen e historisë së arteve kombëtare.

Në këtë kuptim, problemi i mungesës së materialeve arkivore nuk është vetëm çështje teknike, por edhe vizion udhëheqës kulturor.

Këtu qëndron edhe një ndër sfidat e vërteta për ruajtjen e kulturës shqiptare, si provë shpirtërore e obliguese e risistemimit, ruajtjes dhe kultivimit të dashurisë nëpër breza mbi artet e një periudhe të trashëguar që s’mund të harrohet, si një trashëgimi që për fat të keq mbetet e shpërndarë, e paorganizuar dhe e rrezikuar nga harresa.

Me ndarjen nga jeta në moshën 87-vjeçare M të piktorit **Skënder Kamberi**, arti shqiptar humbi një nga figurat e tij më të spikatura, një mjeshër të penelit që për më shumë se gjysmë shekulli ndërtoi një univers të pasur ngjyrash, emocioneve dhe kërkimesh të pandërprera artistike. Biri i Vlorës, ai mbetet një nga themeluesit e shkollës së pikturës në këtë qytet dhe një nga zërat më autentikë të artit pamor shqiptar.

Piktori Skënder Kamberi i përket brezit të parë të piktorëve nga Vlora që mbaruan studimet në Akademinë shqiptare të arteve. I diplomuar në Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë në vitin 1965, në atelietë e Danish Jukniut dhe Vilson Kilicës, Kamberi u kthye menjëherë në Vlorë, ku hodhi themelet e një tradite të re artistike. Si pedagog i parë në shkollën artistike "Naim Frashëri", ai formoi breza të tërë artistësh, duke u bërë jo vetëm krijues, por edhe një figurë kyçe në edukimin dhe emancipimin estetik të qytetit. Që me mbarimin e studimeve artisti Skënder Kamberi ka marrë pjesë në të gjitha ekspozitat dhe konkurset lokale dhe kombëtare, duke tërhequr vëmendjen e publikut e të kritikës së kohës.

Që në fillimet e tij, Kamberi u shfaq si një **artist i pazakontë dhe "rebel" në thelb**, i cili, edhe brenda kufijve të realizmit socialist, kërkonte hapësira të reja shprehjeje. Ai solli një mënyrë të papritur në ndërtimin e kompozimeve historike, duke shmangur skemat ilustrative dhe duke i dhënë veprës dimensionale monumentale, shpesh të mbushura me tension dramatik, por edhe me nota lirike. Tablo të tilla si *"Buka e duarve tonë"*, *"Demonstrata e bukës, 1942"* apo *"Betimi i Vrana Konit"* dëshmojnë këtë prirje të tij për të eksperimentuar brenda kufijve të një sistemi të ngurtë.

Një nga tiparet më të dallueshme të pikturës së Kamberit ishte **koloriti i tij i pasur dhe i guximshëm**, ku ndikimet impresioniste dhe ekspresioniste përthitheshin në një gjuhë personale. Ngjyra tek ai nuk ishte thjesht element përshkrues, por bartëse emocionit dhe drite. Peneli i tij, shpesh i lirë dhe energjik, krijonte një strukturë të gjallë, ku figura dhe hapësira ndërthureshin në mënyrë organike. Kjo e bënte veprën e tij të menjëhershme dhe të dallueshme, njëherësh tokësore dhe poetike.

Krijimtaria e tij e gjatë – mbi **1400 vepra në gjini të ndryshme** – dëshmon një përkushtim të rrallë ndaj artit. Në periudhën pas viteve '90, arti i Kamberit u çlirua më tej, duke reflektuar realitetet e reja sociale dhe dramet e tranzicionit shqiptar. Tema si eksodi, dhimbja kolektive, lufta dhe pasiguria u trajtuan me një gjuhë më të drejtpërdrejtë dhe më ekspresive. Peneli u bë më i lirë, më impulsiv, ndërsa ngjyra fitoi një dimension edhe më dekorativ e simbolik.

Në të njëjtën kohë, ai iu rikthye me një pasion të veçantë **peizazhit dhe pikturës në natyrë (plein air)**, duke u bërë një nga mjeshtrit më të ndjeshëm të dritës shqiptare. Peizazhet e bregdetit të Vlorës, ullinjë, shkëmbinjë dhe horizontet detare, në duart e tij shndërroheshin në kompozime të gjalla, ku natyra merrte frymë dhe transmetonte emocione të drejtpërdrejta.

Skënder Kamberi ishte një artist që nuk reshti kurrë së kërkuari. Ai ndërtoi stilin e tij përmes një pune të palodhur, eksperimentimi të vazhdueshëm dhe një qëndrimi të qartë antikonformist. Për këtë arsye, ai mbetet një nga ata piktorë që i dhanë artit shqiptar jo vetëm vepra, por edhe **identitet dhe guxim krijues**.

I vlerësuar me titujt "Piktor i Merituar" dhe "Piktor i Popullit", si dhe me një sërë çmimesh e vlerësimesh kombëtare e ndërkombëtare, Kamberi la pas një trashëgimi të jashtëzakonshme që ruhet në institucionet kryesore artistike dhe në koleksione të shumta private në Shqipëri dhe jashtë saj.

Sot, ai largohet fizikisht, por mbetet i gjallë në çdo telajo ku drita, ngjyra dhe ndjenja

# In Memoriam

# SKËNDER KAMBERI

## Lamtumirë, Mjeshtri rebel i ngjyrës

Ylli Drishti Historian & Kurator Arti  
Av. Fatmir Braka  
Koleksionisti kryesor i artistit Kamberi

bashkohen në një gjuhë që vetëm ai dinte ta fliste. Skënder Kamberi ishte dhe do të mbetet një **mjeshër i pikturës shqiptare**, një artist rebel dhe i lirë në shpirt, që i dha formë dhe ngjyrë kujtesës sonë kolektive.

**Krijimtaria kompozicionale e Skënder Kamberit – drama e historisë dhe fuqia e figurës kolektive**

Një nga shtyllat më të rëndësishme të krijimtarisë së **Skënder Kamberit** mbetet piktura kompozicionale shumëfigurëshe, ku artisti ndërtoi një univers të pasur tematik, duke trajtuar historinë, luftën antifashiste na-

cionalçlirimtare dhe realitetin social të kohës me një gjuhë të veçantë piktorike.

Në ciklin e tablove me temë historike, kushtuar shekujve XIX–XX, Kamberi rikthen me forcë dramatike momentet e qëndrësës popullore dhe figurat e lëvizjeve antiosmane. Vepra si *"Rrëzimi i beut nga kali"* (1970), *"Dheu mbrohet me pushkë"* (1971), *"Koto Hoxhi në burgun e Turqisë"* (1971), *"Po me se luftojnë vallë"* (1972), *"Amanet flamurin"* (1972), *"Kapëdan Sali Vranishti"* (1972), apo *"Lufta e Zenel Gjolekës kundër reformave të Tanzimatit"* (1974), përbëjnë një cikël të konsoliduar ku historia nuk trajtohet si narrativë e ftohtë, por si përjetim emocional dhe dramatik. Në këto

tablo, artisti nuk glorifikon individin e vetëm, por shpesh vendos në qendër **forcën kolektive dhe shpirtin e qëndrësës**, duke i dhënë skenës një energji të brendshme të fuqishme.

Në vijim, cikli i veprave kushtuar luftës antifashiste nacionalçlirimtare dëshmon të njëjtën prirje për të trajtuar historinë përmes dramës së grupit dhe jo heroizmit të izoluar. Tablo si *"Partizanët e detit"* (1975), *"Illegalët"* (1978), *"Nga Bramyshja në Sanxhak"* (1979) apo *"Inaugurimi i brigadës së V sulmuese"* (1979), shpalosin një botë në lëvizje, ku figurat ndërthuren në një ritëm të brendshëm dinamik. Kamberi shmang statizmin dhe skematizmin tipik të kohës, duke krijuar kompozime të gjalla, me tensioni dhe emocionet përcillen përmes gjesteve, lëvizjes dhe kontrasteve koloristike.

Një tjetër drejtim i rëndësishëm është cikli i tablove me temë nga ndërtimi socialist dhe jeta e përditshme. Vepra si *"Lezhjanët bisedojnë"* (1964), *"Agim pune në naftë"* (1973), *"Buka e duarve tonë"* (1976), *"Në hidrocentral"* (1984), *"Netë festive"* (1985), *"Emancipimi"* (1988) dhe *"Drejt Europës"* (1990), tregojnë për një artist që kërkoi të kapë jo vetëm momentin, por edhe **psikologjinë kolektive të shoqërisë**. Edhe këtu, ai i largohet klisheve të figurës së heroit të idealizuar, duke vendosur në qendër njeriun e zakonshëm dhe përvojën e tij.

Tipari dallues i këtyre kompozimeve është mënyra se si Kamberi ndërton skenën: figurat janë gjithmonë në lëvizje, të lidhura organikisht me njëra-tjetrën dhe me hapësirën, ndërsa **ngjyra luan rol themelor në krijimin e atmosferës emocionale**. Paleta e tij e pasur, me ndikime të dukshme impresioniste dhe ekspresioniste, i jep veprës një jetë të brendshme që shkon përtej narrativës.

Ndryshe nga shumë bashkëkohës të tij, Kamberi **thyen normat strikte të realizmit socialist**, duke mos e vendosur figurën e udhëheqësit apo heroit në qendër absolute. Ai preferon të ndërtojë tablo ku protagonistit është vetë ngjarja, drama dhe kolektiviteti. Kjo qasje e bën pikturën e tij më të lirë, më njerëzore dhe më të afërt me realitetin emocional.

Edhe në portrete, ai dëshmon të njëjtën ndjeshmëri dhe kërkim. Që nga portreti i parë i kushtuar **Eqrem Çabejt** (1961), e deri te portretet e figurave të njohura si Dritëro Agolli, Abdurrahim Buza, Feim Ibrahim apo Kristaq Rama, Kamberi arrin të depërtojë përtej fizionomisë, duke kapur karakterin dhe botën e brendshme të subjektit. Paralelisht, ai realizon dhjetëra portrete të njerëzve të thjeshtë, duke ruajtur gjithmonë një raport të drejtpërdrejtë me realitetin njerëzor.

Një element domethënës në krijimtarinë e tij është edhe raporti me institucionet dhe normat ideologjike të kohës. Edhe pse realizoi disa vepra kushtuar figurës së Enver Hoxhës, disa prej tyre nuk u pranuan në ekspozitat zyrtare, çka dëshmon për një artist që, edhe brenda sistemit, ruante një **qëndrim të pavarur dhe një frymë jo-konformiste**.

Në tërësi, krijimtaria kompozicionale e Skënder Kamberit përbën një nga kontributet më të rëndësishme në artin shqiptar, ku historia, shoqëria dhe njeriu trajtohen me një gjuhë të pasur vizuale, me guxim artistik dhe me një ndjenjë të thellë përgjegjësie estetike.

**Lamtumirë, mjeshër i ngjyrës.** Skënder Kamberi largohet fizikisht, por mbetet i gjallë në çdo telajo ku drita dhe kujtesa shqiptare marrin frymë. Ai nuk ishte vetëm një piktor, por një rrëfimtari i historisë sonë, një dëshmitar i kohëve dhe një zë i lirë në artin shqiptar.

Në historinë e artit shqiptar do të jesh gjithmonë i pranishëm – si një nga themeluesit e një tradite, si një mjeshër i kompozimit dhe si një shpirt krijues që nuk reshti kurrë së kërkuari.

**Lamtumirë, artist. Ne nuk do të të harrojmë.** Vepra jote do të vazhdojë të flasë për ty – sot, nesër dhe për brezat që do të vijnë.



Mbi romanin “Zonjës me pirpiri”  
të Odise Kotes, “Toena”

## Një poemë epifanike

Nga prof. Zija Vukaj

Në atmosferën e letërsisë së sotme, ky roman vjen si një vërshim i beftë i një rrëkeje që buron nga pjesët shkëmbore të qytetit të gurtë jugor, kapton vise të largëta dhe të afërta dhe derdhet në limanin e një letërsie të përbotshme- weltliteratur e pati cilësuar Gëte këtë lloj krijimi.

Përgjatë shestimit të një arkitekture të sofistikuar kompozicionale, autori na ka futur në shtjellat e një narrative plot labirinte dhe ndeshtrasha, të cilat në krye të herës janë spërkatur me një mjegullinë të qëllimshme, brenda së cilës nëpërduken hije personazhesh që presin të plazmohen doradorës në qartësinë e tyre, qartësi që sendërohet nga zembereku rrëfimtari i cili realizohet prej tri rendeve narrative: prej autorit-rrëfyes i gjithëdijshëm, prej personazhit të Annabel Arçer, një zonjë londineze, rrëfimet onirike të së cilës ndriçojnë skutat ontologjike të ansamblit të personazheve, si dhe prej dialogjeve mes personazheve, që i japin tekstit të veprës një frymëmarrje të ngjashme me atë të veprave skenike.

Vendkoha e kësaj vepre është gati e parrokshme. Skenat janë Londra, Boni, Korfu, Vjena, Gjirakastra dhe ngjarjet shtrihen nga e sotmja deri në kohën e lavdishme të principatave.

Gjithë mizanskena e veprës përshkohet, ndriçohet dhe sublimohet nga skenografia e hijshme, thujse mahnitëse dhe magjike e veshjes që quhet “Pirpiri”. Pirpiria na shfaqet në fillim si eksponat i muzeut britanik, cilësuar si veshje tradicionale ballkanike, e kundruar me skepticizëm nga zonja londineze Annabel, skepticizmi i së cilës ka lidhje me dramën shpirtërore dhe dashurinë e stuhishme që krijon kjo veshje me aureolë aventurore.

Pirpiria, ky objekt polisemik- një muzeum lëvizës- e vë gruan Annabel, në qendër të vëmendjes nëpër të gjitha takimet e saj në publik, e çon hijeshinë femërore në nivelet më të epërme, dritëson çdo tipar dhe lëvizje të saj. Këtu autori përshkruan si në pjesët më të ndritura të një poeme cilësimit të pirpirisë.

Ajo është kryefjalë, ëndërr, fatalitet, hijeshi, kob, titull fisnikërie, është fizike dhe metafizike. Ajo është institucion, memorie kulturore, dritë verbuese, mit, legjendë.

Dinamika rrëfimtare na tregon përmes retrospektivës njohjen e Zonjës Annabel me mjeshtrin që ka ndërtuar pirpirinë, Andre Gjinobardhi dhe idilin e tyre dashuror.

Dhe Andrea vetë, mjeshtri i Korfuzit, ky bir shqiptar, dishendent i një fisi të përmendur nga qyteti i misterit në Gjirakastrës rrezaton hirin e një orfeizmi mbresëlënës.

Ky orfe artizan, simbol i një demiurgu të veshur me pushtetin e fuqishëm të artit të vet, pajisur me një botë tejet të pasur shpirtërore, bëhet topisi që burimon dhe rrezaton të gjitha këndet e kësaj vepre.

Autori Odise Kote, me një opus tashmë të pasur dhe autoritetin e një shkrimtari të spikatur shqiptar shfaqet në këtë vepër si një krijues që dominon jo vetëm realitetet e diskursit që shtjellon, por edhe arrin t'i sublimojë ato nëpërmes frymëzimit, intuitës dhe virtuozeitit artistik në eliksir tërheqës dhe të freskët estetik.

Romani “Zonja me pirpiri” transmeton fuqinë e traditës sonë popullore, efektet madhore që e bukura e ardhur prej shekujve të largët, prej gjenezave të hershme zanafillore të kombit tonë të lashtë ka rrezatim tronditës në mbarë kulturën botërore. Gjithashtu, kjo vepër është një apologji e qartë e ontologjisë humane, e cila shfaqet tek qenia njerëzore e çdo epoke, e çdo vendi apo kulture si një substrat i përbashkët dhe mjet i pashmangshëm komunikimi. Autori arrin të universalizojë jo vetëm këtë souvenir mbresëlënës, të kulturës shqiptare, por edhe të rikonfirmojë universalitetin e genies humane.



## Kompozuar nga Vasil S Tole, dirigjuar nga Eno Koço “ALBANOI” asht një vepër e kalibrit european që na nderon kudo në botë

Nga Robert Prennushi

Në fakt një shkrim që fb ta nxjerr pa dashtë, pashë për dy fjalë që kisha shkruar për Sinfoninë ‘Albanoi’, të kompozitorit i avanguardës, Vasil S. Tole, vepër që e kisha ndigjue pa vemendjen e duhun, sepse atë ditë kisha edhe nipat që sillëshin nëpër shtëpi.

Ndaj hapa Linkun që kisha në PC për ta ndigjue ma me vemendje.

‘Albanoi’-t, pra shqiptarët e herëshëm, po kështu dhe kohët me tituj, të lanë me kuptue për kohë të lashta, jo të reja, siç asht edhe vetë Eposi. Në lidhje me këte, që nga emertmi i kohëve, duhet thanë se kompozitori ka vendosë që në fillim të ‘shfrytëzojë’ mundësitë shprehëse të folklorit tonë në të gjithë vendin, Veri e Jug. Madje dhe Hengun.

Sinfoni me Program?

Ma shumë se me program, udhërrëfuese do të thojë. Nga forma asht klasike, katër kohë - sepse sot kompozitorët modernë shkruajnë Sinfoni edhe me 1 ose 2 kohë, ose me 3 si Stravinskij, - por asht vepër me një gjuhë shprehëse krejt moderne: atonaliteti, i shkëputun nga armonia tonale klasike, polifonia, dy plane tonale që shpesh zhvillohen ‘për hesapë të vet’, i ndejmë jo rallë në këte vepër të shek. XXI, postmoderniste.

### I. Eposi.

Tunxhi në kushtrim! Pse edhe Kanga ‘maje krahu’ quhet kangë kushtrimi! Gjama, rritmi i heshtun e Vallës së shpatave e ashpersia e luftës ndjehet që në masat e para. Vjen prej kësaj një atmosfere e zymte: Rreziku! Fiatit në një rregjister të naltë bashkë me një shtresë të zymtë të harqeve e jo vetëm në rregjistrin e poshtëm. Timpani, pra lodra! Lajm. Kushtrim. Organizim. Nji temë e huej në rregjister të naltë me fiati e violina. Një gjendje e randë. Dhimbje. Gati nji funebre që përforcohet nga rregjistri i ulët, i thellë e në pianissimo. Nji violoncel përpiqet me ngritë krye. Kështu flauti. Por poshtë...deri sa timpani e trombonat ‘bahen gjallë’ përsëri... Nuk ka paqë në këta troje të lashta.

Prerja si me thikë e violinave në rregjistër të lartë sikur kërkojnë të krijojnë nji gjendje të re, por gjejnë vetëm pak qetësi tek fagoti në rregjistër të uët. Por gjithnji në dizonancë... Nuk ka paqë edhe tek violonçeli në rregjistër të ulët...Nuk ka paqë në këta treva ku ‘fort po shndritë njaj diell e pak po nxenë’, jo vetëm në mënyrë figurative.

Nuk duhet të kërkojmë në këte kohë me nji përmbajtje kaq komplekse, të gjejmë formën e sonatës: temat, përpunimin e reprizën.

Randë, randë pasojat e luftës në rregjistrin e ulët e pastaj nji zgjim: nji temë me jetë dhe e shkurtë, nji ostinato violinash shumë veriore, shkëndiat e shpatave me fiati e poshtë nji ritëm insistues e nji temë tunxhi që ngre kokën me nji temë mbizotnuese. Ndërrojnë rolet violinat e tunxhi. Ndjehen edhe nji herë temat kushtruese të fillimit. Por këte herë ngre kokën drita. Fitorja. Liria. Due të theksojë se jo njiherë verejmë në vepër dy grupe instrumentale e tonale, që sillen si re në qiell, në distanca të ndryshme naltësie e ngjyrash.

### II. ISO..Nji zgjim, nji pianissimo.Asht larg agimi...

Qetësi. Fagoti e mandej korno në oktavë, në nji shtart harqesh në rregjister të ulët, që rallëherë përgjigjen në pianissimo, larmerojnë nji agim, nji pejsazh, që fillon të duket. Këte e perforcon dhe tromba. Pejsazhi tashmë merr pamje: Ka paqë, qetësi, zgjim, nji pejsazh që edhe tromboni e prap tromba e perforcojnë kete. I japin ma dritë. E ndonji glissando e lehtë e ndonji viole i jep ngjyrë, lokalizon pejsazhin.

Qetësi. Jug, por nuk ndjehet pentatoni. Ndonji rreze dielli shihet. Por ndjehet edhe Jugu.

<https://youtu.be/f3EOtbBII0?si=c1TigoTXF4zybvsr>

### III. PERCHORUS /DANCE:

Asht nji Valle – zjarr, ku orkestra asht e angazhueme tanësisht e në të gjithë estensionin e tingllimit të tyne. Asht nji Valle shqiptare ku mjeshtria e orkestracionit të mban në tension. Grimca temash me rritme të ndryshme që kalojnë nga harqet tek fryma të mbajnë të tendosun. Kjo kohë edhe e vetme, mund të luhet e të qendrojë në çdo koncert e kudo në botë. Kompozimi, dirigjimi, orkestra në nivel shumë të naltë.

### IV Heng. Revely Finale.

Për mue (po kush të pyetë ty?). Sinfonia mund të myllej në kohën e tretë. Pjesa ma e madhe e kohës së IV, Hengu, që e dijme se erdh bashkë me pushtimin osman, nuk na çoi përpara, edhe në këte vepër megjithë mjeshtrinë ortkestruese të autorit. Madje na solli pak mbrapa, kaq e vertetë sa autori, me ndjeshmneni të hollë, e pau këte gja, dhe ju suell e mori “mish” e tema nga pjesa e tretë.

ALBANOI asht nji vepër e kalibrit european që na nderon kudo në botë.

Këto mendova e ndjeva duke e ndigjue këte vepër e mbeta shumë, shumë i knaqun per nivelin e kompozimit, dirigjimit e interpretimit nga orkestra.

Edhe letërsia e mirë do ta kishte të pamundur t'i mbijetonte rrethit të egër të izolimit në regjimin totalitar, ku edhe Dodës, komandant i postës kufitare në fshatin Bukojna, personazh i romanit "Ditët e lakuriqëve të natës", (njëri prej romaneve të trilogjisë "Atje ku dielli lind dy herë") i qe krijuar ose ushqente iluzionin se ishte kryeministri i atij vendi, se mund të vendoste për fatet e tij, pa pyetur askënd.

Pa përmendur shkrimtarët e traditës sonë, të cilët u shkolluan jashtë vendit, madje jetuan një kohë ose gjithë kohën jashtë vendit, edhe shkrimtarët më të mirë shqiptarë që sot njihen si brezi i viteve '60, si Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Arapi u shkolluan jashtë vendit, ku regjimet komuniste në frymën hrushoviane hodhën poshtë dhe dënuan praktikën çnjerëzore staliniste. Atje, ndonëse nuk i shpëtuan plotësisht ndëshkimit dhe persekutimeve, u lejua botimi i disa veprave që krijuan edhe disidencën letrare. Njëkohësisht kurrë nuk u vu në dyshim përvoja botërore e letërsisë. Siç është vënë shpesh në dukje, avantazhet e kësaj kulture solide vihen re në veprat më të mira të shkrimtarëve që përmendëm. Sa nga një frymë hyjnore që bekohet, talentit i duhen rrethanat e përshtatshme që të kultivohet.

Namik Dokle është përpjekur herët t'i përvidhet perdes së hekurt kulturore. Ndoshta fillimisht jo me ndonjë qëllim të përcaktuar kaq qartë, siç mund ta themi sot në liri. Vetëpërmbytja shpesh deformonte mendimet më të fshehta. Në fillim të viteve '80, ai ia doli të studjojë spanjishten, prej së cilës qenë përkthyer mjeshhtërisht në shqip disa nga kryeveprat e letërsisë botërore në prozë e poezi. Mjafton të përmendim Servantesin, Lorkën, Pablo Nerudën. Ndërkohë përmes kësaj gjuhe të madhe mund të përthithet përvoja më e mirë e letërsisë botërore.

Si gazetar i terrenit për një kohë të gjatë ai mësoi të njohë njerëzit, të hulumtojë karaktere, të depërtojë deri në palcën e disa të vërtetave të thjeshta që fshiheshin, heshteshin, shurdhoheshin nga propaganda e regjimit. Shkroi në frymën e kohës një sërë dramash e dramatizimesh që i shërbyen për t'u shkathtësuar me skalitjen e figurave njerëzore shumë dimensionale. Përmes urtësisë popullore u aftësua të ndërtojë monologje e dialogje të mprehta me sens humorit e ironie. Duhej në një farë mënyre të shpartallohej edhe një rreth i hekurt izolimi dhe vetizolimi të brendshëm, për t'i mbijetuar fizikisht ndëshkimeve të diktaturës që prodhonte çdo ditë armiq të rinj. Ndërkaq është e njohur përvoja e tij e gjatë mbi një çerek shekullorë në jetën politike të vendit deri në majat më të larta të saj.

Në këtë sens bëhet e kuptueshme pse në romanet e Dokles, një trilogji e plotë për vendlindjen, kërkohet paralele e përngjasime me vepra të njohura të letërsisë botërore që ka ndikuar e ndikon vazhdimisht në botën shpirtërore të miliona lexuesve anekënd lëmshit të dheut.

Romani "Ditët e lakuriqëve të natës" që në prologun e tij të gjall asosacione të këndshme në përfaqje me një letërsi tashmë të njohur botërisht nën shenjën e realizmit magjik, të lëvruar nga autorë të njohur si Migel Anhel Asturias, me librat "Uikend në Guatemalë", "Zoti President", "Papa Jeshil", etj., të cilat ndoshta edhe për shkak të specifikave politike që bartnin vendet e Amerikës Latine, për fat të mirë, arritën ta shohin dritën e botimit në Shqipërinë e mbyllur komuniste në fillim të viteve '70 të shekullit të kaluar. Më vonë nga kjo trevë e begatë letrare e kulturore e botës erdhën edhe emra të tjerë po kaq të shquar si Gabriel Garcia Markes me "Dashuria në kohën e kolerës", etj.

T'i kthehemi prologut të romanit. Mikrobiologu i ngarkuar nga Akademia e Shkencave me zbulimin e shkaktarëve të sëmundjes së tërbimit që po jepte shenja të forta përhapjeje në një zonë të skajshme të vendit, pas kthimit nga ky mision, mëson se do të internohet. Lajmi shokues që në fakt e priste prej kohësh, jepet që në faqet e para të librit, i kumtuar dhimbshëm e me drojë të kuptueshme njerëzore, po krejt qartë dhe pa ekuivoke. Diku lart është vendosur dëbimi i tij jo vetëm nga Akademia.

Vijimi i romanit është një digresion rrëfimi, një palimpsest kujtimesh përmes episodesh hulumtuese si rrathët koncentrikë në trungun e prerë të pemës që pas numërimit tregojnë moshën e saj. Epilogu zbulon shkaqet e vërteta, po askush nuk do të ngazëlletet prej saj. Heroi, tashmë i dërmuar nga luzma e dyshimeve, do të ndjehet edhe më i lodhur, më i trishtuar prej zbulimit. Dhe kjo ka arsyet e veta.

Pavarësisht shkallës së lartë të vlimeve

Elemente sureale: Fantazia, fantazmat e reja dhe tradicionale në romanin "Ditët e lakuriqëve të natës" të shkrimtarit Namik Dokle.

## Temperatura e ankthit

### Nga Izet Duraku

shpirtërore, gjuha e narracionit është e ftohtë, gati neutrale. Ajo mëton të zhbijë imtësitë shprehëse të mendimit përmes një pasurie leksikore, edhe kjo një veçori e ndërimit të situatave, skenave të gjera e mjedisve më intime, duke mbajtur gjithnjë frymën pezull përballë befasi të jetësore. Ngjarjet rrjedhin pa forcime, ashtu të paparashikueshme, siç është e paparashikueshme rrjedha jetësore. Dialogjet, një mjeshhtëri e selitur hershëm prej autorit, herë janë të drejtpërdrejtë, të tërthortë, aludues apo edhe të pakuptueshëm deri në hermetizim. Monologjet, bisedat e heshtura me veten, janë më të hapura, më informuese. Meditimi shpesh arratiset në vise e kohë të largëta. E kaluara rreket të zbusë sadopak vrazhdinë e së tashmes. Karaktere pasionante në roman, në përgjithësi, ruajnë tonin e përmbytur të ligjërit duke shmangur patetikën. Mungesa e retorikës edhe në gjuhën e profesorit e bën më të besueshme figurën e tij, që përmes pasionit për punën dhe të vërtetën shkencore arrin pahetueshëm deri në caqet e akteve sublime.

Duke hetuar shenjat e pasojat e sëmundjes misterioze të tërbimit, Profetori vëren në një shkallë ngritëse se si molisja e melankolia njerëzore, shndërrohet në brengë, vuajtje të pakuptueshme, dhimbje therëse deri në humbje të vetëdijes dhe jetës ndër djemtë e vajzat e reja të fshatit. Zhgualli i së vërtetës ishte i vështirë të thyhej. Natyrisht i pambërritshëm për miqtë e largët si Profetori. Sepse shkaku i tërbimit ishte para sysh, mund të shihej edhe nga të verbërit. Mungonte dëshira për të parë? Jo, verbëria ishte e stisur. Banorët e dinin prej kohësh mizorinë e kësaj të vërtete të thjeshtë që po e vuanin në kuriz. Të gjithë shihnin, po e kishin të ndaluar të tregonin çfarë duhej krejt qartë. Prej shkeljes së tabusë, 13 familje ishin arratisur nga ferri, do të shtohet racioni i vuajtjes për banorët e mbetur brenda kufirit që kishte ndarë për së gjalli dajën nga nipërit e mbesat, bijën e martuar këtej ose matanë kufirit para se të mbyllej hermetikisht nga shtëpia e prindërve, nga motrat e vëllezërit. Qenë ndarë miqtë e hershëm, farefisi, qenë ndaluar të hynin e dilnin për dasma e vdekje. Situata e veçantë, ajo gjendje alarmi e përhershme nga rreziku i armikut të jashtëm që do të rrezikonte sipas ithtarëve të regjimit lirinë dhe pavarësinë e vendit, mbante të lartë për secilin temperaturën e ankthit dhe tmerrit. Një tmerr që duhej pranuar, që i duhej dorëzuar vullnetarisht pa e hapur gojën. Regjimi të rrihte, po nuk të lejonte të qaje.

Mjegullimi i arsyes prej tmerrit ndëshkues duhej të mbulohej edhe me një alibi shkencore. Pa e shfaqur, Profetori i biologjisë, dora dorës, do ta kuptonte se po përdorej prej regjimit. A do të pranonte ai të shndërrohej në një instrument mashtrimi?!

Doktori, që mendohej se do të ishte në krah të tij, do t'i kundërvihej në çdo hap. Analizat

e pafundme për të gjetur qen, mace, lakuriqë, dhelpra të infektuara, synonin për të treguar kujdesin e rrjeshëm të regjimit, shkaktarit të vërtetë të tërbimit njerëzor. Sa herë shkencëtari shmangej nga protokollin strikt shkencor, në pamundësi për ta ndalur, doktori bënte të habiturin. Misteret nuk ekzistojnë atje ku nuk ka mistere. Profesorit, si në mjegull, i duhej se doktori nuk ishte në mision për të ndihmuar, po për ta penguar me çdo mjet. Madje ky udhëtim i pazakontë do të ishte një kurth për vetë Profetorin e nderuar. Në të vërtetë ai po dërgohej me shërbim për ta larguar nga Akademia, për të sajuar prova për të që mund ta vinin pas hekurave ose për ta internuar larg kryeqytetit, duke e privuar nga mundësia e lëvizjes dhe e jetës shkencore. Ndaj nuk mund të ishte entuziast për absurditetin e një zbulimi të cilin regjimi e dinte. Në një situatë absurdi mund vetëm të indinjohesh me të gjithë, edhe me veten, ndonëse ai kishte dyshuar që në ditën e parë.

Në hullinë krahasimtare fundin tragjik të personazhit e kemi parë që në fjalinë e parë të romanit "Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar" të G. G. Markes. Edhe këtu prologu ngjan si epilogu i veprës. Një vdekje që ndonëse e paralajmëruar, erdhi si pasojë e indiferencës njerëzore, apatisë për ta ndalur dorën e kimit, ose ligësisë së fshehur që lutej në heshtje që premtimi për vrasje të ndodhte. Romani hyn thellë në shpirtin e një shoqërie që e ka të pamundur të përballet me të keqen, që, edhe pse e njoftuar, lejon që tragjedia të ndodhë. Në ndryshim prej absurdit të kësaj shurdhërie, në romanin e Namik Dokles, shtypja shoqërore favorizon zgjatjen e izolimit dhe të fatkeqësive që rrjedhin prej tij. Përndjekja e përnatshme synon të asfiksojë shpirtat kryengritës. Mekanizmi absurd i dhunës bëhet edhe më agresiv përmes argatëve jo të paktë të së keqes. Acari i shtuar synonte të ngrinte lulet e jetës, të shuante e të vriste dashurinë si pemën e jetës duke asgjësuar shpirtërisht e fizikisht ekzistencën e saj. Si një reagim memec, dridhjet, konvulsionet e shenjat e tjera të tërbimit vrastar, do të mbeteshin si i vetmi reagim kundërshtues ndaj dhunës së verbër të regjimit.

Ndërsa krejt romani "Murtaja" i Albert Kamys ngrihet gjithashtu mbi parabolën e sëmundjes së murtajës duke krijuar një paralelizëm me situatën aktuale politike në një qytet bregdetar algerian, ku krejt papritur shfaqen në rrugë e kudo minjtë e ngordhur, shkaktarë të përhapjes së sëmundjes fatale, prej fatkeqësisë së të cilës rrallë kush mund të shpëtonte. Madje nga regjimi i karantinës së vendosur për të frenuar murtajën do ta pësonin edhe familjarët e mjekëve të ngarkuar me stopimin dhe kurimin e sëmundjes shfarosëse. Izolimi absurd shpesh hakmerret përmes shfarosjes së familjeve të tëra për shkak të izolimit të tyre të detyrueshëm.

Edhe në romanin e Namikut situatat e absurdit këmbehen me njëra tjetrën. Mbi realitetin jetësor rikrijohet një realitet tjetër paralel me elemente sureale, ku jetojnë së bashku të gjallët e të vdekurit, legjendat e hershme dhe të reja, të larguarit dhe sedentarët, shpresa dhe makthi i ëndrrave. Në strukturën shtesore të romanit hetohen qartë gjurmët e strukturës së përrallës ku dalin qartë arketipet e personazheve të njohura, që shkojnë krahas si e mira dhe e keqja. Udhja është personazhi i pranishëm kudo. Lëvizja në kohë dhe hapësirë e personazheve bëhet për ta mashtruar përditshmërinë e zymtë. Duket sikur burimet tentojnë rikthimin në gjirin e tokës. Koha lëviz mbrapsht nga e sotmja në të shkuarën ndoshta për të gjetur fillin e humbur, po udhët e së ardhmes duken të zëna. Mungojnë përbindshat e frikshëm, dragonjtë e kuçedrat, po hetohen hija e së bukurës së dheut që e mbajnë të lidhur, jo në një shpellë, po në fshatin e harruar duke ia vrarë dëshirën për ripërtëritje. Një nënë e zgjuar, si nëna e jetës, mban gjallë lidhjet me të shkuarën për t'i dal zot të ardhmes. Ajo ka gati shpresë, ilaçin e vazhdimësisë së jetës përmes inkurajimit të dashurisë midis të rinjve.

Në qiellin e zymtë të romanit vërteten luzma lakuriqësh me krahë shqiponje e turinj miu, në tokë kërkohen e hetohen gjurmë dhe lprash të kuqe. Bukojna, një pikë në dukje e humbur e globit, është në fakt një miniunivers i jetës njerëzore ku skajet më të largëta të jetës lidhen me metroplem më të ndritshme të botës.


Paralelizma të tilla nuk kanë mbetur thjesht si përngjasime të rastësishme në sipërfaqe të veprës. Ata nuk kanë lindur nga imitimi, po prej pjekurisë artistike. Është e vështirë të shkohet larg pa brumin vetjak të arsenalit të shumtë të mjeshtrisë narrative. Ndonëse që në fillim jepet fati i keq i kryepersonazhit, kjo ndjehet natyrisht, pa zhurmën artificiale të kataklizmës. Jo. Fundin e botës e afron gënjeshtra, mistifikimi dhe jo e vërteta. Duke pritur me stoicizëm e qetësi ndëshkimin, ai arrin të ruajë ekuilibrin shpirtëror për t'i shkuar deri në fund hetimit të tij shkencor. Hetim që shkon përmes dijeve të shkencës, ku vendi, koha dhe hapësirat këmbehen shpesh me njëra tjetrën. Profetori është i vetëdijshëm si një prift misionar në xhunglën njerëzore ku mohohej besimi e shpresa. Ashtu si dritën e besimit ai kërkon edhe të vërtetën e sëmundjes pa besuar aspak në broçkullat që mund të thuheshin. As në alibitë shkencore. As në paragjykimet përcmuese rreth vendeve e njerëzve në viset e largta, gjoja të pazhvilluara. As në hijet e hapta dhe të fshehta që e ndiqnin në çdo hap udhëve të fshatit. As nga fjalët aluzive, shumkuptimshe apo të megjulluara prej jermi të frikës. As prej heshtjes së rëndë të netëve plot terr. As prej lehjes së qenve dhe dinakërisë së dhelprave të kuqe. Dhe shpall kumtin, sa shkencor po aq edhe njerëzor: këtu ka vetëm një sëmundje; ndalimi i dashurisë.

Realiteti i ka mundësuar autorit një fantazi të ndezur plot elemente sureale. Në semantikën e fjalës fantazi, siç dihet qëndrojnë fantazmat. Këtej rrjedh edhe fantazmagoria e pasur e romanit, të mbushur me ngjyra, hije shoqërore që nuk i ndahen askujt ditën dhe natën, hije që kërcënojnë haptas apo që mbajnë shënime kërcënuese. Në ajrin e rënduar të udhëve enden shpirta të shqetësuar, që, ndonëse gjallë, kanë kapërcyer përtej kufirit politik që ndan njerëz, toka, peisazhe, duke thyer një tabu të shenjtë prej regjimit. Pas thyerjes së tabusë, ashtu si në botën primitive në ag të njerëzimit, shtohen ndëshkimet jo aq të shenja për banorët e fshatit që duhej ta harronin se mund të kapërcehej kufiri. Aleat i regjimit shndërrohet terri, që sfidohej prej një pjese banorësh duke shtuar llampat. Fantazma që përmes shenjave e kujtimeve të lëna, kthehen nga hadi si sirena joshëse që grishin për të dalë në brigje tashmë të ndaluara. Shpirta dhe fantazma shpirttrash u ngatërrohen nëpër këmbë njerëzve.

Fantazma e Stalinit të vdekur me kohë në Rusinë e largët, tashmë të shpallur armike, nuk mjaftonte të ndiqej verbërisht nga Diktatori, por edhe të rimishërohej edhe tek figura tragjikomike e një fshatari, shërbyes i zellshtëm i së keqes. Lakuriqët e tuneleve plot rrezatim të Nimçës ngujohen në shtëpitë e braktisura të fshatit që bashkë me tartabiqet u prishin gjumin e jetën çdo miku e banori. Ato janë rojet e ferrit. Turinjtë prej miu ndotin e përhapin tërbimin duke prishur ritin e lashtë të vazhdimësisë së jetës. Fantazmat e reja si Gjethi i Thatë bashkë me Gjethin e Njomë (pseudonime përgjuesish), shtojnë rrezikun e shumëfishimit të së keqes.

Fantazmat e vjetra të magjistarëve e mgjistarëve që arrijnë të ulin hënën në tokë, për ta mjellë, japin zemër se e keqja mund të përballohet. Fantazmat e vjetra rikthehen për ta fituar betejën me fantazmat e reja si krijesa artificiale kundër ligjeve të natyrës njerëzore. E keqja e mishëruar të ndalimi, mbyllja, veçimi dhe ngritja e barrierave të pakapërcyeshme midis sekseve, vajzave e djemve, nuk ka të ardhme. Jeta e gjen shtegun për të dalë nga rrethi i mbyllur i vdekjes.

Bukojna është metafora e një vendi të izoluar me mjetet e shtërngimit e të dhunës. Nuk është vetëm drama tragjike e një grushti njerëzish që fati i dënoui të jetonin pranë kufijve shtetërorë që do të mbyllte politika. Si mënyrë jetese, izolimi arriti të ndante shtete, krahina, familje e individë nga njëri-tjetri, duke hyrë në çdo qelizë jetësore. Veçimi do të bëhej dhuna e përhershme që synonte të bëhej pushteti absolut. Megjithatë bota e madhe me diellin e saj të jetës është e pamundur të mbahet mbyllur. Ajo rikthehet përmes kujtimeve të së shkuarës. Harrimi sfidohet nga mpërjha e kujtesës që duke regjistruar ngjarjet e mëdha e të vogla, do t'i shërbente rritjes së rezistencës dhe të imunitetit në organizmin e jetës së drobitur nga izolimi i gjatë.



**M**ali i tejdkushëm, kur është shkruar (1986-1988) dhe botuar (1990) ka qenë një roman atipik, njëherësh dhe paradigmatic, parashënjes në letërsinë shqipe, në kundërvënien të plotë me metodën e realizmit socialist, ndonëse, është shkruar në kontekstin shoqëror dhe ideologjik të saj. Atipik është edhe në llojin e romanit, që ka ardhur nga vet lloji i imagjinatës së krijimit subjektiv të një realiteti ideal, i ngjashëm dhe i pangjashëm me realitetin e jashtëm, por i ngjashëm me realitetin e brendshëm psiko-social të autorit, që aspironte ndryshime shoqërore rrënjësore, projektin e të cilave e kishte gati në mendjen dhe frymëzimin e vet.

\*\*\*\*

Kundërshtimin haptas ndaj realizmit socialist dhe ndryshimin e madh botëkuptimor-letrar, Zija Çela nuk e pati me përmbysjen e sistemit politik (1991), sikurse ndodhi, në atë kapërcyell, me shumicën e shkrimtarëve. Ai, dhe proza e tij romanore, pati ndryshuar disa vjet më përpara. Në atmosferën e pritjes së përgjithshme për ndryshime, në mesvitet 1980, disa shkrimtarë me qëndrime kritike, të shprehura pjesërisht, ose, të pashprehura deri atëherë, paraqitën për botim, vepra me kritika të forta për sistemin politik. Koço Kosta botoi (në revistën *Nëntori*, 1986) gjysmën e novelës *Ata të dy dhe të tjerë*, e cila u kritikua me egërsi. Edhe *Mali i tejdkushëm* i Zija Çelës, me referencë kohore të historisë së rrëfyer të po atyre viteve, është përfutur në të njëjtën atmosferë politiko-letrare dhe për të njëjtin qëllim: daljen haptas prej caqeve të censurës. Fatmirësisht, nuk pati fatin e novelës së kolegut të vet. Megjithatë, censura, edhe pse ishte në grahmë, mezi e lëshoi nga dora për të dalë në dritën e botimit. Krahas romaneve të Ismail Kadaresë, është ndër të paktët, që shënuan kthesën, daljen e plotë prej caqeve kufizuese të krijimit, në një hapësirë tjetër, të lirë, pa obsesion censurimi dhe vetcensurimi. Me ideshmërinë dhe vegimet anticipuese ka qenë edhe një projekcion parashënjes poetikash për veprat e ardhshme të autorit. Me sa, dhe, si mundet letërsia, ka qenë, gjithashtu, parashënjes për dukuri dhe ngjarje, që ndodhën kur Shqipëria u hap, duke u bërë pjesë e sistemit politik evropian.

Parashënjat kanë pasë filluar në vetëdijen letrare të shkrimtarit dhe në laboratorin e të shkruarit të letërsisë, i lirë në vetvete, pa përfillur kërkesat e dogmës zyrtare, ende e mbrojtur me ligj. E çliruar dhe e lirë, imagjinata është ngjitur më lart, në aluzione metaforiko-simbolike dhe parabola për ndryshime politike, sidomos për hapjen me Perëndimin. Nëpër to, dukshëm, dhe, në nënshtresa të përsiatjeve dhe dialogjeve, përcillet një humanizëm pannjerëzor, dëshirë për komunikim dhe afri shpirtërore me të tjerët, pa kufij shtetërorë dhe politikë, të afërt dhe të largët, një ndjeshmëri dhe dashuri, aty-këtu, gati sentimentaliste, për qenien njerëzore të patjetërsuar.

Rrëfëhet për një periudhë historike të mbideologjizuar dhe të politizuar, por, në të, nuk shfaqen botëkuptime a qëndrime të tilla, që zotëronin në përditshmëri, përveç varfërisë dhe pasojave traumatike të mbikqyrjes. Në të kundërt, veprohet dhe përsiatet sipas prirjeve të ndryshme vetjake, botëkuptimore, kulturore dhe psiko-morale të personazheve, jashtë botëkuptimit të ideologjizuar. Edhe institucionet ideologjike, që vepronin zotërueshëm, janë "fshirë", duke i shmangur, sikur mos të ishin, shfaqen vetëm në raste të caktuara, të domosdoshme për të përshkruar organizimin shtetëror. Pra, është një lloj letërsie, që mohon, me mënyra të ndryshme, sistemin ekzistues për të mbivendosur a për ta zëvendësuar imagjinativisht me një sistem tjetër shoqëror, të njëmendtë,

- Mali i tejdkushëm i Zija Çelës-

## ROMAN ATIPIK, PROJEKSIONE PARASHËNJUESE

Nga Prof. Bashkim Kuçuku



jo utopist, me shënja të botës së lirë demokratike.

Nga mjedisi shoqëror i vjetëruar, që ka ngecur në rrugën e historisë, simbolikisht, nëpërmjet një tuneli imagjinar, dilet në hapësirat e mbarë kontinentit. Shoqëria e mbyllur shqiptare njësohet me vendet e tjera, mishërim i sistemit demokratik evropian. Atmosfera njësohet përfutur me një sistem tjetër simbolik, i zhvilluar në alegori, veçanërisht me simbolet: *Nata Polare* dhe *flamuri i nxirë nga bloza*.

1. *Nata Polare*, /përsëritja për bashkëqytetarët e kontinentit


Dëbora e jashtëzakonshme (1985), që mbuloi të gjitha vendet e Europës me bardhësi ngrice, në roman, është shndërruar në fshirje të kufijve politikë, kur, edhe shqiptarët, duke përballur të njëjtat vështirësi natyrore, qenë një lloj me të tjerët, qytetarë të saj. Në atmosferën e *Natës Polare*, të rrethqarkullimit të tokës pa dritën e diellit, folësi, në *Qendrën e Zërit*, në vend të "Mirupafshim, bashkëqytetarë të Malashtit!", kinse me *lapsus linguae*, përsëritet: "Mirupafshim, bashkëqytetarë të kontinentit!", sikur të thoshte bashkëqytetarë të Bashkimit Evropian.

2. *Reja me thinja floriri dhe rremba gjaku*, /flamuri i nxirë nga tymi/bloza

Me këmbimin e pamjeve të një reje,

asociativisht këmbehen, duke u ndarë, rrugët e historisë. E përngjashme me krifë letrash dhe thinja të zbardhura prej një drite floriri, shëmbëlltyra e bardhë, fisnike, fillimisht e papërcaktueshme, konkretizohet me emrin e Skënderbeut dhe aureolën e tij. Në zhbërje, nën rrezet e diellit të fundit, që ndërmend perëndimin, fundin e periudhës së rrëfyer bashkëkohore, reja duket me damarë të hollë si rremba gjaku. Shëmbëlltyra e saj shoqërohet me pika të heshtjes, pa përcaktim, as historik dhe as fiksional. Mes dy shëmbëlltyrave, të resë dhe të Skënderbeut, ndërfitet refreni i përzishëm, me disa trajta: "Të rrëqethj mishtë!", "Ç' dimër i mbrapshtë ky i sivjetmi", "Ububuja", fjalë pasthirmë e saposajuar, të cilat sintetizohen te gjendja e flamurit, simbolit prijës, të nxirë nga tymi/bloza e "motit". Prej simboleve zbritet në shprehje të drejtpërdrejtë për vjetërimin e sistemit politik, pamundësinë e tij për të vazhduar më tej: "Të rrëqethet mishtë ta përfytyrosh socializmin, njëqind- apo dyqindvjeçar, me patokë të velur si këta."

Në mungesë të komunikimit të njëmendtë, kufijtë politikë dhe shoqërorë, të mbyllur, kapërcehen me anë të vegimeve "futuriste". Galeria-tunel e minierës, në ëndrra gjumi fiksional, shndërrohet në "metro", tejkshuese e malit. Prej saj dilet



në një stacion treni, të ngjashëm me stacionet e vendeve të huaja me lëvizje të madhe njerëzish dhe ngarkesash. Edhe qielli i zogjve, jo i aeroplanëve, bëhet hapësirë ndërldhjeje, përsëritjeje dhe komunikimi imagjativ. Pata, që vjen, me dy unaza, një nga Stokholmi (Suedi) dhe një nga Magdenburgu, (Gjermani), ndonëse, e plagosin në krahë, kthehet prej nga erdhi me një unazë të tretë, nga qyteza minatore shqiptare, për t'a njëjtësuar vendngjarjen e romanit si qytet evropian.

Mali, vendndodhja e galerive të veprimt, është edhe mbyllja e patundshme e horizontit të shikimit, pamundësia për të shkuar më tej. Aluzionet analogjike dhe simbolike mbishtresojnë në peshën e tij edhe rëndesën e detyrës ndaj pushtetit, të kërrusjes dhe thyerjes prej tij. Në shtresimin figurativ të përgjithshëm të malit, mes të thënave të llojit: *atë e ka zënë mali poshtë, kurse miniera ka nevojë për burra që ta mposhtin malin*, qarkullojnë thirrje qëndrueshmërie dhe nënzëra revolte. Galeritë e metalit të çmuar të kromit, me shtrirjen e tyre, prej hyrjes, në sipërfaqe të tokës, deri në thellësitë e zgjatura të saj, njëmendësisht malin e bëjnë të tejdkushëm edhe fizikisht. Mbi "tejdkushmërinë" e tij është ngritur "tejdkushmëria" e abstraktimeve, aluzioneve simbolike dhe parabolike, e të parit të kulturës dhe qytetërimit të vendeve të tjera: Francës, Suedisë, Gjermanisë, matanë malit, që nuk lë të shihet andej.

Dinamika e strukturës së romanit shpërfaq një prej domethënive më të rëndësishme të mendimit të përgjithshëm. Personazhi shkrimtar, një lloj alter ego i autorit, për arsye psikologjike vetjake, e ka ndërtuar përftesën kohore, dhe, prej saj, ritmikën e rrëfimit me njësinë kohore bazë jo të vitit, as të muajit, por të javës. Shtatëdhjetenëntë javët e kohës së rrëfyer, që janë më pak se dy vjet, subjektivisht duken disafish. Në mendësinë e tij, që përjeton me të ardhmen, dhe të vet autorit avangardë, koha, subjektivisht, ecën mjaft ngadalë, pasi në realitet nuk ka ndryshime. Kjo mënyrë e matjes së kohës i është ngulitur atij në fëmijëri, në institucionin shkollor, ku koha e disiplinimit për t'i mbajtur, ose, për t'i përjashtuar nga konvikti, llogaritej me një javë. Zanafilla vetjake e domosdoshmërisë së rrëfimit të kësaj historie fiksoni është disiplina, rregulli, detyrimi për t'iu nështruar rregullit dhe kohës. Obsesioni i frikës së *përrjashtimit* nga shkolla, që vjen prej fëmijërisë, dhe i mundësive të përjashtimeve të tjera, në sistemin shoqëror të përjashtimeve, njësohet me obsesionin, në moshën e pjekurisë, i *mosdurimit* për ndryshime politike sa më të shpejta, kanë përcaktuar qëndrimin ndaj kohës, rrjedhën e historisë së rrëfyer dhe arkitekturën strukturore të romanit, të ndarë në javë. Disiplinimi dhe frika nga përjashtimi, përjetimet shoqërore prej tyre janë shkrirë dhe zhvilluar në problematikën bashkëkohëse, të një shoqërie po aq disiplinuese dhe përjashtuese, si shkolla dhe konvikti, prandaj, rrëfimtari i historisë së fiksonit më shpesh dhe më tepër është vet autori.

**B**urrat janë qeniet më të çuditshme të kësaj bote,- i tha shkrimtarja e njohur Vera B. bashkudhëtarit të saj, tek fluturonin me avion për të vajtur në një qytet jugor në Francë, ku do të zhvillohej një takim triditor ndërkombëtar me shkrimtarë të kontinentit.

Shkrimtari ulur pranë saj, me emrin Andrea M., që duhet thënë se gëzonte një famë më modeste se ajo, miratoi thjesht me kokë pa ditur u'të thosh. Atëherë shkrimtarja e njohur u detyrua t'a thellonte më tej mendimin e saj për burrat :

-E pra burri, sa më i trashë, desha të them sa më kokëfortë ose kokëgdhë të jetë, aq më shumë s'i kupton gjërat.

Pas kësaj fjalie, shkrimtari Andrea M.e pyeti me delikatesë :

- C"do të thuash me këtë ?

-Dua të them atë që.....nganjëherë më duket se Zoti i ka krijuar burrat vetëm që t'i bëjnë gratë të çmenden ose të vrasin veten .

Por duket se edhe pas këtij pohimi Andrea nuk pati ndonjë gjë të mençur për të thënë, prandaj ai heshti përsëri.

Shkrimtarja e njohur ishte vërtetë grua e hijshme, pak e çakërditur, e hollë me buzë të mishta dhe një mendje aq të hollë, saqë kolegu i saj duhet ta kishte mendjen çdo çast që të mos i shpëtonte asgjë nga gjërat e mençura që ajo thoshte aq shpesh, madje as edhe nga ato broçkullat sensuale që nxjrrte nga goja.

Në të vërtetë ajo parapëlqente t'i thoshte gjërat hapur, "ashtu siç janë në realitet", si dhe ta shijonte jetën me një lehtësi të mrekullueshme, te çdo hipokrizie, ose falsiteti, që karakterizon rëndom natyrën njerëzore. Fundja si çdo shkrimtar në botë.

Shkrimtaren e njohur e shoqëroi deri në aeroport i shoqi, një shkencëtar i njohur, dhe ata me zor u shqitën nga njëri-tjetri nga një përçafim aq të gjatë, saqë Andrea u detyrua ta kujtonte me një të rënë të lehtë shpatullave. Kur hipën në avion, i shoqi vazhdoi me këmbëngulje ta përshëndeste tejkangjellave të aeroportit duke lëvizur dorën në ajër, teksa ajo i puthte dy gishtat e saj të hollë e ia hidhte atij me një fryrje të lehtë buzësh.Natyrisht që ai nuk dallonte asgjë nga larg, por gjithsesi lëvizte dorën kot me shikimin nga avioni, derisa ai filloi të lëvizte.

Me të kryer këtë rit sensual, Vera rregulloi pak flokët dhe pasi hodhi një vështrim të shpejtë përreth tha:

-Eshhtë tepër i mirë.

Më pas ajo ngriti gotën me verë të kuqe dhe i tha shokut të saj shkrimtar "Gëzuar pra, dhe jam shumë e kënaqur që do të jemi bashkë gjithë këto ditë.

- Edhe unë,- i tha sinqerisht shkrimtari modest.

Vera piu një gllënjë verë dhe fare qetësisht i tha bashkëbiseduesit të saj:

-Zot, ç'sy të blertë që paska,- dhe drejtoi shikimin nga udhëtari i tretë ulur përçafim saj, një mjekrosh trupmadh, me pamje nordiku, që shihte nga qielli krejt indiferent.

-Kush ?- pyeti Andrea.

-Ky derrkuci këtu pranë,- tha ajo po me atë zë të qetë dhe, pasi ktheu kokën dhe e shikoi edhe një herë në sy, shtoi :-Jo, jo, më duket se i ka ngjyrë gurrkali, shikoje me vëmendje.

E pa prituri përgjigje, ajo diç i tha nordikut, i cili u duk se qëllon qejfli bisedash me shkrimtarë të njohur.

-Ashtu më duket dhe mua,- reagoi Andrea me vonesë në lidhje me ngjyrën gurrkali të syve të nordikut.

-Ç'tip i çudiçëm ! u kthye ajo pas pak nga Andrea gjysmë i kotur, e, pasi nuk mori përgjigje, I u kthye më me zjarr bisedës me me nordikun dhe herë pas herë kukurisej duke përplasur duart mbi këmbët e zbuluara.

Fatqëqësisht në aeroportin transit, mjekroshi me sy ngjyrëkali nuk e kishte vazhdimin e rrugës bashkë me ta, por fatmirësisht përkoji që koha e tranzitit për të dy palët të ishte e mjaftueshme që ata të zhdukeshin një copë herë të mirë duke e lënë shkrimtarin modest të shijonte në vetmi një birrë te bari i aeroportit.Ajo u kthye në bar pak para se të nisej avioni dhe tha shkurt:

-Tip i lezetshëm.... Si është puna !...Interesant.

Pjesën tjetër të udhëtimit atyre u qëllon vendi në një radhë dyshe, kështu që kishin gjithë kohën e duhur për të folur me njëri tjetrin.

- Po t'a kishim gjithë jetën të qartë, pra të parashikueshme nuk do të kishim art, pra nuk do kishim



# Ylljet Aliçka

## SHKRIMTARËT

### Tregim

ç'të shkruanim apo jo ? tha Vera mendueshëm.

-Ashtu është,- tha Andrea.

Më pas ata llototisin për punë të artit dhe veçori të tjera që i dallojnë shkrimtarët nga pjesa tjetër e popullsisë dhe, pasi arrijnë në përfundimin se shkrimtarët janë nga qeniet më të holla të kësaj bote, ia futën me gjumë deri në fund të udhëtimit.

Mbërritën në qytetin turistik rreth mbrëmjes, ku i pritni një shofer me tabelë, që i çoi më pas në një hotel romantik mbushur me shkrimtarë të njohur dhe pemë të larta "si skelete lakuriq", siç i perifrazoi më pas shkrimtarja e njohur.

Për të vajtur në sallën e konferencave shkrimtarëve u kishin vënë në dispozicion një autobuz luksoz .

-Zot, shikoje me kujdes atë që ndodhet dy radhë pas nesh,- i tha Vera shokut të saj, sapo hipën në autobus për në sallën e konferencës,- po puna është që ai të mos e kuptojë që ti po e sheh.

Andrea ktheu kokën dhe dalloj një burrë sykaltër, që e e kuptoi se po e shihnin, dhe i bëri një përshëndetje kortezie.

-Dallove gjë ?- pyeti ajo tërë kërsëri.

-Hëm.... S'di ç'të them...- u përgjigj Andrea si i zënë në faj.

-Burrat nuk kanë nuhatje për gjëra të holla. Nuk të duket hyjnor në tërë qenien e tij, mospërfillës deri në pafundësi ? Ka një fytyrë tmerrësisht indiferente, madje një qetësi që të josh ose të ndjell t'ia trazosh. Se ç'më kujton tim bir kur fle.

Andrea e pa me habi dhe heshti.

Në sallën e konferencës ajo ra në sy menjëherë për shkak të veshjes së saj ekzotike dhe në gjysmëerrësirën e sallës, pasi i hodhi një vështrim të shpejtë gjithë pjesëmarrësve, i afrua Andrea dhe i pëshpëriti në vesh:

- Kam përshtypjen se qenka vend i papërshtashëm për mua, desha të them për bukurinë time,- dhe qeshi me të madhe duke tërhequr vëmendjen e shkrimtarëve në sallë.

Ata u ulën në një vend që përkoji krejt rastësisht mu pranë shkrimtarit sykaltër me qetësi olimpikë. Kurse në pushimin midis seancave ajo se nga humbi për t'u shfaqur më pas e ulur vetëm pranë tij. Fliste dhe qeshte papushim.

Gjatë drekës ajo gjeti pak kohë sa t'i kërkonte ndjesë Andreas se këtë radhë nuk do të hante drekë me të, pasi "kishte hasur krejt rastësisht burrin më joshës të kësaj konference monotone."

-Do të t'i tregoj të gjitha më pas,- i tha dhe iku fluturimthi.

Ajo u kthye në hotel pasdite vonë dhe e lumtur vajti e u ul në tryezën e Andreas.

-Çudi si ndodh, - filloi ajo të fliste mendueshëm,- jeta është plot të papritura.Unë s'e kisha fare mendjen në konferencë, kur ndjeva që dikush m'i kish ngulur sytë. Pra ai vetë se ç'më hodhi një vështrim, se unë s'i dhashë fare shkak. Më kupto, ndoshta ju burrat nuk e keni këtë intuitë... Po unë e kapa, e ndjeva që ai m'i kishte ngulur sytë. S'e merr dot me mend se me çfarë qetësie flet, thotë gjëra nga më makabret me një zë fin, pak të ngjirur, deri në ëmbëlsi do të thosha...

-Kush ?-pyeti Andrea pa e pasur mendjen.

-Ai pra, shkrimtari spanjoll.Ta them sinqerisht, - nisi ajo me vrull,- kur e putha, pasi natyrisht u puthëm, s'kam pse e fsheh, ndjeva që ai puthte ashtu siç dhe heshtte, i qetë deri në çmenduri.Vallë ta ruajë dot atë qetësi prej perëndish edhe kur bën dashuri ? Thjesht kuriozitet shkrimtareje.

-S'di ç'të të them ...- ia ktheu miku i saj.

-Po nga t'a dish xhanëm ,- qeshi ajo,- ai më ftoi të hamë darkë sonte.

Ajo e takoi Andrean vetëm të nesërmen për të ngrënë mëngjesin në verandën e hotelit, ku nuk preku asgjë me dorë, veç tymoste e trishtuar cigaren dhe u mjaftua vetëm me fjalët:

“Qe vërtet ashtu siç e kisha parashikuar.”

Andreas s'i kujtohej se si e kishte parashikuar.

Ditën tjetër ajo kishte radhën për të folur në konferencë. Foli shumë bukur, tha gjëra të mënçura, të paturpshme, gjë që i joshi pjesëmarrësit. E mbylli diskutimin duke shprehur keqardhjen e saj të thellë “për këto pemë të gjata rreth nesh, që ngjajnë si skelete lakuriq, dhe që nuk kanë kurrë mundësi të përqafohen me njëra-tjetrën.”

Salla shpërtheu në duartrokitje.

Në pushimin e kafes atyre iu afrua një poet me llullë në gojë, që mbante mbi kokë një republikë të vjetër dhe një shall vishnje hedhur pa kujdes, ose ndoshta me shumë kujdes. Poeti i foli Verës me një zë të zvargur:

-Unë për vete do parapëlqej të isha më mirë një nga ato pemët e larta lakuriq sesa një qenie njerëzore.

-Kurse unë do parapëlqej të isha e përqaftuar përjetësisht,- ia plasi ajo aty për aty dhe padysim kjo u mjaftoi që të tërhiqeshin në një qoshkë të sallës me nga një gotë uiski në dorë.

Ndërkohë Andrea humbi mes një grupi shkrimtarësh irlandezë, që si gjithë shkrimtarët irlandezë, pinin shumë alkool. Vetëm vonë në darkë, gjysmë i trullësuar nga pija, shtrirë në dhomën e tij, ai dëgjoi zhurmat e hapave të tyre tek hynin me tërsëllim në dhomën e saj, nga ku për një kohë të gjatë vinin zhurma shishesh të thyera dhe fjalësh përçart. Hoteli ra në qetësi vetëm nga orët e para të mëngjesit.

Të nesërmen në mëngjes Vera u pa ulur në terracën e lartë të hotelit dhe, po me atë fytyrë të trishtuar, pinte kafe pranë poetit me shallin vishnje hedhur pa kujdes në qafën e tij të reshkur, nën sytë e të cilit vareshin qeska të mëdha pagjumësie ose alkooli bashkë.

Poeti me shall vishnje kishte marrë pamjen e njeriut më fatkeq në botë.

Me të parë Andrean, Verës i shkëlqyen sytë, e ftoi në tryezën e saj, e puthi plot mall dhe iu lut t'i jjepte kartën e telefonit, pasi “e kish marrë tmerrsisht malli për burrin dhe djalin.”

Sarriti t'a falenderojë Andrean, mori kartën dhe u turr me vrik tek telefoni ngjitur me barin.

Andrea mbeti vetëm në tryezë me poetin me shall vishnje.

Nga telefoni dëgjoheshin copëza ngashërimesh “... shpirt, shpirt, mos u mërzitni, dhe dy ditë më kanë mbetur.... erdha, ju kam në zemër, ju puth fort, ju kam blerë të dyve nga një dhuratë... ju dua pa fund”

Sapo e la telefonin, ajo fshiu lotët dhe u ul pa fjalë. Dukej më e lehtësuar, teksa bohemit thithte i heshtur llullën e tij. Të bëhej se kishte bërë fajin më të madh në botë.

-Mos më shiko ashtu, se s'kam bërë gjë- iu drejtua ajo Andreas, - ai tërë natën veç villote dhe thithte llullën. Le që edhe sikur të donte, nuk bënte dot gjë me gjithë atë alkool që piu gjatë ditës. Aman, nuk i duroj dot burrat që qahen gjithmonë për trishtimin e kësaj bote e broçkulla të tjera si këto. E megjithatë më vinte keq, kur e shihja ashtu të dorëzuar plotësisht, të pafuqishëm dhe se si më erdhi, ia mora kokën e ia mbajta fort gjithë natën në gjoksin tim, teksa ai dëneste i dehur dhe veç pëshpëriste për fatin e tij të mbrapshtë. Na ka ftuar të dyve për darkë, në një darkë surprizë, siç tha vetë.

Dhe, si për t'i shprehur edhe një herë mirënjohjen, Vera pa nga bohemit, që rrinte i përhumur si dru, pa kuptuar gjë nga ato që thoshte ajo, i buzëqeshi me dhembshuri dhe, duke ndryshuar menjëherë shprehjen e fytyrës pyeti mikun e saj:

-Mos të mërzita ?

-Jo aspak,- tha Andrea.

-Të lutem mos më lër herë tjetër vetëm. Ti e di, në fund të fundit, të jetosh nuk është kurrë e lehtë apo jo ?

- Ashtu është,- pohoi Andrea dhe i buzëqeshi kot bohemit.

Derisa erdhi darka Vera u befusua dhe me një djallë brun, “ndoshta poet spanjoll, që e njoha në ashensor, dhe se nganjëherë fjalët janë të tepërta”, kishin mjaftuar ato çaste

të ashensorit, “o Zot koha merr kuptim tjetër në vartësi se si e jeton”, dhe zeshkani e kishte parë me një vështrim toreadori dhe, kur ashensori kishte mbërritur në katet e poshtme, ai ia kishte kapur dorën, dhe “unë nuk thashë asgjë, ai vepronte vetë, ndërsa unë s'i dhashë asnjë shenjë komprometuese, Zot si janë burrat, më puthi me zjarr, puthje demi më saktë, të merre frymën, sikur po zihej me një dem të thuash. Dhe e gjithë kjo, pra, pa asnjë fjalë.”

Më pas ata pinë në heshtje më shumë se ç'mund të mbanin.

Ajo mori herë frymë thellë dhe meqë ishte tip që i thotë gjërat ashtu siç janë në realitet e shikoi Andrean drejt e në sy dhe i tha :

-Interesant, me të arrita të shihja ngjyrën violet. Kupton? Violet.

- E kam parasysh si ngjyrë,- u përpoq të justifikohet Andrea.-Si ngjyrë mund ta dalloj, por në këtë rast nuk e kuptoj ç'lidhje ka.

-Kujtova se e dije, është fakt i njohur, me një fjalë çdo grua e pjekur e di, nejtë, fjala është tamam për atë kulm të kënaqësisë kur fillimisht të errësohen sytë nga orgazma e atëherë kur ti e ke humbur fare mendjen, gjithçka të bëhet violet, ngjyrë violet. Shkurt diçka tej orgazmës, tej botës reale...e pashpjegueshme me fjalët e kësaj bote.

Ajo heshti një copë herë si për të nuhatur të kuptuarit e shpjegimit të saj.

-Po, po e kam parasysh si ngjyrë,- përsëriti dhe një herë shkrimtari modest.

Surpriza e ftesës së bohemit vetmitar ishte një darkë në një lokal majë malit në shoqërinë e poetit bohem dhe të një mikut të tij të ngushtë, i cili gjatë darkës u befusua thellësisht me natyrën tepër origjinale të shkrimtares së njohur. Kjo magjepsje e tij u bë shkak i një ftohjeje të dukshme midis dy miqve të ngushtë, gjë që, mesa u kuptua, po e dëfrente shumë Verën.

Dhe, kur erdhi radha për të kërcyer në verandën e lokalit prej druri, ajo kërcëu vetëm me mikun e bohemit, duke e lënë bohemin vetëm me Andrean, i cili po mbaronte i heshtur shishen e dytë të verës. Ajo kërcente e lumtur në krahët e mikut të ngushtë të bohemit dhe herë-herë i qeshte Andreas, i cili dëgjonte i paepur qarjet e bohemit. Në fakt bohemit ishte angazhuar i tëri për t'i shpjeguar Andreas pavendosmërinë e tij në lidhje me kohën kur do vinte “dita e shumëdëshiruar” prej tij, pra dita kur do të vriste veten, duke dhënë dhe shpjegimet përkatëse për shtyrjet e pafundme, tmerrsisht torturoese, që i bënte ai “asaj dite fatlume”.

Ajo u kthye në tryezë e ngazëlluar.

-E pe? pyeti ajo Andrean.

-Kë?

-Atë pra, portorikanin që na sjell pjatat. Si ka mundësi të të mos ketë rënë në sy gjithë ai katana ! Eshtë student, por natën punon si kamerier, shkurt tipik portorikan, me atë shpengimin e tyre karakteristik. Në fakt unë nuk e pashë, pasi ai na shërbente nga pas, por, kur padashur më preku gjoksin, tek më servirte pjatën, Zot si janë burrat, ndoshta e bëri me qëllim, portorikan është, ç'nuk pret prej tyre, unë ktheva kokën, thjesht për të parë kush më preku gjoksin, dhe ne u pamë drejt e në sy...diçka si... një mister i ëmbël, sytë i kishte si ...dy puse me .... muzgje të mpiksur. Kurse ky tipi, rrudhi buzët sapo ftova portorikanin të kërcenim.

-Po s'ka shumë rëndësi,- u përpoq ta qetësonte Andrea,- ai është i zënë me rrëfimin e jetës së tij fatkeqe.

- Jo,jo, s'e kisha fjalën për këtë buallin plak, por për mikun e tij që ra sallatë pas meje. Apo edhe këtë s'e vure re ?

-Po, po...,- pohoi Andrea aty për aty.- Po mirë është të rrih dhe pak me këtë, e kam fjalën për bohemin,- tha Andrea duke iu shmangur epitetit aspak elegant që nxori Vera nga goja atypari, -në fund të fundit ai na ftoi dhe po harxhon tërë ato para për hatrin tënd.

-Ohu, aman se s'kam nerva në këtë natë magjike të dëgjoj qarjet e një llafazani të marrë fund,- tha ajo e bezdisur e, me të thënë këtë, u zhdruk në turmën shumëngjyrëshe të kërcimtarëve.

Vera u vonua dhe ata e shtynin kohën me gjithfarë bisedash të trishtueshme, derisa ajo erdhi plot hare dhe ashtu, e djersitur e tëra, tha pa e pasur mendjen:

- U mërzitët, pëllumbthat e mi. Sa ju kam zili, gjithmonë bisedat e burrave më kanë joshur, madje më

bëjnë të pëlças për të marrë vesh se ç'thonë me njëri-tjetrin për ne gratë në atë botën e tyre krejt të panjohur.

Ata u kthyen në hotel të rraskapitur, ndaj të gdhirë.

E nesërmja ishte dita e ndarjes prekëse, ashtu si çdo ndarje shkrimtarësh të njohur. Me këtë rast mikpritësit organizuan një party të zhurmshme, ku shkrimtarët shkëmbejnë adresat përkatëse bashkë me premtimet për t'i dërguar njëri-tjetrit krijimet e tyre të fundit. Vera qëndroi gjithë kohën e pikëlluar në një tryezë të mënjanuar pranë bohemit. I mbanin dorën njëri-tjetrit dhe kur po ndaheshin, u puthën me mall dhe qanë.

Para se të ndaheshin përfundimisht nga qyteti turistik ajo i kërkoi edhe një herë ndjesë Andreas, “sa të përshëndetej me dikë.”

- Me suedezin ?- pyeti Andrea.

Por nuk ishte suedezi ai me të cilin ajo u puth përsëri dhe e la Andrean të priste me çantat në dorë. Siç tha ajo më vonë, dikush që e kishte njohur gjatë darkës së parë, por që fillimisht nuk e kishte vlerësuar dot “atë gjigant, me gjoks leshtor, por që fliste kaq bukur për filozofinë dhe që ngjante aq shumë me një ari.”

-Në fund të fundit çdo ndarje mbart në vetvete një pikëllim të pashpjegueshëm, sikur të vdes diçka brenda teje,- e mbylli ajo justifikimin për vonesën.

Me të zënë vend në avion, ajo u përhum, e nisi të vështronte nga dritarja, teksa Andrea pinte verë i heshtur.

- Zot, sa më mërziti !”

-Kush ?

-Ai , ariu pra.

-Pse ?

-Desh të vinte me mua, “s'ndahem dot thosh.”

-Qartë,- tha Andrea, - pse nuk ia the..... të vërtetën ?

- Ia thashë shkoqur, më shkoqur sa s'ka. Po ai nuk e kuptonte ose nuk donte ta kuptonte.

-Po ç'thoshte ? pyeti Andrea.

- Po ç'të thoshte? Sikur ishte faji i tij. “Po pse,- kërkonte të më shfaqsohej,- po si të gjithë, unë s'e di që ndryshoj nga të tjerët që bien në dashuri për vdekje, me një fjalë s'jetoj dot pa ty”. Ma bëri kokën dauille. Dakort, njeriu krijon një simpati ... për çastin, po kjo s'do të thotë që tjetri të të ngjitet si rodhe tërë jetën a ku ta di unë.

Ajo psherëtiu mendueshëm dhe e mbylli me një nga ato citatet e saj që e linin gjithmonë gojëhapur bashkëbiseduesin :

-Dështimet nuk e ndihmuan njeriun për të kuptuar rrethanat, por atë vetë. E megjithatë ai më pëlqeu tej mase, më mjaftuan ato dy orë bisedë me të për të zbuluar atë diçka që s'e them dot me fjalë... dhe e pëlqeva pra, ashtu siç ishte.

-Dihet... gjithmonë kështu ndodh, - tha mendueshëm Andrea, - dashuria forcohet më shumë sa herë që pengohet nga diçka.

-Ç'do të thuash? e pyeti ajo.

- Si të të them, në rastin tuaj ajo u pengua nga ajo që ju s'keni mundësi të takoheni më... , domethënë kjo pengesë bëhet ndoshta shkaku që ju të duheni më shumë.

Dhe si për t'iu gjendur më pranë dhembjes së saj Andrea i kapi dorën, e pasi piu gotën e fundit me verë, nisi të kotej derisa avioni filloi të ulej në pistën e tokës mëmë.

Para se të zbrisnin, Vera sikur u gjallërua, rregulloi flokët, bëri pak tualet, uli fundin e ngritur dhe psherëtiu sinqerisht:

- O Zot, sa më ka marrë malli për burrin dhe djalin!

Në aeroport atë e priste shkencëtari trashaluaq. Ashtu si dhe para nisjes, ata u përqaftuan me të njëjtin pasion të dukshëm, pa u ngopur dot me njëri-tjetrin, teksa Andrea priste me stoicizëm me valixhet në dorë. Pas pak, ajo u kujtua dhe i tha të shoqit me një qortim çapkëneje:

- I dashur... po e lamë Andrean në këmbë...

I shoqi, pa e fshehur fare bezdinë, i dha dorën Andreas, hapi derën dhe me të hyrë brenda, e përplasi atë pa delikatesë.

Gjatë rrugës për në qytet ai me një dorë mbante timonin, me tjetrën dorën e së shoqes, e cila si një qengj i vogël i shtriqej dhe i përkëdhelte qafën, flokët, i çuçuriste në vesh fjalë të ëmbla dashurie, teksa makina nga ky shkak ecte shtrembër e bënte dredha, herë nga e majta, herë nga e djathta.

**1. PAK DRITË**

Pak dritë  
O muzg, o erë, o lot,  
të vë pak nur në këtë ballë të  
rudhosur stinësh, jetësh.  
Pak dritë,  
o mik, o peng, o mall.  
T'i vë këto kujtime në një gur mbi varr.  
Pak dritë,  
të bëjë palë dhimbjen e ekzistencës  
dhe kërkimin e esencës, sikurse një  
lapidar heroi të pluhurosor  
në sheshe të katandisura prej (mos)  
kujtimi.  
Të qëndis në vete mëndafshin e  
turbullirës së mendimeve që nuk  
kanë fund.  
Pak dritë,  
o njeri, o peng, o kafshë,  
të vë në flakë çdo gjë që nuk e dua.  
Le ta ndriçojë të gjithë botën para se  
të më vijë ajo flakë mua. Pak dritë,  
o errësirë, o gur, o pafajësi.  
Të ndaj qeniet mizore nga mizoria e  
të qenurit viktimë nga një epokë  
mbijetese e vuajtjesh. Identitetin,  
përkatësinë, t'i ripërtërijë.  
Pak dritë,  
në këtë moçal të pamëshirë që gëlltit  
çdo gjë:  
të mirën, të pamundurën, të vërtetën,  
të drejtën. Me etjen për (mbi)  
nënshtrim ta vendos barazinë,  
të qenurit kasap i dijeve të  
nënshtruara,  
në flakë të katandisur lirinë.  
Pak dritë,  
o vend, o komb, o botë.  
Veç pak dritë për një mendje që drita  
nuk i mjafton ta ndriçojë një botë  
të tërë. Veç pak dritë.

**2. PËRTEJ QEPALLAVE BOSHE**

Natës i thashë:  
Më rrëmbe... në acarin tënd.  
Më mbështjell... në krahët e hënës. Në  
tym të smogut më tret më bëj... hi.  
Çfarë isha, më nuk jam.  
Nuk shoh më... njësoj.  
Nuk eci më rrugëve të njëjta me të  
njëjtin ngazëllim. M'u tretën...  
nga kambanat e huaja zërat e  
ndërgjegjes, që... m'i plagosën.  
Natës i thashë:  
Jam më e vetmuar se ti.  
Zgjohe me si vesë e mëngjesit skllave...  
e mendimeve të huaja. Harrova  
identitetin tim prej guri...  
Zemra më vërshon... rërë.  
Nga mendimet e huaja u bëra... më pak  
vetja. Nuk e di... as ku jam.  
Natës i thashë:  
A do të agoi ndonjëherë?  
A do ta sjellë mëngjesi... aromën e  
vërtetësisë?  
Që mbi të drejtat e mia të mos i  
hedhin... qepallat boshe. Të mos  
bëhen më pak... njerëz.  
Se çfarë sheh bota nuk është... brendia.  
Natës i thashë:  
Sonte...  
qoftë nata e fundit që jetoj në  
parametra të huaj. Unë u këndella.



## KIMETE ARIFAJ

### antologji poetike

Jam vetja.  
Dhe... nëse nuk më kuptojnë më... s'më  
plas!

**3. NË MESNATË**

Kur bota hesht, engjëjt qeshin dhe  
engjëjt qajnë në të njëjtën kohë për  
ekzistencën sociale (jo)njerëzore  
Djali pushon kthetrat në mendjet e  
të paskrupujve duke gjymtuar çdo  
ndjesi morale të tyre.  
Në mesnatë,  
Kur thuren vargjet më të ndjera  
drita i mbulon me agimin e vërtetësisë.  
Sa dyfytësi në një epokë.  
Aty ku shkrihen në heshtje shumë  
fakte e rrethana që as mesnata nuk  
është e aftë t'i mbajë në supe. Në  
mesnatë,  
Kur dashuria e sinqertë e pret agimin e  
kohëve të veta  
Me gërshetim ndjenjash përpunohet  
një luftë shumë qetë.  
Edhe Mesnata i mbyll sytë kur e  
pengon drita e vet.

**4. TË JESH ART NË EPOKËN E TË  
"FJETURVE"**

Ekzistoj, nuk më shohin.  
Kam hedhur në flatrën e pëllumbit  
kohë, thelbin e arsyes së  
ekzistencës. Nuk e gjej dot nën  
petkun e mizorive njerëzore.  
Katandisur nga vetmia. Vetmi... që më  
kushtoi shume...

Të zgjuarit ekzistuan ...veç e veç,  
të fjeturit të gjallë ...janë me të  
gjithë... shpeshherë mundohen të  
jenë edhe mbi të gjithë.  
Epokave të errëta, futa krijimet në  
mesin e dy damarëve të zemrës.  
Mbështolla me gjakun tim, melodinë e  
saj ti mbijetoj kohës... e nxora, dhe  
e servira në tavolinën e ajrit...  
Mu këtu në mes, gjersa po qëndroni, e  
gëlltisni me prezencën tuaj...  
Nuk i duhen epokës së Artë vesh të  
shurdhër, dhe sy të verbuar në  
të ndjerë nën lëkurë rrëqethjen e  
britmave të krijimtarisë njerëzore.  
Duhet një rrëmujë në shpirt, një  
dozë hyjnore në zemër e një penë  
në dorë teksa gllënjkat e verës  
frymojnë lirinë e dhimbjes, afshit,  
pasionit njerëzor në letër...  
Na duhet koha të ripërtërijë shpirtat e  
vdekur në trupa të gjallë.  
Kësaj kohe që të vetmit që mbesin të  
gjallë, janë po ata që ju flenë veprat  
nën gjirin e mbuluar në dhe.

**5. MJESHTRI I PAVDEKSHMËRISË**

Në mendime jam, në to lundroj.  
Bindjet më rrëmbejnë furishëm si  
dallgë të paqena, të pakuptuara nga  
të tjerët,  
të pamëshiruara në asht,  
deri në frymën e fundit të arsyes. Në  
mendime jam.  
Sa i duhet qenies të mishërohet me  
venat e veta, në damarët e ftohtë të

struket një acar  
ndaj injorancës...

Të rrëmbej tonin e arsyes nga vatra e  
padijes...  
Gjithçka që jam, e kam jetuar; Prandaj  
e mendoj.  
Mendoj sot për pozicionin e mendjes  
si të pandashme nga veprimet  
e mia. Gjuha e mendjes është  
shpeshherë më e pasur se ajo  
ekspresive.  
Në momentin kur arrin kulmin e  
racionalitetit, shpesh mposhtet nga  
kujtesa selektive;  
herë-herë, me harresën, bëhet  
inJORANTE, por vorbullat nuk  
mbrapset lehtë.  
I duhet kohë mendimit të evoluojë. I  
duhet jetë qenies  
të krijojë emancipimin e vet si mendje.  
I duhet sfidë njeriut  
të triumfojë në kalibrin e tij.  
Në fund, të gjithë jemi "poetë": disa në  
tentativë,  
disa të heshtur nga injoranca e mbytur  
që ngulfat arsyen kolektive.  
Të tjerët janë poetë madhështorë  
të frymimit për një jetë të rëndomtë...  
Poezia jeton në secilin,  
por nuk artikullohet në secilin.  
Fillet e mendimit janë të kanalizuar  
në fillet e ekzistencës së sprovuar.  
Artikulimi është mjeshtëri,  
por të qenurit i artikulluar  
është diçka përtej njerëzores... Kalibri  
i pastër i intelektit hyjnor frymon  
vetëm në damarët  
e të qenurit vetja,  
në një masë jo indiferente  
ndaj koherencës së kognicionit  
personal. Të qenurit i gjallë nuk  
mjafton.  
Të mbijetuarit është për qyqarët,  
ndërsa pavdekësia lind aty  
ku vdekja ka frikë  
nga origjinaliteti i pavdekshmërisë së  
mendimit.  
Në fund, poeti mbetet mjeshtër i  
pavdekshmërisë, i struktur nën  
siluetën  
e artikulimeve të tij.

**6. VARKA E NDËRGJEGJES**

Nën dritat e fikura të natës, kur  
gjithë bota pushon, në errësirën  
e amshueshme, ti dhe supet e tua  
kuvendojnë.  
Askush tjetër, je ti. Vetëm ti.  
Ndërgjegjja jote me jastëkun tënd  
pushon ose përlehet.  
Iluzioni yt për dynjanë nga dynjaja të  
veçon. Çfarë sheh syri i mendjes  
të dallon si krijesë... Sheh sot me  
imazhin që ke krijuar për jetën  
nga e djeshmja, qoftë ai dhe një  
sekondë i kaluar më parë.  
Puthiten e kaluara me të tashmen në  
vende ku varka e ndërrijes lundron,  
herë në ujëra të pavetëdijshmes e  
herë me vetëdijen bënë aleancë.  
Prapë ti, në atë varkë. .  
Ti dhe vlera që i vë vetes si qenie, i  
vetmuar lundron.



# MIKEL GOJANI

## Nën një copë qiell

Tregim

Dallgët e rrëmbyeshme përplaseshin me një në brigjet e detit. Shushurimat e ujit vazhdonin me taktin e tyre për një kohë të gjatë. Njerëzit prisnin që të ndodh qetësimi i valëve në mënyrë që atyre t'u mundësohet të hynë në det për ty larë. Flamujt e kuq që ishin vendosur në plazhet tregonin që futja në det paraqet rrezik. Arditi dhe Zana P. qëndronin të shtrirë nën çadrën e tyre të ngrehur. Në bar kafen që kishin afër herë - herë shkoni; pinin ndonjë makiato ose ndonjë lëng për t'u freskuar. Burri i moshuar, i cili shëtiste përgjatë plazhit, habitet me gjithë këtë zhaurim që nuk jepte shpresë se do të mund të ndërpritej. Në fytyrën e tij vërehej një nervozizëm. Trupin e kishte mesatar. Flokët akoma të thinjura dhe veçanërisht sytë e tij jepnin përshtypjen e një njeriu të paqetë. Njëra nga valët e rrëmbyeshme erdhi fare pranë këmbëve të tij. Ai bëri një hap të gjatë për t'u shmangur, por nuk arriti dhe brekët e tij u lagën. Me një lëvizje të shkujdesur të dorës ngriti flokët që i qenë lëshuar mbi ballë dhe me po atë ritëm vazhdoi ecjen e zakonshme. Hapat i hidhte të shkurtër e të shpejtë sikur i maste me sy. Vetëm bastuni me majë metalike, që mbante në dorën e majtë. Krejt papritur, në thellësi të detit diçka e padukshme u drodh dhe sa të hapësh e të mbyllësh sytë, një pjesë e sipërfaqes së ujit u shpupuris. Syve të mprehtë të Arditi dhe Zana P. s'u shpëtoi asgjë nga këto lëvizje. Ashtu si çdo gjë tjetër që kishte të bënte me detin, për të dytë ishin të njohura deri në hollësitë më të vogla të gjitha trillet dhe të papriturat e tij. Era që kishte nisur të frynte në thellësi të ujërave, pas pak u ndie edhe në breg. Arditi ndjeu një marramendje dhe iu bë se po humbte drejtpeshimin. Me një lëvizje të qetë e të natyrshme u mbështet në krahun e Zanës. Ai kërkoi dorën e Zanës dhe pa thënë asnjë fjalë, nisi ta përkëdhelte përhumbshin, plot dashuri. I ndjeshëm ndaj përkëdheljes së saj, frymëmarrja e tij po qetësohej. Arditi duke i vënë krahun Zanës të dy ecën të heshtur në zallishtën e lagur. Përmes hazëmuzgut që kishte rënë plotësisht, trupat e tyre i ngjanin e një hijeje të vetme që lëvizte harmonishëm, më të njëjtin ritëm. Valët e detit të errët bëni zhurmë, por ata s'e vinin re. Sytë e të dyve ishin drejtuar nga hoteli në të cilin banonin, të cilin po e mbulononte nata. Disa dritëza të zbehta po ndizeshin aty-këtu si xixëllonja të vogla, që dridheshin dhe luhateshin përmes lagështirës së ajrit.

Që tani hoteli dukej më larg.  
- Pas pak do të nisë shiu- tha Zana P.  
Arditi mbështeti kokën pas supit të Zanës. Nga frymëmarrja e tij e shpeshtuar ajo e kuptoi gjithë ç'donte të thoshte...

I frymëzuar nga këto përjetime që Arditi ia shprehte Zanës P. dhe i shpaloste gjithë këtë botë që shprushte urnën e tij, mirëpo, siç ai i shprehte Zanës P. nuk mund t'i shprehte atë që zihej në shpirtin e tij.

Kjo natë i ngjasonte Natës së Ustikës!  
Këtë frymëzim me muzgun, erën, dallgët... e derdh në faqen e bardhë të notesit të tij me këto vargje:

Erdhi si vegim drite  
Mespërmes errësirës  
As hëna nuk ndriçonte -  
Ishte ogur që thyente shpresat  
Në thellësitë e humbëtitës së pafund.

Shumë herë binte shi  
Ata muaj vizullonjës  
Që përshkoni botën e mynxyrshme  
Që po vinte pa paralajmërim.

Mbase erdhi vjeshta  
Gjethet e verdha si hije e zbehtë  
Me shume melankoli  
U shuan  
Bashkë me portretin diellor.

Drunjtë e molikave të larta  
Që preknin lartësitë e qiellit  
U përplasën në brigjet shkëmborë.

Erdhi me errësirën  
Peizazhet  
Si të pikturave të Vangjush Mios  
U shkumbuan  
Në pafundësinë  
E dallgëve të detit...

Shëngjin, 8 shtator 2023

‘Në gjithë trupin më dhëmb një grua’. Më saktë, mungesa e saj, korrigoj Drini vargun e famshëm të Borgesit teksa palos me kujdes një pusullë që ka ndërmend ta përdorë si shpatë për të copëtuar fjollën e nyjzuar të dashurisë që, në vend të gëzimit, të vetmen gjë që i jep është zoritja në frymëmarrje. Letra, që është rishkruar pas çdo zhgënjimi, pra me qindra herë, ka pak a shumë këtë përmbajtje:

“Joy, Unë deri këtu jam. Më tutje rruga jonë bigëzohet(edhe këtë fjalë e ka huazuar nga Borges).Secili le të ndjekë shtegun tij. Më dhëmb mendimi që të humba, por mendimi që të kam pa të pasur është torturues. Dashurinë time, fatkeqësisht, e kam matur veç me dhimbje. Sado që dashuria është e pambarimtë, metri i dhimbjes time nuk shkon dot më tej. Do të të kujtoj gjithmonë siç kujtohet kryqëzimi i Shpirtit të Shenjtë;me dhimbje dhe adhurim deri në sosjen e ditëve. Shpresoj të të kujtohem ndonjëherë.. Drini”

Prore e kishte latuar letren asisoj, pa akuza, pa ankesa, pa shfryrje mllefi pa fyerje dhe aq më pak mallkime, sepse e dinte që të tilla ndjesi që lindin natyrshëm me fundin, gjithmonë cynsin nevojën për kundërakuza, për mbrojtje, për shpjegime, për shfaqësime si rrjedhojë, thuasje gjithmonë përfundonin në pikënisje.

Xhoana nuk e kishte për gjë të harronte orën e takimin, të mos vinte fare, të zhdukej gjithë ditën dhe në darkë të bënte një mesazh:“Beb, nuk kisha bateri. Gjume të ëmbël se jam e rraskapitur”, të fliste me adhurim për ish-in, apo të hidhte batuta tallëse për Drinin, dhe se kuptonte(a ndoshta e kuptonte shumë mirë) se këto nguleshin tek tjetri si heshta të zjarra në lukth. Mbrëmjen e shkua, paturpësia e Xhoanës dhe poshtërimi i Drinit kaluan çdo cak. Patën lënë të takoheshin, por ajo s'qe bërë e gjallë. Me pezmin e pritjes së kotë, Drini e la veten të verdallisej kuturu. Ishte mbrëmje nentori. Gjethet e rëna dhe ravëglimi i dritave të velnin me melankoli. Mes kalimtarëve të panumërt pikasi atë që nuk priste ta takonte, Xhoanën. Nuk ishte vetëm. Vetëtimthi mendoi të ndryshojë rrugën, por ishte tepër vonë. “Drini si je?”- thirri ajo me një natyrshmëri shtirane. “Ky është Fabiani, një miku im. Fab ky është Drini, një shok i imi.” Nga tronditja, a nga nevoja e ngutshme për të harruar, Drini se kujton si u zhvillua biseda më pas, por mban mend se kur qe kthyer në shtëpi dhe qe lëshuar përmbys në shtrat, mes ngjashërimeve kishte ndërjerë se veshët i qenë zgjatur aq shumë sa preknin murin ku ishte zatetur shtrati. Edhe pasqyra i përshfaqti në shëmbëlltyrë të përcudnuar. Mbi supet disi të brishta, por të natyrshme, rëndonte një kokë e zmadhuar përbindëshëm, me turirin që zgjatej përpara dhe me veshët që shkonin lart si dy gjethet të murrme misri. Në mëngjes pasqyra qe kthjelluar, por ndjenja e poshtërimit kishte mbetur. Nuk pati grimë dyshimi që kishte ardhur çasti i përsosur për të kryer veprimin që kushedi sa herë ish matur. Duhej postuar letra dhe duheshin kyçur të gjitha portat elektronike

BEHAR  
JACAJ

# Thundrat


Tregim

që Xhoana të mos futej më. Kështu le të shkonin deri në harrim. Po nisej për në postë kur cingërroi telefoni. Ishte Xhoana. I lutej që të takoheshin. “Posto letrën dhe mos u bëj idiot” - i tha një zë që ai nuk ia vuri veshin. “Edhe të dënuarve me vdekje u lejohet fjala e fundit” - foli me vete sikur po mbrohej para ndonjë trupi gjykues. “Mos u bëj idiot. Mos e lërë të të gënjejë siç bën përherë.” -këmbënguli më kot zëri. “Nëse, edhe pasqyrat më tregojnë gomar, atëherë le të jem vetja” - foli Drini, kësaj herë me ngazëllimin e dikujt që, pas një malli dërmues, dashuria ia sjell shpirtin në vend.

Pasditen dhe mbrëmjen i kaluar sëbashku. Sado që fjalët i pati të mjegullta dhe kontradiktore, Xhoanës i erdhën në ndihmë puthjet dhe nurin i saj i bollshëm që t'ia shpërndante dhimbjen dhe mendimet e errta. Në darkë, paçka se Drini ndihej i lumtur, pasqyra sërish reflektoi shëmbëlltyrën e përcudnuar. Javët që pasuan Xhoana iu kthye sifatisht të saj, zhdukej pa gjurmë dhe dukej pa shpjegime. Edhe Drini u kthye tek letra si tek një hajmali shpëtimi. Një mëngjes kur, siç thotë populli për të treguar teprimin e dhimbjes, i edhe shpirti për të dalë, mbylli zarfin duke ngjeshur në dyll një lulëzë livando dhe doli në rrugë. Sa hyri në postë, një e njohura e tij që ishte sporteliste, kushërirë e largët e mamasë, e njoftoi se kishte ardhur një zarf në adresë të tij. Ishte nga Xhoana dhe në syprinë ishte livandoja e dyllosur. Ia rrëmbeu tjetrës zafrin nga dora dhe e hapi ne një frymë. Në të gjeti fjalët e veta:

“Drin. Unë deri këtu jam. Më tutje rruga jonë ndahet(Xhoana nuk e njihje Borges-n). Dashurinë time, fatkeqësisht, e kam matur veç me dhimbje. Sado që dashuria është e pambarimtë, metri i dhimbjes time nuk shkon dot më tej. Do të të kujtoj gjithmonë siç kujtohet kryqëzimi i Shpirtit të Shenjtë;me dhimbje dhe adhurim. Shpresoj të të kujtohem ndonjëherë.. Xhoana”

Kur mbaroi së lexuari, toka iu shëmb nën këmbë dhe rrënojat e saj i ranë mbi krye. Me panikun e atij që është duke u mbytur, telefoni Xhoanën, por zëri mekanik i sekretarisë shpalli: “numri i kërkuar nuk ekziston”. Siç parandieu, edhe portat që të çonin tek ajo ishin të kyçura. I shkoi mendja të krahasonte letrën e marrë me letrën që do të postonte. Më kot gërmoi nëpër xhepa. Që andej nuk nxorri asgjë sepse duart i qenë kthyer në thundra.



# SAZAN GOLIKU

## Lotët e pyllit

Nëna Liljanë qesh me Arbërin në duar.  
Sytë e saj gjelbërohen.  
A do të ketë pamje më të bukur  
lumturia?

\*\*\*

Një kriminel i padënuar çirrej nga tribuna:  
"Poshtë politikanët vrasës!"  
Dhe u zgjodh kryetar  
i turmës pa tru.

\*\*\*

Dora e lirisë vrau tradhtinë.  
Dora e ringjallur e tradhtisë  
vrau lirinë.  
Avni Rustemi -  
në pedestal të lavdisë.

\*\*\*

E dua shiun kur jam nën tendë,  
e dua borën kur e shoh nga dritarja,  
e dua të dashurën kur hedh shkelma,  
nuk e dua presidentin kur pshur  
mbi turmën që e duartroket.

\*\*\*

Të zvarritesh këmbë e duar  
nëpër llucën kënetore  
si një vemje bukuroshe  
për t'u bërë politikan,  
për t'u kthyer pushtetar.

\*\*\*

Kapakët e syve rëndohen... mbyllen  
ëmbëlsisht...  
mbi reliefin e palavruar të trurit – mjegull  
e zezë...  
Ky nuk është gjumi.  
Qenka vdekja e bardhë –  
harrimi.

\*\*\*

Pa dashur kapa qimet e veshëve.  
Më janë zgjatur pas të shtatëdhjetave.  
Mahi e natyrës ndërsa na shkurton jetën.

\*\*\*

Klithmat e pyllit u përplasën te retë e  
nxira,  
retë ia përcollën qiellit si valë të  
dhëmbëzuara...  
qielli ua dhuroi yjeve.  
Lotët e drurëve të prerë  
u përthithën nga shkretëtira  
e së nesërme

\*\*\*

Hënë moj Hënë na ke prishur punë,  
ne linim takimet me vashën e ndezur.  
Ti dilje e qeshur për të na përqeshur  
me sytë ziliqar me helmin e ligësisë  
na hidhnin shigjeta duke grisur faqet e  
turpit.

\*\*\*

Mbi varrin e nëpunësit  
ende bën roje frika –  
dajaku i shefit  
fantazma e ligjit.

\*\*\*

Të zvarritesh këmbë e duar  
nëpër llucën kënetore  
si një vemje bukuroshe  
për t'u bërë politikan,  
për t'u kthyer pushtetar.

\*\*\*

Myku në tru ose  
shërohet vetëm kur skuqet në tigan ose  
kur e pastrojnë krimbat në varr ose  
kur jemi të droguar  
dhe e quajmë mjaltë.



# ARTA MAXHUNI

## Ajâ

*Poete e odës s'madhe*

*Germat si lulka struk*

*N'bukurinë e fjalëve*

*Banesë t'përhershme ka dashnin'*

*Kryezojën e tanave*

*Me komoditete t'vogla*

*Çdo pikë jete begenis*

*Din me fâl*

*Edhe kur e rremja ia ban kangën tingull t'hyem*

*Asht pa moshë e pa gjini*

*Për pse-t dhe sesi-t*

*Hem lutja hem gjegjia*

*Hem ndarja e hem bashkimi*

*Gojë e zmadhueme prej zâni*

*Nga kushedi ç'shtatore ikun*


*Un' jam kjo*

*Ajâ jam un'*

*Grue*



*Karikaturë nga Arben Mexsi*



# KLARA KODRA

## Në ditëlindjen e motrës



Kur të pashë ty së pari  
Kisha në dorë mimoza.  
Mimozat ngjanin - me çfarë? -  
Ja, me copëza dielli.

Ti ishe mbështjellë  
- me një batanije? -  
jo, më duket  
me një copë të vogël qielli.

Vije nga qielli i ëndërrave  
Mbi një re të kaltër.  
Vije nga qielli i ëndërrave  
Tërë dritë e bukuri.

Mamasë i kisha thënë:  
“Dua të më sjellësh motër”  
Dhuratë më dha një motër.  
Ajo motër ishe ti.

Ishe aq e vogël,  
Ngjaje me një kukull.  
Kisha në shtëpi një kukull  
Që ta kalonte ty  
Veç në fytyrëzën rozë  
Ty të shkëlqenin syçkat.

Ca syçka të errët  
ndrinin.  
O, ata sy!

Jam tretur në kujtime.  
Stilolapsi më ngeci.  
S’e mban dot stilolapsi,  
as letra,  
aq dashuri.

**Botohet  
për herë të parë  
në gjuhën shqipe  
soneti i Shekspirit  
"Shtegtari i  
dashuruar",  
përkthyer nga  
Alqi Kristo në  
vitin 1970**

*Prof. Dr. Diana Kristo*


Një vëllim antologjie nën emrin e Shekspirit me titull *The Passionate Pilgrim (Shtegtari i Dashuruar)*, botim i Jagardit (William Jaggard) doli në dritë më 1599. Botuesi kishte pikasur interesimin në rritje për sonetet e Shekspirit dhe përmbledhi njëzet poezi në një vëllim të vetëm, duke pretenduar se të gjitha i përkisnin atij. Por botimi përmbante mjaft pasaktësi lidhur me autorësinë e poezive. Vetëm disa syresh mund t'i atribuohen me siguri Shekspirit. Poezitë e tjera janë qëmtuar aty këtu nga autorë bashkëkohës si Christopher Marlowe, Richard Barnfield, Bartholomew Griffin, Thomas Wilkes e të tjerë.

Për asojë, *The Passionate Pilgrim* nuk është një poemë e vetme, por një përmbledhje mozaiku poetik kompozimesh të shkurtra, nga të cilat vetëm pesë cilësohen si zëri autentik i Shekspirit, ndërsa të tjerat u përkasin ose autorëve të sipërpërmendur, ose mbeten me origjinë të paqartë.

Në esencë, *The Passionate Pilgrim* shpalos kompleksitetin e marrëdhënieve romantike nëpërmjet pasqyrimin të temave të dashurisë, dëshirës, bukurisë, epshit dhe virtytit, nga përgjërimi i singertë e flirtimi i lehtë deri te zhgënjimi, tradhtia dhe malli, duke krijuar një tablo të gjallë të marrëdhënieve romantike si përplasje midis pasionit dhe arsyes, ndershmërisë dhe iluzionit. Disa nga poezitë janë lodruese, pasqyrë e vrojttimeve mendjemprehta e me humor të lojës së dashurisë, ndërsa të tjerat janë përsiatje e hollë midis asaj çka është vërtetësisht e ndjerë dhe mashtrimin të ëmbël që dashuria shpesh vesh me petkun e singertetit. Vëllimi konturon dashurinë si një dëshirë fizike dhe dhimbje emocionale, një lidhje romantike dhe një realitet i hidhur i marrëdhënieve njerëzore.

*Shtegtari i Dashuruar*, megjithëse i shqipëruar aty nga vitet 1970 nga Alqi Kristo, virtuoz i përkthyer i verbit dhe nuancave ekuivalente kulturore, mbeti në dorëshkrim deri në ditët e sotme. Versioni shqipëruar finëson dhe rrjedhshmërinë e gjuhës së pastër shqipe, lehtësinë e të kuptuarit të idiomatikës dhe metaforës së pasur shespiriane,

Shpreh mirënjohjen time të singertë ndaj Ex Libris dhe në mënyrë të veçantë ndaj Bujar Hudhrit, botuesit të palodhur e me standarde të rralla, për bashkëpunimin korrekt e profesional si dhe për besimin e palëkundur, përkujdesjen dhe dashurinë e tij ndaj fjalës së shkruar, në mbështetje të vlerave të letërsisë së vërtetë.



**WILLIAM SHAKESPEARE  
Shtegtari i dashuruar**

*Përktheu nga origjinali*

**ALQI KRISTO**



## SHTEGTARI I DASHURUAR

## I

Kur dashnorja betohet të vërtetën mishëron,  
Unë e besoj, ndonëse e di që gënjen;  
Ajo pandeh syri im axhami s' shikon,  
I parratur me dredhitë false, s' vëren.

Më kot mendoj që më merr ende të ri,  
Ndonëse e di që po më ikën jeta,  
Buzëqesh, e i zë besë gjuhës plot dredhi,  
Nga të dy palët shëmtuar shkelet e vërteta.

Po pse s' tregon se është e pabesë?  
Dhe unë pse s' pranoj se qenkam plakur?  
Oh, shtirjen dashuria e ka shpresë,  
Dhe pleqëria s' pranon q' është vakur.  
Kështu pra njëri tjetrin e gënjejmë,  
Fajet, me rrena, në lajka i kthejmë.

## II

Kam dy dashnorë që s' janë të ngjashëm,  
Një më gëzon e një më ka helmuar;  
I miri engjëll është burrë i pashëm  
Dhe shpirti i lik, një grua e shëmtuar.

E liga grua më tërheq në ferr,  
Më ysht ta zboj pra, engjëllin pa faj  
Dhe shenjtin tim ta bëj një djall për sherr,  
T'ia ndyj dëlirjen me shëmtinë e saj.

Dhe si të kthehet engjëlli në djall,  
Unë nuk do ta njoh, por do dyshoj;  
Ata të dy, do bëhen miq për mall,  
Por engjëlli do bëhet djall, besoj.

Nuk do ta di, por do rroj me dyshim,  
Se mos ajo ma flak të mirin tim.

## III.

Fjalët hyjnore që më shpreh me sy,  
Që bota të t' i kthejë, s' ka guxim,  
A mjaftojnë vallë të të falin ty,  
Kur shkel betimin, pa ndonjë dënim?

Me gra nuk merrem, por do të provoj,  
Se ti je perëndeshë, prandaj s' të ndaj,  
Dhe dashurinë do të ta fitoj,  
Me q' është hyjnore, turpin mund ta laj.  
Betimi im është frym' që avullon;  
Atëherë ti o diell që ndrit në botë,  
Ma davarit betimin që më sundon,  
Që kur ta shkel, të mos kem faj të plotë.  
Se ç' budalla s' do shkelte atë be  
Për të fituar parajsën përmbi dhe?

## IV

Citer' e ëmbël rri te një përrua<sup>1</sup>,  
Tok me Adonin, freski e rinisë,  
Përkëdhel djalin me sy si fajkua,  
Tamam si mbretëresh' e bukurisë.

Ca ngjarje q' e dëfrenin i rrëfente,  
Dhe ca dhurata që fort e tundonin;  
E prekte lehtë, zemrën t' ia rrëmbente,  
Të tilla prekje, nderin ia cenonin.

Por ca nga mosh' e mitur, pa guxim,  
E ca nga turi i plaçkës, ca nga data,  
Karremin s' desh ta prekte për dëfrim,  
Por qeshte e tallej me ato dhurata.  
Ajo mbretëreshë, u shtri në shpinë e u bë gati  
Ai budall kokëshkretë, ia mbathi nga inati.



## V

Në dashuria më cyt të shkel benë,  
Besa çmeritet po s' jepet për bukurinë;  
Ndonëse besëthyer, për ty nuk shkel benë,  
Mendimet e mia si lisa, për ty si shelg përkulen.

Nga fletët e shelgut merr mësim;  
Mësimi i këndshëm është si dhuratë;  
Kush të njeh ty, ka dije e durim  
Dhe kush të lavdëron, ka edukatë.

Është injorant ai që s' të admiron,  
Këtë e çmoj sepse t' admiroj vetë;  
Të shkrepin sytë, zëri të gjëmon,  
Muzikë e zjarr i ke kur je e qetë.

Hyjnore je, por mos shko me të tjerë  
Që të të ngre në qiell kurdoherë.

## VI

Posa thau dielli vesën mëngjesore,  
Porsa kopeja zuri hijen vetë,  
Citera zjarr me dashuri trupore,  
Priti me mall Adonin kokëshkretë.

Pranë një shelgu aty në përrua,  
Ku shkonte vapën Adoni çdo ditë,  
M' e nxehur se dita ajo u afrua  
E priste djalin tamam si në pritë.

Ai sa erdhi, u ul përmbi bar,  
I hoqi rrobat, buzë ujit ndali;  
Dielli vështronte botën me sy zjarr,  
Por jo siç nguli sytë ajo te djali.

Porsa e pa, ai u vërvit n' ujë:  
"O Zot, tha ajo, përse s' më bëre ujë?"

## VII

E bukur, por luhat dashnorja ime,  
E ëmbël si pëllumb, por namuz prekur;  
E pastër xham, por bëhet copë e thërrime,  
E butë dyllë, por ndryshket si hekur.  
Zbardhon e skuq si trëndafil i ri,  
Por s' e kalon askush në pabesi.

Sa herë i puq buzët me të miat,  
Çdo puthje e shoqëron me plotë betime,  
Ç' përralla shpik që të m' i ngopë shijat,

Trembet mos humbë dashurinë time!  
Por tek më shfaq të tillë dashuri,  
Betime e lot i bën për qesëndi.  
Nga dashuria porsi kashta digjet,  
Por shpejt, si kashtë e dogji dashurinë;  
Ashtu siç i ndërtoi, i shembi shtigjet,  
Se nuk e respektoi besnikërinë.  
A ishte kjo lavire a dashnore?  
Të mirën e ktheu keq, të dyja horre.

## VIII

Kur poezia puqet me muzikën,  
Ashtu siç puqet motra me vëllanë,  
Kjo dashuria jonë e shton lirikën,  
Se një do ti, një unë, jemi pranë.

Ty të pëlqen Doulendi me lahutë<sup>2</sup>  
Sepse magjeps çdo ndjenjë njerëzore,  
Dhe mua Spenseri<sup>3</sup> se di të futë,  
Më fort se kush, idera madhështore.

Ty të pëlqen të dëgjosh melodi  
Nga Fobi q' ep muzikë mbretërore<sup>4</sup>,  
Dhe unë zhytem n' atë ëmbëlsi  
Siç zhytet dhe ai në këngë eprore.  
Një Zot për të dy, siç thotë poeti,  
Dashnorët shkrihen tok te njëri tjetri.

## IX

Një ditë, mbretëresh' e dashurisë,  
.....<sup>5</sup>  
M' e zbehtë se pëllumbi prej mërzisë,  
Për hir t' Adonit krenar e të egër;

Ajo qëndron mbi një kodër të lartë,  
Kur vjen Adoni me bri e langonj,  
Nga epshi ndezur, mbretëresh' e zjarritë,  
Të hynte n' ato toka, s' e lejoi.

"Një herë, - tha, - kam parë një djalosh,  
Në këtë pyll, plagosur nga një derr,  
Në kofshë thellë, ja këtu përposh,  
Shikoma kofshën, plagë e rëndë, tmerr."

Tek ia tregoi, ai pa plagë shumë  
Dhe iku vrap me turp, sikur kish punë.

<sup>2</sup> Doulend – lahutist i famshëm në kohën e poetit.

<sup>3</sup> Spenser – poet i shquar anglez

<sup>4</sup> Fobi – Apollo, perëndia e diellit.

<sup>5</sup> Në këtë sonet, mungon vargu i dytë.

<sup>1</sup> Citera – Afërdita (Venus)

## X

Lule e këputur herët, fishket shpejt;  
Këputet gonxhja e fishket kërcelli!  
Perla e nxjerrë herët, nxihet krejt!  
Të bukurën më shpejt e rrëmben qielli!  
Si mollë e gjelbër në pemë, e paprekur,  
Q' e rrëzon era ende të papjekur.

Unë vajtoj për ty pa pasur shkak,  
Sepse në testament s' më le asgjë,  
Por prapë them, se s' më ke lënë pak,  
Se unë kurrë s'të kërkova gjë.  
Oh, po moj shoqe e dashur, të lyp ndjesë,  
Ti më ke lënë dëshpërim në pjesë.

## XI

Me Adonin Afërdita po qëndronte,  
Nën hije, tek një lis, për dashuri,  
Se si e kapi Marsi i tregonte<sup>6</sup>  
Dhe kjo iu dorëzua për çudi!

"Kështu, - tha, - më pushtoi e më koriti"  
Dhe e pushtoi Adonin për një grimë;  
:Kështu, - tha, - mbreti i luftës më shkopsiti"  
Dhe i zbuloi djaloshit bukurinë;

"Kështu, - i tha, - dhe buzët m'i vulosi"  
Dhe ngjiti buzët mbi buzët e tij;  
Por kur i thithi frymën sa ia sosi,  
Ai ia mbath me vrap e lemeri.  
Ah, ja kështu e dua unë gruan  
Që të më puthë sa të humb toruan!

## XII

Rinia nuk rron dot me pleqërinë.  
Djali kërkon gëzim, plaku kujdes;  
Djali behar, plakushi cingërimë;  
Djali i shkathët, plaku me përdhes.

Djaloshi plot hare, plakushi fle;  
Djali vrapon, plaku gulçon;  
Djali i duruar, plaku i dërmuar;  
Djali azgan, plaku nopran.

Moshën s'e dua; t'adhuroj rini;  
Dashuria është e re.  
Ti pleqërinë merre, o bari,  
Se duket vjen me nge.

## XIII

E mirë është bukuria, por e kotë;  
Lustër e ndritur që nxihet në çast;  
Lule që vdes, qysh porsa çel në botë;  
Një qelq i brishtë që thyhet me kast.  
Një plaçkë afife, qelq, shkëlqim, kurorë,  
Që humb, venitet, thyhet për një orë.

Dhe siç humbet e mira përmbi tokë,  
Siç nxihet lustra kur s'fërkohet më,  
Siç vdesin lulet, tharë, bërë trokë,  
Si qelq i thyer, që nuk ngjitet më,  
Ashtu dhe nuri që nxihet me bojë,  
Nuk ka ilaç e dhembje ta shërojë.

## XIV

Natën e mirë! Ah, kjo s'është për mua;  
Ajo q'uron, më ngjall një shqetësim;  
Më mbylli në një dhomë kur u gatua  
Merak i madh për shkatërrimin tim.  
"Rri me shëndet, - tha - nesër eja prapë".  
Ç' shëndet? Unë kam hyrë në një kllapë.

Po kur u ndamë, ajo buzëqeshi,  
Për miqësi a tallje, s'e kuptoj;  
Ndoshta nga që më zboi e më përqeshi,  
A ndoshta që t'i kthehem, ta afroj.  
"Të kthehem!" Fjalë bosh e plotë mjerim  
Se marr mundimin e nuk marr shpërblim.

## XV

O Zot, ç' po shoh në lindje tek agimi!  
Më zgjohet zemra; dhe mëngjesi i ri  
I fton të çohen ndjenjat nga pushimi.  
S' guxoj të kem besim në syt' e mi,  
Tek shoh bilbilin sa shpejt ligjëron  
Dhe lus t'isha lauresha që këndon.

Sepse ajo e pret me këngë agimin  
Dhe zbon të zezat ëndrra që tmerrojnë.  
Pra, shkova të dashnorja për takimin;  
Se zemra edhe sytë ma kërkojnë.  
Vreri u bë gaz e gazi vrer  
Se tha: "Ti eja nesër e më merr."

T'isha me të, do të shkante nata shpejt  
Kurse tani, minutat bëhen orë  
Dhe një minutë zgjat një muaj krejt!  
Ndririt lulet, diell, mos ndrit për një të gjorë!  
Ti natë, jepja kohën tënde dritës,  
Shkurtohu sonte, nesër merrja ditës.

## [XVI]

Ajo ish bijë lordi, m'e bukura në tri,  
E desh të shoqin shumë, më fort se çdo njeri,  
Gjersa i zuri syri njënglez, djalosh të ri,  
I cili ia ktheu mendjen.

E gjatë ishte lufta, midis dy dashurive,  
Ja trimin do të vriste, ja burrin e lavdive,  
T'i mbante që të dy, ish kulm i marrëzive.  
Oh, ç' zonjë budallaqe!

Po njëri do të lihej, se ish si gjemb në sy,  
Asgjë s'mund ta ndihmonte, t'i mbante që të dy;  
Dredhit' e saj e fyen të shoqin sa u fry.  
Sa keq që s'kish se ç'bënte!

Kështu u ndeshën armët me dijen për fitore,  
Por dolën më të forta armët kulturore  
Se e rrëmbeu m'i dituri zonjën gazmore.  
Këtu mbaron dhe kënga.

## XVII

Ish një ditë lot e vaj,  
Dashuria si në maj,  
Pa një lule kuq si zjarr  
Q' e nget ajri ledhatar.

Nëpër fletët kadife  
Përshkon era si pa fre;  
Një dashnor që pret të vdesë,  
Era frymë i jep shpresë.

"Ajri, - tha - të prek pa punë,  
Ajër desha t'isha unë!  
Por kjo dorë është betuar,  
S'këput lule gjemb mbuluar.

Por i riu s'mban premtim,  
E kap lulen me guxim.  
Se për ty dhe Jupiteri  
Ta kish gruan zezo ferri,

S'do desh t'ishite perëndi,  
Të kish tënden dashuri!"

## [XVIII]

Kopetë s'ushqehen,  
Dhe dhëntë s'ndërzenen,  
Se deshtë nuk nxehen.  
Çdo gjë s'më do.

Dashuri s'ka,  
Besa mu nda,  
Zemra më la,  
Shkaktare kjo!

Vjershat me shaka i kam harruar,  
Dashuri e gruas m'është shteruar,  
Kur ajo më shfaq një dashuri,  
Vihet një "jo" që s'e tund njeri.  
Një fat i zi,  
M'i bëri hi;

O fat i zyrtë, grua e pabesë!  
Se shoh tani,  
Plotë pabesi,  
Nga gratë, se burrat lypin ndjesë.

Mbaj zi fiçor,  
Çdo frikë e shporr,



<sup>6</sup> Marsi, perëndia e luftës.

Dashuria më korr,  
 Jetoj zeher.  
 Zemra më pikon,  
 Ndihma më mungon,  
 Fati më dënon,  
 Ngarkuar me vrer.

Xhura e bariut tim, s'dëgjohet,  
 Dashi im i tredhur, s'harbohet,  
 Qeni bishtprerë, s'lot një pikë,  
 Jo vetëm s'lot, por ka dhe frikë;  
 Psherëtimat s'i mbaj,  
 Më bëjnë të qaj,  
 Kur angullit, jam në mjerim.  
 Psherëtimat ushtojnë,  
 Nga toka jehojnë,  
 Si mijëra burra të munduar në luftim!  
 Pusët s'mbufojnë,  
 Zogjtë s'këndojnë,  
 Pemët s'blerojnë,  
 Ngjyrë s'kanë.  
 Tufat vajtojnë,  
 Kopetë gjëmojnë,  
 Nimfat përgjojnë,  
 Frikë kanë.  
 Kënaqësitë tona si çobanë,  
 Gjithë takimet nëpër fusha çqenë,  
 Lojnat e mbrëmjes, kanë fluturuar,  
 Dashuria ka humbur, ka mbaruar.  
 Lamtumirë vashë,  
 Të gjitha i lashë.  
 Kur s'kam kënaqësi kam shkak për zi:  
 I gjori Koridon<sup>7</sup>,  
 Vetëm jeton,  
 Ndihmë për të nuk ka, askush s'mendon.

**XIX**

Kur syri yt ka zgjedhur vashën  
 Dhe e kap drenushën pa mundim,  
 Gabimet ndreqen e nuk trashen,  
 Me dashuri e me durim.  
 Merr këshillë nga një m'i zgjuar,  
 Jo aq i ri, i pamartuar.

Dhe kur fillon që ta gjykosh,  
 Mos përdor fjalën lustër bosh,  
 Që të nuhatë se do shahet –  
 I çali gjen se ku të mbahet; –  
 Por thuaj thjesht, je shpirti im  
 Që t'i tregosh se ke besim.

Çka se vrenjt vetullat ajo,  
 Retë do të zhduken domosdo;  
 Më vonë ajo do të pendohet  
 Që po rren veten e helmohet.  
 Atë që mbron ditën tjetër,  
 Do ta përbuzë shpejt, patjetër.

Dhe në përdortë forcën, çë,  
 Me nëmë e grindje thotë, jo;  
 Forca e saj, nuk është asgjë,  
 Se me dredhi do thotë ajo:  
 "T'ish gruaja e fortë si burrë,  
 Nuk do ta mbanit nën besë, kurrë."

Kështu, çdo ti, ia ngul asaj;  
 Mos u kurse për të shpenzuar  
 Lëvdata, merita pa faj  
 Duke e bindur e treguar  
 Se një kështjellë a kullë e lartë,  
 Merret kollaj me plumb të artë.

Trajtoje me besim e ndreq  
 Me sjellje t'urtë e të sinqertë;  
 Dhe kur ajo të sillt keq,  
 Mos e ngacmo ta bësh të sertë.  
 Kur të gjesh rastin, mos nguro,  
 Ta këshillosh kur thotë jo.



Dredhitë e grave mos harro,  
 Mbulohen nga jashtë me shijë;  
 Hilet, trillet që kanë ato,  
 Gjeli q'i shkel, s'duhet t'i dijë.  
 S'e dini ju fjalën që thotë:  
 Çdo grua ka tekë të kotë?

**[XXI]**

Ish një ditë, mend e maj,  
 Në të këndshmin muaj maj;  
 Ishim ulur nën një hije,  
 Tek ca lisa në koriye;  
 Bisha rendnin, zogj këndonin,  
 Pemët çelnin, lulëzonin,  
 Çdo gjë vajin e largonte,  
 Veç i ziu bilbil vajtonte,  
 Ai zog është për të dhemb,  
 Ulte gjoksin gjer mbi gjemb,  
 Dhe ia thoshte me të qarë  
 Për mëshirë e zemërvrarë.  
 Cuq, cuq, cuq, ai këndonte,  
 Fiu, fiu, fiu, kështu vazhdonte;  
 Ta dëgjoje se si qante,  
 Askush lotët s'mund t'i mbante;  
 Kaq e shprehte dëshpërimin  
 Aq sa më kujtonte timin.  
 Oj – i thashë – ti qan kot!  
 Askush s'të ngushëllon dot:  
 Pemët rreth nuk kanë ndjenja,  
 Bishat s'janë aspak të denja,  
 Mbret Pandioni<sup>8</sup> të ka vdekur,  
 Shokët krejt të janë mekur;

Të ka mik njeriu, ta dish,  
 Po ti s'ke me kë të rrish.  
 Dhe po mbete pa para.  
 As njeriu hovarda  
 Q'i ka me thes paratë,  
 S'të ndihmon e të lë thatë,  
 Edhe lajkat kur i shet  
 "Mëkat që s'je bërë mbret;"  
 N'është i prirur nga përmendja,  
 Shpejt atij i rritet mendja;  
 Në u sjellte keq me gratë,  
 I këllasin frikë e datë.  
 Po në e braktistë fati,  
 Shkon çdo madhështi që pati;  
 Dhe ata q'i krihnin bishtin,  
 Tani s'i zgjatin as gishtin.  
 Ai q' është mik vërtetë,  
 Të ndihmon kur ke siklet:  
 Në paç dhembje, ai qan,  
 Në s'ke gjumë, ai ofshan;  
 Në çdo dëshpërim e mbresë,  
 Tok me ty ai merr pjesë.  
 Kush të lyen shpon si shajka,  
 Mik besniku nuk bën lajka.

Gratë me burrat zihen pa drojë,  
 Të shahen, jo për tu lëvduar,  
 S'ka zot a shenjt q t'i pajtojë  
 Kur mosh' e tyre ka kaluar.  
 Po t'ish përputhje në krevat,  
 Femra gjen tjetër e s'e zgjat.

Por ndal! Mjafton, sepse kam frikë.  
 Po dëgjoji shoqja, më bën zap,  
 Nuk do më ndahet asnjë çike  
 Sa të mësoj që të mos llap.  
 Por do të skuqet, siç ndodh shpesh  
 N'i dalçin të fshehtat në shesh.

**[XX]**

Rri të bëjmë dashuri,  
 Do të gjejmë lumturi,  
 Bredhim kodra e lugina,  
 Male, fusha e lëndina.  
 Gërxhe e pllaja, marrim dhenë,  
 Tek kullot bariu kopenë,  
 Në lumenj e në ujëvara,  
 Ku këndojnë zogjtë në ara.

Të t'bëj shtrat me trëndafila,  
 Me buqeta karafila,  
 Me kurorë e lule thanë,  
 Do të ta qëndis fustanë.

Do shtroj lule e burbuqe,  
 Lidhur me kordele të kuqe;  
 Po të të pëlqejnë ato,  
 S'dua gjë, më dashuro!

**PËRGJIGJJA E DASHNORES**

Dashuri e bot' e re  
 Dhe e vërtetë t'ish me ne,  
 Ato më pëlqejnë shumë  
 T'i gëzoj me ty dhe unë.

<sup>7</sup> Koridon - emër bariu.

<sup>8</sup> Pandion - Mbreti i Athinës, babi i Filomenës, e cila u shndërrua në bilbil.



Edicioni i II i Panairit të Librit në Shkodër  
28-30 Maj 2026

## Edicioni II i panairit “Libri të ban të lirë”

Në ambientet e famullisë “Zoja e Shkodrës” në Shkodër, me datë 28-30 maj 2026, do të organizohet për të dytin vit radhazi panairi i librit “Libri të ban të lirë”, me pjesëmarrjen e shkrimtarëve dhe botuesve nga të gjitha trevat shqiptare. Bordi organizativ i përbërë nga Stefan Çapaliku, Andreas Dushi dhe Gjovalin Çuni kanë përmbyllur programin e veprimtarive kryesore, ndërkohë që pritet të plotësohet me veprimtari të tjera të propozuara nga botuesi e pranishëm.

### Programi:

#### 28 maj

**11:00** Takim i shkrimtarit Xhahid Bushati me nxënësit e shkollave të qytetit për prezantimin e veprës së tij. (Salla “Kardinal Mikel Koliqi”)

**11:00** Punëtorja e shkrimtarisë krijuese I – Mentor Stefan Çapaliku. (Salla e Muzeut Dioqezan)

**Ora 17:30:** Promovimi i librit të Fabio Rocchit “Ligjërimet...”, moderator Durim Taçi.  
(Biblioteka “Zoja e Shkodrës”).

**Ora 18:45:** Çelja e Panairit të librit. Përhëndesin: Mons. Giovanni Peragine, Arqipeshkëv;  
Profesor Matteo Mandala; Anna Shkreli, botuese (Odeoni i hapur).

**Ora 19:00:** Promovimi i romanit “Droja” të Andreas Dushit (Odeoni i hapur).

**Ora 20:00:** Seancë leximesh (Odeoni i hapur).

Arjola Zadrime; Durim Taçi; Gazmend Krasniqi; Arben Shala; Mimoza Rexhvelaj.

#### 29 maj

**Ora 10:00:** Përkthimi në shqip, ura kulturore me botën: Granit Zela, Durim Taçi, Xhelal Fejza dhe Zija Vukaj.

**Ora 11:00:** Ligjëratë nga Zuzanë Finger “Letërsia shqipe në gjermanisht”  
(Salla “Kardinal Mikel Koliqi”); (Biblioteka);

**Ora 11:00:** Punëtorja e shkrimtarisë krijuese II – Mentor Stefan Çapaliku (Salla e Muzeut Dioqezan)

**Ora 12:00:** Poezia bashkekohore shqipe. Në panel: Lulzim Haziri, Gazmend Krasniqi, Primo Shllaku,  
Ledia Dushi, Rozafa Shpuza (Salla “Kardinal Mikel Koliqi”);

**Ora 18:00:** Prezantim i “Triumfi i Gjergj Elez Alisë”, Ridvan Dibra. (Biblioteka “Zoja e Shkodrës”)

**Ora 19:00:** Ligjëratë nga Matteo Mandala mbi Martin Camajn dhe botën arbëreshe  
(Salla “Kardinal Mikel Koliqi”);

**Ora 20:00:** Seancë leximesh.

Lulzim Haziri; Rozafa Shpuza; Granit Zela; Primo Shllaku; Melita Vjerdha

#### 30 maj

**Ora 10:00:** Punëtorja e shkrimtarisë krijuese III, lexime letrare dhe ndarja e certifikatave për pjesëmarrësit – Mentor Stefan Çapaliku (Salla “Kardinal Mikel Koliqi”)

**Ora 11:00:** Promovimi i librit të ri të Stefan Çapalikut “101 tregime të shkurtra”,  
(Salla “Kardinal Mikel Koliqi”).

**Ora 12:00:** Ndarja e Çmimeve të Panairit “Libri të ban të lirë”.